# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXIV - Nr. 7562 E diel 17 Qershor 2018 **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**


Opinioni i Ditës

Nga ANDI BUSHATI

## Kush po luan me aktorët?



E gjithë propaganda e pushtetit është angazhuar ditët e fundit për ta paraqitur çështjen e Teatrit Kombëtar si një dasi mes artistëve. Që pas tubimit ...

Vijon në faqen 21

Dje në "Deutsche Welle"

Nga THOMAS LATSCHAN

## Kampionati Botëror në Rusi, humbje për lirinë e shtypit



Mijëra gazetarë dridhen kur dëgjojnë bilbilin për hapjen e Kampionatit Botëror në Rusi. Mes tyre nuk ndodhet Hajo Seppelt. Ai është gazetar sporti ...

Vijon në faqen 22



Kryeministri: Do bëjmë Rrugën e Arbrit

## Batutat e banorëve në Lurë me Ramën: Je i dyti që vjen këtu pas Mehmet Shehut

Replika e kryeministrit: Ishalla do shkojë ndryshe puna ime. Agroturizmi, TVSH-ja 6%

DARINA TANUSHI

Nis sot zyrtarisht puna për ndërtimin e Rrugës së Arbrit në Dibër, ndërkohë që kryeministri Edi Rama premtoi dje edhe rikonstruksionin e rrugës që të çon në Lurë, një nga pikat turistike të zonës dhe të vendit. Gjatë një ...

Në faqen 3

EMRAT/ MINISTRIA E FINANCAVE PUBLIKON LISTEN E RE TE PERFITUESVE

# TE PERNDJEKURIT, KUSH E FITON DEMSHPERBLIMIN

Ish-të dënuarit e diktaturës që marrin paratë. Kush e ka emrin në listë duhet të dorëzojë numrin e llogarisë bankare brenda muajit qershor




*(Në foto)* Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 6

E HODHEN NGA MAKINA

## Vrasja e Anxhela Meçanit, ndalohet dhe lihet i lirë 63-vjeçari italian

Në faqen 7

FLET ISH-DEPUTETJA

## Burri i Mimoza Hafizit padit LIBRA-n: Më ktheni 25 milionë lekë

Në faqen 4

SA DO TE PAGUANI

## Rruga e Kombit, ulje tarife për përdoruesit me mbi 10 kalime në muaj

Në faqen 5

KRITIKA

## "Wall Street Journal": Kadare, ndërgjegjja e popullit të tij

Në faqen 12

PROTESTA TE TEATRI



## Hervin Çuli: Nuk i kërkoj falje Mirush Kabashit, zotëria gënjeu për mua

Në faqen 12

MILOSAO Kush është shkrimtarja që ia dhuroi librat Akademisë së Arteve në Tiranë

## Dasha Drndiç, një autore mike e shqiptarëve

*Në brendësi: Për librin e Ferrantes. Gjon Gazulli, ambasador i Skënderbeut*

Nga BEN ANDONI

Kishte fituar njohje ndërkombëtare dhe ndërkohë me veprën e saj i pati dhënë një status të lartë dhe tepër interesant letërsisë kroate, që funksionon si degë e veçantë në letërsinë sllave pas ndarjes së ish-Jugosllavisë. Tema për të cilën ishte më e predispozuar ishte ajo që lidhej me përballjen e individit me vetëdijen dhe sidomos me kujtesën. Ishte tejet e interesuar me rastin shqiptar për këtë përballje dhe me miqtë e saj shqiptarë ndau shumë ...



Suplement

# SITUATA POLITIKE
## REAGIMET

### Presidenti në Berlin takon kreun e Shoqatës Evropiane të Sipërmarrjes

## Ilir Meta: Ka interes të lartë të sipërmarrjeve gjermane për Shqipërinë

Presidenti i Republikës, Ilir Meta pati dje gjatë vizitës në Gjermani një takim me presidentin e Shoqatës Evropiane të Sipërmarrjeve të Mesme e të Vogla, Mario Ohoven. Gjatë këtij takimi, presidenti deklaroi se konstatoi një interes shumë të lartë të sipërmarrjeve gjermane për të bashkëpunuar me Shqipërinë. Në një status në rrjetin social "Facebook", Meta shkroi dje: "Një takim i shkëlqyer me Presidentin e Shoqatës Evropiane dhe asaj Gjermane të Sipërmarrjeve të Mesme e të Vogla (BVMW), zotin Mario Ohoven. Kënaqësi që konstatova një interes shumë të lartë për të bashkëpunuar me Shqipërinë. Ramë dakord që në


Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, dje gjatë takimit me Mario Ohoven

kuadër të aktiviteteve për 30-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve ekonomike e tregtare me Gjermaninë, të përfshijë Shqipërinë në rrjetin me të madh evropian të SME-ve". Po dje, Presidenti Meta i akordoi në një ceremoni të veçantë violinistes së shquar shqiptare, Ervis Gega, titullin e lartë "Naim Frashëri". Presidenti Meta me këtë rast shprehu mirënjohjen e thellë për kontributin e dhënë nga violinistja e shquar për lartësimin e emrit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. "Kam privilegjin që si President i Republikës të vlerësoj një personalitet që kontribuon për lartësimin e emrit të vendit tonë në Gjermani, në Evropë dhe në të gjithë skenat ku ajo demonstron talentin e saj", - tha Presidenti Meta. Duke vlerësuar talentin e zonjës Gega, performancën e saj në skenat më prestigjioze të Gjermanisë dhe të botës, si dhe karrierën shumë të suksesshme artistike si koncertmaestre e parë e Filarmonisë së Bonnit, Presidenti Meta nënvizoi se shqiptarët ndjehen krenarë me talente të tilla në botë. Presidenti i Republikës i akordoi violinistes Ervis Gega titullin e lartë "Naim Frashëri" me motivacionin "në shenjë vlerësimi për kontributin artistik si një violiniste e shquar dhe e suksesshme shqiptare, e cila ka interpretuar në festivalet shqiptare dhe në skenat e mëdha botërore".


Kryeministri Edi Rama dje në Lurë

### Ish-presidenti, dyshues për vendimin e BE: Nuk do të ketë datë deri në plotësimin e disa kushteve

# Nishani: Arsyet pse nuk do të hapen negociatat

## *"Përgjegjësit e kësaj katrahure po na izolojnë përsëri nga bota e qytetëruar"*


Ish-Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani ngriti dje shqetësimin se ka sinjale nga vendet e Bashkimit Evropian se nuk do të japin dakordësinë për çeljen e negociatave në datën 28 qershor. Përmes një postimi në "FB", Nishani shkroi dje: "Të dashur miq, vendet kryesore evropiane kanë nisur sinjalet e para se Shqipëria nuk do ketë një datë përfundimtare për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian deri në plotësimin e disa kushteve". Sipas tij, arsyet janë: "Banditizmi dhe korrupsioni, droga dhe kriminalizimi institucioneve të shtetit, blerja e zgjedhjeve dhe vrasja e shpresës, ikjet masive nga vendi dhe kontrolli i të gjitha pushteteve nga një njeri i vetëm, kufij të shqyer dhe aleanca të dyshimta, varfërimi i popullit dhe grabitjet e pasurive publike nga oligarkët e pushtetit, shqiptarët e zakonshëm që mbyllin bizneset e tyre dhe bosët mafiozë, që pastrojnë në kulla paratë e narkotikëve, spitale mizerabël dhe shkolla në degradim, rrugë që shkatërrohen në vend që të ndërtohen, propagandë hipokritësh si në vitet '70, etj., etj.". Pa përmendur emra, por duke nënkuptuar kryeministrin e qeverinë, Nishani u shpreh më tej: "Përgjegjësit e kësaj katrahure po na izolojnë përsëri nga bota e qytetëruar, e civilizuar dhe e lirë". Tashmë pritet që pas raportit dhe rekomandimit që dha Komisioni Evropian për të hapur negociatat pa kushte me Shqipërinë, Këshilli Evropian të vendosë përfundimisht nëse do t'ia japë këtë provim Shqipërisë për të kaluar në një fazë tjetër në datat 28-29 qershor. Gjatë këtyre ditëve ka pasur një lobim të fortë të kryeministrit Rama, ministres së Drejtësisë, atij të Brendshëm në vendet skeptike si Gjermania, Holanda e Franca. Ditët e fundit ndërkaq, Johannes Hahn, komisioneri i BE për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit në një intervistë për gazetën "Der Standard" deklaroi se Shqipëria nga këndvështrimi komisionit ka përmbushur kërkesat për të filluar procesin e negociatave. Ai ka vlerësuar reformën në gjyqësor, një nga 5 prioritetet kyçe që Shqipëria kishte për të realizuar si kusht para hapjes së negociatave. "Pra, nga këndvështrimi ynë, Shqipëria i ka përmbushur kërkesat për të filluar procesin e shqyrtimit. Bazuar në këtë, ju mund të bëni një analizë për të parë kriteret për hapjen e kapitujve. Jam i bindur se Shqipëria, pas vendimit maqedonas, mund të bëjë të njëjtën gjë. Mundësia për reforma është më e fortë gjatë negociatave. Unë jam i bindur se Franca dhe Holanda do të shohin gjithashtu 'gotën gjysmë plot'", u shpreh Johannes Hahn.

## Berisha denoncon trafik droge me avion drejt Italisë: U nis nga Tepelena

Ish-kryeministri Sali Berisha, referuar denoncimit të një qytetari dixhital postoi dje një foto të një avioni që kalon mbi Tepelenë, sipas informacioneve të ish-kryetari të PD-së. Në foto duket të jetë një avion i vogël, ndërsa qytetari dixhital shprehet se bëhet fjalë për një avion që trafikon drogë drejt Italisë. "Tepelena, përsëri kryeqytet i kanabisit në Europë! Narkoflota çdo ditë transporton mallin drejt Italisë", shkroi dje në faqen e tij në rrjetin social "Facebook", ish-kryeministri Berisha. Ndërsa qytetari dixhital, sipas tij, ka thënë se nga



Tepelena është nisur një avion i vogël me mall drejt Italisë. "Këtë vit parcelat e kanabisit nga krahu i Memaliajt drejt Buzit janë sa ç'ishin në vitin 2016", i ka thënë qytetari, Berishës.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Batutat me banorët në Lurë, kryeministri: Ishalla më shkon puna ndryshe nga Mehmet Shehu

# Rama: Rruga e Arbrit e bukur për t'u bërë, por kafshatë e madhe në buxhet

## "Masa lehtësuese për ata që merren me agroturizëm, TVSH 6%"

Darina Tanushi

Nis sot zyrtarisht puna për ndërtimin e Rrugës së Arbrit në Dibër, ndërkohë që kryeministri Edi Rama premtoi dje edhe rikonstruksionin e rrugës që të çon në Lurë, një nga pikat turistike të zonës dhe të vendit. Gjatë një bashkëbisedimi me banorët e zonës së Lurës, i shoqëruar edhe nga e deleguara e qeverisë, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, Rama pati disa replika me banorët atje. Rama u kërkoi banorëve të fokusohen tek agroturizmi si një mundësi për të nxjerrë familjet e tyre, por edhe të gjithë zonën e Lurës nga varfëria. Ndërsa vetë qeveria do të ndihmojë duke kryer ndërhyrjen në rehabilitimin e banesave të vjetra. Një nga banorët i tha Ramës se ai ishte i dyti kryeministër që viziton Lurën pas Mehmet Shehut, ndërsa kreu i qeverisë ia ktheu një përgjigje aty për aty: "Ah, ishalla do shkojë ndryshe puna ime". Kryeministri foli për mundësitë e mëdha që jep zhvillimi i turizmit në këtë zonë. "Unë besoj shumë që agroturizmi është një mundësi e madhe dhe një potencial i jashtëzakonshëm, që ne nuk e kemi fare të shfrytëzuar dhe që duke e shfrytëzuar, një gjë është e sigurt, dalin nga varfëria të gjitha familjet që e bëjnë. Nuk ka asnjë mundësi që të jetosh me agroturizëm dhe të jesh i varfër", u shpreh Rama. "Ne kemi kaluar një masë shumë lehtësuese që, kush merret me agroturizëm, ka vetëm 6% TVSH. Pra, nëse ke një restorant, e ke 20% TVSH-në. Nëse ke një biznes çfarëdo, e ke 20% TVSH-në. Nëse ke një agroturizëm, ose një bujtinë në një fermë të vogël, ku ti ofron produktet që i bën vetë, ose produktet që bëhen rreth e rrotull në fshat e ke 6% TVSH-në dhe tatim-fitimin e ke vetëm 5%, sado të fitosh ti", sqaroi kreu i qeverisë. Rama premtoi se do të investohet edhe te rruga, duke u shprehur: "Duhet që ne të investojmë për rrugën dhe kjo na bëhet kafshata e dytë e madhe për buxhetin, se qenka e thënë që të gjitha kafshatat e mëdha ne t'i gëlltisim këtu në Dibër, se Rruga e Arbrit është e bukur për t'u thënë, është shumë e bukur për t'u bërë, por është një kafshatë shumë e madhe për t'u gëlltitur nga buxheti shteti. Edhe kjo rrugë është e bukur të thuhet dhe e bukur të bëhet, por nuk është kafshatë e lehtë, sepse kërkon një fond të konsiderueshëm dhe sigurisht që ajo që kthen mbrapa është shumë e madhe po ashtu". Më tej kryeministri bisedoi me banorët. Një prej vajzave që i përket shoqërisë civile për mbrojtjen e parkut të Lurës propozoi që rruga të bëhej deri lart në parkun e Lurës. Ndërsa kryeministri iu përgjigj, jo pa ironi: "Më the që ta çojmë rrugën deri në majë të malit. Unë jam me një mendim tjetër. Unë jam që në majë të malit të bëjmë edhe një pistë helikopterësh që të shkojmë edhe në qiell, por t'i bëjmë me radhë. Se fillimisht bëjmë rrugën për të ardhur këtu, pastaj patjetër që ta çojmë në majë të malit. Pastaj në majë të malit bëjmë dhe ndonjë teleferik, siç tha Adelina për të zbritur poshtë, duke rrëshqitur dhe duke parë bukuritë. Çështja është të jemi realistë dhe të kuptojmë mundësitë tona".



Kryeministri Edi Rama dje në Lurë

### BATUTAT GJATË TAKIMIT

**Banori** - Përshëndetje! Sot jemi mbledhur e gjithë Lura, të majtë e të djathtë. Unë dua të flas për dy pika të Lurës. Kam jetuar në Lurë tërë jetën. Lura vuan për rrugë. Lura vuan për drita. E deklaroj që në dimër, natë dhe ditë, pa u fikur 3 herë dritat nuk kanë ndenjur. E dyta, jam demokrat i orëve të para se kam qenë i persekutuar. Kam votuar gjithmonë kundra PS-së. Nëse ti do bësh një gjë për Lurën, ngelesh kryeministri më me shenjë për Lurën.

Kryeministri Rama: Tani, një pyetje kam unë. Atyre që ua ke dhënë votën pa pushim, të kanë dhënë gjë? Pse nuk e ndërrove njëherë?

**Banori:** - Jo, vetëm duke pasur emrin socialist, se asgjë s'më kanë bërë. Vetëm duke pasur emrin socialist, jam larg teje. Se ajo më ka luftuar mua.

Kryeministri Rama: Ty të ka luftuar komunizmi, nuk të ka luftuar socializmi.

**Banori:** Do ta them edhe një gjë. Nuk flas për interesa personale. Unë në atë kohë edhe ditën e diel punoja. Unë marr 5 mijë e 500 lekë pension dhe faleminderit Zotit për katër fëmijët që kam, se unë do vdisja për bukë. Nuk më ke asnjë faj ti, se as partia ime nuk mori asnjë masë. Jam i kënaqur se në atë kohë isha me pak vetë i persekutuar, tani jam me gjysmën e Shqipërisë i persekutuar. Sa ta marrë Saliu pushtetin, të gjithë ata të tutë i pushon dhe i le pa bukë. Sa ta marrësh ti, të gjithë ne, na ke pushu, na ke lënë pa bukë edhe jam i kënaqur se jam me gjysmën e Shqipërisë i persekutuar.

**Kryeministri Rama:** Ti thua i ke pushuar të gjithë, ata të mitë thonë "nuk dole gjë as ti se nuk pushove asnjë". Kështu që varet nga e sheh këtë punë.

**I riu:** Rrugën ta bësh nga Rrësheni, jo nga Dibra. Se nga Rrësheni lidhemi më shpejt me Tiranën

**Rama:** Po, ku të duash ti.

**I riu:** Jo ku të duash ti, se të njoh, i ke reklama të gjitha këto.

**Rama:** Çfarë reklame, ku i ke parë?

**I riu:** Të kemi dëgjuar shumë mirë.

**Rama:** Ndryshimi mes meje e teje është se unë i mbaj premtimet, ti s'ke punuar asnjë ditë.

**I riu**: Ka ardhur ministri yt, Lefter Koka para ca vitesh dhe premtoi projekt për rehabilitimin e rrugës. Ishte projekt 4 milionë euro, hodhi 4 kamionë me zhavorr dhe iku.

**Rama:** Të flas unë tani?

**I riu:** Po, fol.

**Rama:** Dorëzo mikrofonin se e kam unë radhën. Këto milionat e eurove i keni bërë si kokrra fasulesh. Unë thashë që duhen bërë kjo e kjo, nuk thashë që të bëjmë kulla e të mos bëjmë rrugët. Ku e dëgjove ti këtë, thashë e nisim nga ato që kemi mundësi. Ti i di të gjitha, unë di më pak se ty, por ti asnjë nuk di të saktë, unë ato që di, i di të sakta se ma do detyra, jo se jam më i zoti se ty, fillimi i punës me kullat është shumë i mundur dhe i duhur.

### PËRPARIM SPAHIU

Deputeti i LSI-së për Dibrën, Përparim Spahiu ironizoi dje vizitën e Ramës në Lurë. "Sot, z. 'Do Të' ishte në Lurë dhe sot pas pesë vitesh qeverisjeje, kuptoi që Lura ka nevojë për rrugë, ka nevojë për investime. Duke parë që ka premtuar shumë dhe ka shumë 'Do Të' për të bërë, ai dha një zgjidhje origjinale për Lurën. Meqenëse është e pamundur të shkosh me tunel atje, ai premtoi që turistët do t'i çojë me dron...".

## Xhaçka: Gati plani për zhvillimin e Lurës, dikur politikanët vinin vetëm për fushatë

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka theksoi dje gjatë bisedës me banorët e zonës se Lura është një vend që për shkak të rrugës shumë të keqe, distancës, izolimit vizitohet shumë rrallë, madje vizitohet rrallë edhe nga politikanët, vetëm në raste fushate elektorale dhe të zgjedhjeve. "Por sot - vijoi ajo - nuk kemi ardhur as për fushatë e as për zgjedhje, por kemi ardhur sepse kryeministri na ka bërë bashkë në një fushatë llogaridhënieje në të gjithë Shqipërinë, jo vetëm në qendrat e bashkive dhe njësive administrative, por kudo ku banojnë qytetarë që ne u shërbejmë për të bërë një diskutim sy më sy e ballë për ballë me gjithsecilin për shqetësimet, nevojat. Për të bërë një vlerësim të punës së qeverisë në këtë mandat të dytë qeverisës". Ministrja shtoi se, "kemi ardhur edhe për të folur për aspiratat për zonën dhe punët e investimet që do të bëjmë këtu në zonë". Ministrja Xhaçka u shpreh se, "para takimit bisedova me shumë prej jush dhe jam e kënaqur të dëgjoj që kanë interes për t'u kthyer në Lurë nga ata, që dikur për shkak të vështirësive u detyruan të shpërngulen në zona më të zhvilluara".



Sipas saj, prioriteti i qeverisë është t'i kthejë Lurës vëmendjen, atë që i takon. "Aspirata jonë dhe juaja për Lurën është një investim i gjithanshëm duke filluar nga rruga e asfaltuar, tek rrjeti i shpërndarjes së ujit të pijshëm, tek kanalizimet e ujërave të zezë, deri tek mbështetja që do t'i japim ekoturizmit, agroturizmit dhe atyre që janë vlera kryesore e kësaj zone si bujaria, mikpritja mes bujtinave, ushqimit të jashtëzakonshëm etj. At Gjergj Fishta ka thënë se nëse do të shohësh dhe njohësh Shqipërinë, patjetër duhet të shohësh dhe njohësh Lurën dhe bukurinë e saj të mahnitshme", u shpreh Xhaçka.

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**

**"Toke Are me sip 865 m2 , me Nr pasurie 131|86 Zona kadastrale nr 1896 , Volumi 9 , faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .**
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 336,000 (Treqind e tridhjete e gjashte mije) Lekë .

Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date 18.06.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

EPSA enforcement private service
SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

1 - Truall me sip. 100 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 1/460, Vol.42, Fq.74, e ndodhur ne Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te TIRANA BANK sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 5.375.520 LEKE. Ankandi do te zhvillohet ne date 28.06.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSA" shpk te ndodhur ne Rr "Ismali Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.
2 - Truall + Ndertese, me sip. 552 dhe ndertese 206.5 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 6/43, Vol.20, Fq.17, e ndodhur ne Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te TIRANA BANK sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 952.000 EURO. Ankandi do te zhvillohet ne date 13.07.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSA" shpk te ndodhur ne Rr "Ismali Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.
Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

**Shitje me Ankand te Dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

"Truall" me sip. 1,874m2 nga e cila 250 m2 eshte ndertese, me Nr. Pasurie 134/33,vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier. Regjistruar ne Z. R. P. P. Fier ne emer te Shoq. Albjon shpk. Çmimi fillestar per shitje eshte 6.180.854 Leke.

Data e shpalljes 15.05.2018
Data e zhvillimit 20.06.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

### Reagon ish-deputetja: Kjo pagesë nuk ka qenë kontribut vullnetar

# Bashkëshorti i Hafizit padit LIBRA-n, i kërkon kthimin e 25 mln lekëve



Biznesmeni Hasan Hafizi, pronar i kompanisë së ndërtimit të rrugëve "Albavia" dhe bashkëshorti i ish-deputetes Mimoza Hafizi ka paditur në gjykatë partinë LIBRA. Hafizi i është drejtuar me një kërkesë-padi gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku kërkon prej LIBRA-s 25 milionë lekë (të vjetra), si dhe bllokimin e financave. "Politiko.al" ka siguruar dokumentin e kërkesë-padisë së Hafizit, ku bie në sy fakti se kontrata nuk është nënshkruar mes tij dhe LIBRA-s, por ndërmjet biznesmenit Hafizi dhe pronarit të ndërtesës ku është strehuar partia politike për disa muaj.

**DORËHEQJA**
Ben Blushi, ish-kryetar i LIBRA-s dha dorëheqjen nga partia që e drejtoi vetëm pak kohë, por që e krijoi së bashku me Hafizin. Tashmë ai i është rikthyer profesionit të tij si pjesë e medias. Partinë LIBRA aktualisht e drejton një njësi e quajtur "Bërthama".

Përfaqësues të partisë Lista e Barabartë pohuan se po përgatisin një reagim dhe thonë se 25 milionët që kërkon z. Hafizi janë kontributi i tij vullnetar për partinë, në të cilën në atë kohë bënte pjesë si bashkëthemeluese bashkëshortja e tij, Mimoza Hafizi. Blushi dhe Hafizi e nisën LIBRA-n si një projekt të përbashkët pasi u larguan nga Partia Socialiste, pak para zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2017. Ndërkaq, në një sqarim të saj, ish-deputetja Mimoza Hafizi thotë se qiraja e godinës ku ka ushtruar aktivitetin LIBRA është paguar nga bashkëshorti i saj për shkak se kontrata ka qenë në emër të tij. "Përgjatë disa muajve, në vitin 2017, kjo parti ka mundur të paguajë vetëm tatimin mbi qiranë, pasi të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë nuk kanë arritur të mbulojnë pagesën e qirasë, detyrim ndaj qiradhënësit", sqaron Hafizi. Sipas saj, kjo pagesë nuk ka qenë asnjëherë e deklaruar si kontribut vullnetar. "Çdo pretendim ose tentativë nga kushdo për ta konsideruar pagesën e qirasë së LIBRA-s si kontribut vullnetar, është në shkelje të ligjit. KQZ duhet të kontrollojë deklaratat e kontributeve vullnetare të kësaj force politike", u shpreh Hafizi. Ajo sqaron se bashkë me një grup themeluesish dhe anëtarë të Partisë LIBRA, prej disa muajsh kanë nisur një proces gjyqësor ndaj akteve të rënda antiligjore të kryera nga një grusht njerëzish, që kanë uzurpuar këtë parti.

### Deputeti i PD tha se kryeministri e ka luftën për karrigen e vet, jo për negociatat

# Paloka: Rama shet Shqipërinë, por nuk mund të lëshojë Tahirin e Xhafajn

## "Për të është më e lehtë të mbushë vendin me terroristë"

Deputeti demokrat, Edi Paloka akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se është gati të shesë Shqipërinë, por jo Saimir Tahirin e Fatmir Xhafajn. Duke iu përgjigjur në distancë deklaratës së kryeministrit Edi Rama për azilkërkuesit shqiptarë në BE, bërë në intervistën e tij me portalin austriak "profil.at", Paloka tha dje se Rama nuk e ka "luftën" për negociatat, por për ruajtjen e karriges së tij. Një ditë më parë, kryeministri Rama është shprehur se nëse BE e vendos si kusht për hapjen e negociatave, atëherë qeveria shqiptare është gati të kthejë çdo azilant shqiptar në atdhe. "'Jam gati të bëj gjithçka për negociatat", - thotë Rama për median austriake. Në fakt është gati të bëjë gjithçka, përveç atyre që i kërkojnë të bëjë. Për të është më e lehtë të ngrejë kampe e të mbushë vendin me terroristë apo me refugjatë se sa të dorëzojë Tahirin dhe Xhafajn", u shpreh dje nënkryetari demokrat i Kuvendit. Sipas tij, Rama "është gati të vetofrohet (të ofrojë Shqipërinë në fakt) për armë kimike dhe plehra toksike, po nuk është gati të ndalë krimin e organizuar dhe trafikun e drogës. Fal detin dhe naftën e shqiptarëve, po nuk heq dot dorë nga koncesionarët dhe oligarkët e tij. Merr përsipër të dënojë me kthim në mjerimin e 'rilindjes' të qindramijë shqiptarëve që sot janë të detyruar të kërkojnë shpresën nëpër Evropë, por nuk merr përsipër të bëjë reformë zgjedhore e as drejtësi të pavarur, që t'ju japë shqiptarëve të drejtën të zgjedhin lirisht ata që duan t'i qeverisin. Me pak fjalë - shtoi më tej Paloka - Rama vetofrohet dhe është gati ta shesë e shkatërrojë këtë vend pa u menduar dy herë vetëm që mos i preket karrigia dhe xhepi i tij. Po sigurisht që edhe për këto 'fajin e ka opozita'!". Një ditë më parë, në këtë intervistë dhënë medias austriake, kryeministri u shpreh: "Nëse vonesa e hapjes së negociatave për Shqipërinë do ta ndihmonte Bashkimin Europian të frenonte rritjen e populizmit në BE, atëherë unë jam gati. Por ne kemi bërë gjithçka që BE na ka kërkuar të bëjmë. Ne e ndryshuam Kushtetutën në kompromis me opozitën, e cila nuk pajtohet me pothuajse asnjë çështje. Tani po vendosim në punë një sistem të ri emërimi për gjykatësit dhe prokurorët. Natyrisht, Shqipëria ka nevojë ende për shumë kohë për t'u bërë anëtare e BE-së, por ne nuk jemi aktualisht të interesuar për anëtarësim. Nisja e negociatave për pranimin do na ndihmonte për zbatimin e reformave". Ndër të tjera, Rama u shpreh se e ka të vështirë të kuptojë se pse vendimi i Komisionit të BE për të filluar bisedimet me Shqipërinë nuk duhet të jetë detyrues për shtetet anëtare. "Ne jemi gjithashtu të gatshëm t'i kthejmë bashkatdhetarët që banojnë ilegalisht në Francë, ose në vende të tjera të BE. Por besimi i shqiptarëve në BE dhe gjendja e mirë këtu do të dëmtohen. Nëse numri i refugjatëve rritet, ne presim ndihmë nga BE. Kjo është ajo që i thashë kancelarit federal Kurz në Vjenë", u shpreh Rama.



**EMIGRANTET**
"Merr përsipër të dënojë me kthim në mjerimin e 'rilindjes' të qindramijë shqiptarëve që sot janë të detyruar të kërkojnë shpresën nëpër Evropë, por nuk merr përsipër të bëjë reformë zgjedhore e as drejtësi të pavarur, që t'u japë shqiptarëve të drejtën të zgjedhin lirisht ata që duan t'i qeverisin", - tha Paloka.

**DEKLARATA E KRYEMINISTRIT**
"Ne jemi gjithashtu të gatshëm t'i kthejmë bashkatdhetarët që banojnë ilegalisht në Francë, ose në vende të tjera të BE. Por besimi i shqiptarëve në BE dhe gjendja e mirë këtu do të dëmtohen. Nëse numri i refugjatëve rritet, ne presim ndihmë nga BE. Kjo është ajo që i thashë kancelarit federal Kurz në Vjenë", u shpreh Rama.

**SHKURT**

### Alibeaj: A do të investojë Rama para të pista në "Air Albania" e aeroportin e Vlorës?

Partia Demokratike i ka kërkoi dje kryeministrit Rama të japë shpjegime nëse po investon para të pista të familjes së tij për aeroportin e Vlorës dhe kompaninë ajrore "Air Albania". Deputeti i PD-se, Enkelejd Alibeaj, tha dje nga selia e PD-së se: "E vërteta është se kompania e Sinan Idrizit u krijua me një fond qesharak vetëm 9 ditë para vendimit të firmosur nga Edi Rama, që e bëri Sinan Idrizin pronar në një biznes të përbashkët me qeverinë, siç është biznesi multimilioner i kompanisë ajrore "Air Albania". Një farë Sinan Idrizi, që thotë se është biznesmen i madh, pa pasur ndonjë biznes që mund ta tregojë, i ka dhënë dje borxh Edi Ramës emrin e tij për të lëshuar banalitete prej të forti në adresë të Partisë Demokratike". "Neuroza e re, që bashkëpunëtorët ia njohin si 'Makthi i Babales', i shfaqet Edi Ramës sa herë ai kapet nga opozita në afera gjigante korruptive, kriminale dhe klienteliste. Prandaj, pasi urdhëroi dy televizionet kombëtare të censurojnë opozitën për aferën korruptive të 'Air Albania', Edi Rama përdori emrin e Sinan Idrizit për të bërë si i fortë, duke kërcënuar opozitën me gjyqe dhe burg", u shpreh Alibeaj.

## Bushati në Durrës: Hapja e negociatave, mundësi për të rinjtë



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi zhvilluan një bashkëbisedim me studentët e Universitetit të Durrësit "Aleksandër Moisiu", ku diskutuan mbi procesin integrues të vendit në Bashkimin Evropian dhe përfitimet e të rinjve nga ky proces. Duke u ndalur tek procesi i integrimit evropian të Shqipërisë, ministri Bushati theksoi se vendit i duhet të hedhë hapa përpara në këtë proces, të përmbushë standardet dhe të punojë për transformimin e saj të brendshëm. "Hapja e negociatave shton mundësitë për të rinjtë për të studiuar dhe për të qenë pjesë e programeve të ndryshme në universitete evropiane, apo për punonjësit shkencorë e kërkimor për të bërë projekte të përbashkëta në këto institucione. Brezi i ri vendoset përballë një konkurrence të madhe, qoftë me vendet e rajonit, por edhe të BE-së. Ai tha më tej se përfitimet nga procesi integrues janë në të gjitha fushat si arsim, bujqësi, turizëm, mjedis, etj.", vijoi më tej ministri Bushati. Për sa i përket zhvillimit ekonomik të rajonit, ministri solli në vëmendje programet e BE-së, apo Fondet e Solidaritetit, që janë fonde të cilat vihen në dispozicion të zvogëlimit të hendeqeve ekonomike e shoqërore, që ekzistojnë brenda rajoneve të ndryshme të BE-së.

Taksa, pas sezonit turistik. Formula për banorët e Kukësit dhe pakti me bizneset e Kosovës

# Rruga e Kombit, 100 lekë për kuksianët, zbritje për përdoruesit e shpeshtë

## *Tarifa 5 euro, ja tri kategoritë që përfitojnë ulje*

Ornela Manjani

Grupi ndërministror qeveritar dhe kompania koncesionare e rrugës Milot-Morinë kanë përmbyllur procesin e negociatave, duke dalë me një formulë konkrete për tarifimin preferencial të banorëve të qarkut të Kukësit, autobusëve të linjës dhe përdoruesve të shpeshtë. Burimet nga grupi negociator bëjnë të ditur se të gjitha automjetet e regjistruara në qarkun e Kukësit do të paguajnë një tarifë prej 100 lekë me TVSH për një kalim. Përdoruesit e qarkut të Kukësit do të parablejnë përmes 'Telepass', në mënyrë të përshkallëzuar deri në 44 kalime në muaj me këtë tarifë të reduktuar. Reduktimi i tarifës do të aplikohet edhe për linjat e transportit publik, që kryejnë udhëtime nga dhe për në qytetin e Kukësit. Tarifa e tyre e kalimit do të jetë gjithashtu 100 lekë me TVSH për një kalim. Kategoria e tretë përfituese e tarifave të lehtësuara është ajo e përdoruesve të shpeshtë të rrugës, ku përfshihen qytetarët e Shqipërisë dhe ata të Kosovës, të cilët e përdorin aksin rrugor në mënyrë të vazhdueshme. Parimi i vendosur është ai i reduktimit të tarifës në varësi të numrit të udhëtimeve. Sa më shumë të udhëtosh, aq më shumë përfiton nga ulja. Fatura për politikat lehtësuese do t'i kaloje buxhetit të shtetit, i cili për 30 vite do t'i paguajë koncesionarit 48.5 milionë euro.



### APLIKIMI

Tarifa në Rrugën e Kombit do të rinisë në 17 shtator dhe për frekuentuesit e shpeshtë do të ketë ulje nga 10% deri në 40% në varësi të numrit të kalimeve në një muaj. Sa më shumë të udhëtojë një qytetar apo një biznes, aq më shumë ulje përfiton, e cila varion nga 10% në 40%. Tarifa e kalimit në rrugën Durrës-Kukës u vendos për herë të parë në fillim të muajit prill në masën 5 euro për një kalim ose 10 euro vajtje-ardhje. Kjo pagesë u kundërshtua nga banorët për të cilët në kontratën e koncesionit parashikohej që të kishte lehtësira, por vetëm 6 muaj pas hyrjes në fuqi të taksës derisa të identifikoheshin përdoruesit e shpeshtë. Kjo çoi në zemërimin e qytetarëve të Kukësit, të cilët dy ditë pas vendosjes së taksës protestuan duke djegur pikën e kalimit me pagesë. Pavarësisht këtyre lehtësirave, banorët e Kukësit dhe drejtuesit vendorë kanë kërkuar që pagesa për ta të jetë 0 lekë. Tarifa për qytetarët e tjerë do të mbetet 5 euro, por do të ofrohet ulje në bazë të numrit të frekuentimeve. Vendosja e tarifës u shty pas sezonit turistik, edhe si pasojë e kërkesës së bërë nga bizneset kosovare dhe përfaqësuesit e qeverisë, në mënyrë që të mos rezultonte një barrë më tepër për pushuesit që vijnë nga Kosova.

**ZBRITJE PËR PËRDORUESIT E SHPESHTË**

**1.**Nga 10 deri në 30 kalime në muaj,
përdoruesi i shpeshtë përfiton zbritje në masën 10%.
**2.**Mbi 30 deri në 50 kalime në muaj,
përdoruesi i shpeshtë përfiton zbritje në masën 20%.
**3.**Mbi 50 deri në 60 kalime në muaj,
përdoruesi i shpeshtë përfiton zbritje në masën 30%.
**4.** Mbi 60 kalime në muaj,
përdoruesi i shpeshtë përfiton zbritje në masën 40%.

## Unifikohet kontrolli doganor Shqipëri-Kosovë

Konfindustria mirëpret vendimet e Kuvendit të Kosovës për heqjen e lidhjes "roaming" në telefoni si dhe njësimin e kontrollit doganor në kufi ndërmjet 2 shteteve shqiptare. Gjithashtu, mbështetet nisma e qeverisë së Shqipërisë për njësimin dhe/ose heqjen e të gjitha pengesave të ashtuquajtura "jotarifore" me Kosovën. Konfindustria kërkon që nismat e mësipërme duhet të shndërrohen në një kohë sa më të shpejtë në vendime të prekshme për qytetaret dhe biznesin. Praktika e derisotme ka treguar që nisma të ngjashme politike kanë mbetur thjesht në letër dhe për më shumë bashkëpunimi ka bërë hapa pas. Konfindustria vlerëson se bashkëpunimi tregtar dhe ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është larg mundësive dhe pritshmërisë. "Në raste të përsëritura janë shfaqur edhe përplasje të mirëfillta të luftës së pastër tregtare. Përmendim rastet e produkteve bujqësore, çimentos, qumështit, birrës, miellit, etj. Vonesa dhe problematika janë shfaqur edhe në krijimin e tregut përbashkët energjetik, rrjetit rrugor, etj. ", - thuhet në reagimin e Konfindustrisë.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **“Shërbimi katering ne ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë 1 vjeçare”.**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **10,200,000 Lekë”.**

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **“Shërbimi katering ne ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë 1 vjeçare”**
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Korrik 2018, ora 10:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



ALBtelecom ...me ju të parët!

**Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.**

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizsshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

| Paketat Super | Super 500 | Super 700 | Super 1100 | Super 1300 | Gigastike | Super 1900 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Çmimi (me TVSH) | 500 Lekë | 700 Lekë | 1,100 Lekë | 1,300 Lekë | 1,300 Lekë | 1,900 Lekë |
| Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse) | 300 | 200 | 2500 | 3000 | 400 | 3500 |
| Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks | 300 | 400 | 500 | 3000 | 400 | 3500 |
| Minuta Ndërkombëtare | | | | 30 | | 60 |
| SMS drejt ALBtelecom Mobile | 300 | 400 | 1000 | 2500 | 400 | 3000 |
| SMS Kombëtare | | | 500 | 400 | | 300 |
| SMS Ndërkombëtare | | | | | | |
| Internet 3G/4G | | 300 MB | 3 GB | 5 GB | 5 GB | 12 GB |
| Internet 3G/4G+ | | | | | | 3 GB |
| Përfitime të tjera | | | | | 10 GB (Social & Chat) | |
| TV | | | | ALBtv Mobile | ALBtv Mobile | ALBtv Mobile |
| Vlefshmëria | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë |

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj.
Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

*Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123."*

### Ish-të dënuarit politikë duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë

# Ish-të përndjekurit, 295 përfituesit e dëmshpërblimit

## *Gati pagesat, dokumenti duhet dorëzuar brenda 15 ditëve*

Ornela Manjani

Ministria e Financave publikon listën e ish-të përndjekurve politikë, që duhet dorëzojnë numrin e ri të llogarisë për të përfituar dëmshpërblimin. Bëhet fjalë për dosje që janë shqyrtuar në vitet 2016 dhe 2017, por paratë nuk kanë shkuar në llogari të përfituesve, për shkak se ato kanë qenë të mbyllura. Janë 295 përfitues, të cilët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Dëmshpërblimeve numrin e llogarisë të përditësuar brenda 15 ditëve për të marrë dëmshpërblimin. Burime zyrtare nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se depozitat bankare, që çelen në emër të ish-të dënuarit politik apo familjarëve përfitues bëhen të disponueshme brenda 1 jave kalendarike nga çelja e tyre. Ministria e Financave njofton publikisht në media dhe nëpërmjet faqes së vet zyrtare për çeljen e llogarive. Ministria e Financave do të përndajë 2 miliardë lekë për kompensimin e ish-të përndjekurve politik gjatë këtij viti. Pagesat do të varën nga shqyrtimi i dosjeve nga Ministria e Drejtësisë. Financat kanë kryer deri tani pagesat për të gjitha dosjet e administruar prej saj. Vetëm në dy vitet e fundit llogaritet të shpenzohen 1.9 miliardë lekë në vit. Kështu, kategoria e parë u cilësua si kategoria parësore. Në këtë kategori u vlerësuan "gra, ish-të dënuara që jetojnë në momentin e pagesës". Në vijim, në kategorinë e dytë me prioritet u vlerësuan "persona ish-të dënuar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, që vazhdojnë të jenë gjallë", në kategorinë e tretë me prioritet janë "persona ish-të dënuar politikë të gjallë që vuajnë nga sëmundje të rënda", në kategorinë e katërt prioritet kanë "persona ish-të dënuar, që janë gjallë, të cilët pavarësisht moshës, në momentin e pagesës kanë fëmijë të mitur nën moshën 18 vjeç", në kategorinë e pestë me prioritet janë "persona ish-të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç", si dhe në kategorinë e gjashtë kanë prioritet "persona ish-të dënuar që janë gjallë dhe në momentin e pagesës nuk kanë mbushur 75 vjeç". Ky ndryshim në ligj ndodhi për t'u ardhur në ndihmë ish-të dënuarve, të cilët jetojnë dhe që ata të marrin dëmshpërblimin në një kohë më të shkurtër.




**LISTA EMERORE PER KTHIMET 2016-2017**

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Naim | Shyqyri | Liço | Mustaf | Bisho | Ujkaj | Zija | Ferit | Zaimi | Aleko | Jonuz | Aga | Ilia | Sotir | Toçi |
| Haziz | Muharrem | Hysa | Tahir | Bisho | Ujkaj | Fatmir | Xhelil | Ajazi | Adile | Fejzi | Kajo | Avni | Sabri | Koritari |
| Servete | Rexhep | Gocaj | Ermal | Ibrahim | Osmanaj | Gjistine | Shkurt | Ndreu | Kalem | Dalip | Ahmetaj | Eglaneina | Aristidh | Bollano |
| Fisnik | Edmond | Mero | Shefqet | Eahir | Xheleka | Lule | Marash | Probibaj | Kile | Rexhep | Vasha | Vasiliqi | Sofokli | Muhameti |
| Mirdash | Murat | Mystafa | Vergjinush | Ramadan | Lamove | Naim | Xhelil | Kalaci | Mehmet | Osman | Aga | Sokol | Hysen | Daka |
| Gani | Destan | Keta | Mihane | Ali | Gashi | Ndue | Zef | Dokaj | Migjen | Ali | Ahmetaj | Muharrem | Metush | Cekaj |
| Pamela | Bashkim | Shehu | Rozete | Sarandi | Ruco | Qamil | Ferik | Haxhiu | Natasha | Nuri | Imeraj | Eglaneina | Fejzo | Vrenozi |
| Eshref | Saip | Caco | Sabahete | Xhemal | Quku | Diana | Haki | Dani | Pranvera | Tasim | Veizi | juljan | Fejzo | Bajaj |
| Skender | Avni | Muçaj | Cesk | Ndue | Rrolba | Dritan | Vahid | Lama | Rabo | Nebi | Xhaferaj | Anton | Mark | Prenga |
| Emiljana | Kostandin | Grabocka | Bashkim | Xhelil | Kalaci | Kiço | Pilo | Miha | Jusuf | Beqir | Muka | Bibe | Mark | Prenga |
| Albert | Pal | Vushaj | Bukuri | Sulejman | Duro | Koço | Mihal | Ruco | Azbije | Lushi | Tafani | Elisabeta | Gjon | Anastasi |
| Nuredin | Meçan | Bresho | Kimete | Isuf | Osmani | Llokrati | Vangjel | Konomi | Balto | Loro | Hoti | Hilmi | Jakup | Rama |
| Edlir | Spiro | Strati | Fatime | Dine | Kamber | Marjo | Hasan | Roli | Demir | Xhelo | Xhika | Mimoza | Abdulla | Nine |
| Irma | Aqif | Shkembi | Mimoza | Fatmir | Gracari | Petro | Pilo | Miha | Fredi | Kole | Mane | Zija | Shyqyri | Toro |
| Liri | Livan | Ajasllari | Sefer | Selman | Gracari | Sabrije | Xhemal | Hoxha | Gjergj | Zef | Sinanaj | Avni | Kasem | Vora |
| Mirash | Pal | Paluka | Drita | Riza | Xhemalaj | Sadet | Abdulla | Beqirllari | Gjyste | Vate | Dakaj | Ismet | Kasem | Vora |
| Petro | Ilia | Nathanaili | Rrenj | Sadush | Hamataj | Spiro | Sarandi | Ruco | Hamide | Xhelo | Tafani | Hyqmet | Dervish | Lumani |
| Tefta | Feti | Hysa | Setki | Sali | Cami | Tanci | Gaqo | Ziko | Hati | Xhelo | Dragoti | Arshi | Kahreman | Vrioni |
| Zef | Ndue | Bardhoci | Silvana | Xhuma | Agushi | Donika | Fehmi | Nasufi | Jorgos | Lushi | Xhika | Ardian | Halim | Bodinaku |
| Dhurata | Enver | Haxhi(LICI) | Valentina | Ali | Bregu | Elpiniqi | Dhimitri | Nici | Kalem | Xhelo | Xhika | Hafife | Xhaferr | Valva |
| Zyle | Malo | Sinanaj | Vergjinush | Osman | Dvorani | Hajdar | Engjellush | Gremi | Livan | Xhelo | Xhika | Suzana | Safet | Keca |
| Qazim(koço) | Dajlan | Mustafa | Zare | Hekuran | Shake | Jani | Xhafer | Hasankolli | Lize | Zef | Zefi | Hafife | Haxhi | Demiri |
| Gjon | Bafti | Camaj | Behije | Bajram | Zekthi | Qamil | Sinan | Xhafa | Margarita | Themi | Sako | Valentina | Koli | Loti |
| Lumturi | Kajtaz | Babsuli | Dhimitraq | Andon | Lapa | Tefik | Riza | Hodaj | Mri | Vate | Dakaj | Andon | Llambi | Teno |
| Merzai | Hamza | Hamza | Valter | Andon | Lapa | Fitnete | Sulo | Murati | Qerim | Xhelo | Xhika | Feruze | Ali | Cela |
| Mexhit | Muharrem | Hoxha | Aferdita | Qerim | Lehman | Ilirjan | Estref | Sheko | Rusi | Mehmet | Ndreu | Lajde | Pal | Kokali |
| Pertefe | Hasan | Alizoti | Aferdita | Sami | Abdiaj | Kujtim | Shaban | Vidhi | Sanije | Mehmet | Braka | Muharrem | Haxhi | Karmaj |
| Fatmir | Shaban | Cela | Dhimo | Qerim | Hoxha | Sherife | Bajram | Dobra | Shaban | Abdyl | Narjaku | Musa | Haxhi | Karmaj |
| Fran | Llesh | Kola | Ilir | Ivzi | Sherolli | Valmira | Estref | Lasi | Vasil | Lushi | Xhika | Pashk | Ndue | Mjeshtri |
| Marije | Lleesh | Sutaj | Kristaq | Themistokli | Papa | Behije | Aziz | Sulmina | Zenel | Aqif | Xhika | Sadik | Ali | Doci |
| Medime | Selim | Hoxhallari | Manushaqe | Dalip | Kasa | Besnik | Uke | lluka | Ali | Mehmet | Xhika | Agron | Lufo | Toto |
| Viktor | Gjok | Nika | Vehit | Abdulla | Kullolli | Drita | Jonuz | Qosja | Dhimokrat | Pavllo | Shtrepi | Aqif | Musa | Dema |
| Vitore | Llesh | Ndoj | Adriatik | Qemal | Murrizi | Fize | Mahmut | Skenderi | Edije | Sabri | Gjata | Farije | Adulla | Tafaj |
| Adile | Shaban | Ndrijo | Fluturak | Avdulla | Kadilli | Flutura | Sulmina | | Lutfije | Haxhi | Kuqi | Robert | Dari | Badurri |
| Ibrahim | Hajdar | Balla | Gjela | Mark | Marku | Gezim | Eqerem | Kutrolli | Meleqe | Haxhi | Hoxha | Zekitija | Ibrahim | Jahija |
| Lavdije | Hasan | Taka | Naxhije | Ibrahim | Harabeli | Ilmi | Ramazan | Hoxha | Njazi | Alim | Dosti | Liljana | Sedet | Celsula |
| Ilmi | Sadik | Kulla | Rina | Zef | Gjikolaj | Klementina | Thomaq | Fundo | Pashako | Ded | Bracaj | Afrim | Veli | Zotaj |
| | | | Spiridhulla | Dhimitri | koka | Sami | Jonuz | Shehu | Ridvan | Alim | Dosti | Agim | Ymer | Haxhimusaj |
| Drita | Lushi | Bali | Fatbardha | Hysen | Smoqi | Sokol | Mark | Mardodaj | Sherife | Mehmet | Xhixha | Arben | Xhelal | Agolli |
| Feruze | Adil | Agolli | Murat | Enver | Malaj | Suada | Kudret | Hoxha | Zef | Fran | Pepushaj | Rozeta | Xhelal | Pillati |
| Antonjeta | Frederik | Mehmeti | Shpresa | Halil | Meta | Tefte | Eqrem | Duli | Jetnor | Qerim | Mucaj | Kristina | Ndrec | Marku |
| Idajet | Mersin | Jaçe | Ali | Tonus | Leshi | Vexhi | Eqrem | Kutrolli | Xhevahir | Musa | Pajaziti | Fatime | Sul | Shehu |
| Xhafer | Xhafer | Cejku | Aurora | Hydai | Haxhaj | File | Hill | Berhamaj | Polikseni | Dhimitri | Papa | Arsen | Ramazan | Uruci |
| Greta | Hamit | Cali | Avzi | Avzi | Hoxha | Marina | Hill | Lika | Janulla | Nikolla | Zharkalli | Athina | Ramazan | Selmanaj |
| Dylber | Ferid | Canaj | Hane | Hajdar | Fregjaj | Gjok | Frrok | Bajraktari | Llazar | Nikolla | Zharkalli | Ferial | Ramazam | Toshkollari |
| Mirela | Manoli | Kasara | Hava | Mahmut | Muca | Beqir | Xhezair | Rexhmati | Ola | Nikolla | Rapaj | Kurti | Rrahman | Uruci |
| Shkelqim | Ferid | Canaj | Lavdije | Hysni | Alushaj | Daniel | Genc | Pervizi | Theodhoraq | Pilo | Goçi | Mariana | Ramazan | Uruci |
| Mirela | Manoli | Kasara | Lavdim | Havzi | Hoxha | Demir | Shefqet | Kotorri | Valentina | Nikolla | Zharkalli | Theodhora | Ramazan | uruci |
| Ilmije | Jazo | Malaj | Nije | Ibrahim | Dashi | Kosta | Andon | Mitro | Rita | Qani | Memko | Shaban | Hasan | Hoti |
| Abdi | Ramazan | Gjoka | Denise | Ragip | Lohja | Mensur | Shuaip | Bekteshi | Zyra | Ramazan | Gjini | Zeqir | Aqif | Xhika |
| Fatime | Ramazan | Cela | Marash | Kole | Sokolaj | Ndrek | Gjergj | Gjinaj | Mirjeta | Adem | Linatopi | Sadik | Rizan | Vata |
| Sofije | Ramazan | Cela | Prel | Vate | Mani | Shqiponja | Ali | kotorri | Edmond | Hulo | Hajderi | Harun | Kadri | Hoxha |
| Zana | Ramazan | Zajmi | Susan | Ragip | Lohja | Xhetan | Avdil | Cejku | Naxhije | Ali | Turkeshi | Makbule | Kadri | Cullhaj |
| Agron | Reshat | Arapi | Ermira | Hysen | Kina | Zef | Pjeter | Xhajaj | Evjeni | Mihal | Huta | Naim | Kadri | Hoxha |
| Alije | Shyqyri | Janca | Liljsns | Ilia | Maka | Bukurije | Sefulla | Laho | Rrefael | Xhevat | Lishi | Rasim | Kadri | Hoxha |
| Elmas | Hekuran | Arapi | Altin | Lutfi | Hazizi | Katina | Dhimitri | Pano | Arsimo | Kolo | Cama | Shqipe | Kadri | Allushi |
| Ylber | Mestan | Gano | Ervehe | Ferit | Molosiu | Lene | Vuksan | Qehaja | Zade | Muçe | Ismajlaj | Islam | Qazim | Lokja |
| Kadri | Idriz | Kotorri | Menyr | Veli | Nelaj | Leonidha | Hysen | Laholli | Artur | Seit | Zajmi | Hasan | Loke | Sahiti |
| Xheme | Ibrahim | Veseli | Nazmije | Veli | Kurti | Zef | Vuksan | Perpali | Fridheriqi | Vasil | Glozheni | Kujtim | Adem | |

### 40-vjeçari Elidon Habilaj: Kush ju solli tek unë?

# Gazetarët e "Daily Mail" gjejnë në Vlorë ish-agjentin që mashtroi "FBI britanike"

**ANGLI** – Gazetarët e "Daily Mail" kanë zbuluar pas 6 vitesh vendndodhjen e një ish-agjenti shqiptar të inteligjencës britanike. Bëhet fjalë për Elidon Habilajn nga Vlora, i dënuar në mungesë nga drejtësia britanike. 40-vjeçari ka zënë faqet e mediave të këtij vendi, pasi ka arritur të mashtrojë për vite të tëra shërbimet e inteligjencës atje, duke qenë njëkohësisht një prej ish-oficerëve të inteligjencës së Agjencisë së Krimeve të Organizuar (SOCA). Mësohet se Habilaj mbërriti në Angli me kamion në vitin 1998 duke pretenduar se ishte shtetas kosovar. Ai përdori identitet të rremë dhe u hoq si Bekim Ademi. Duke treguar historinë e familjes së tij, shqiptari tha në atë kohë se vëllain ia kishin torturuar deri në vdekje, ndërsa babai i ishte varë gjatë luftës së Kosovës. Ndërsa fitoi të drejtën e qëndrimit në Britani, shqiptari mbajti një profil të ulët publik. Në nëntor të 2001, ai fitoi azil politik dhe shtetësinë britanike 5 vite më vonë (në 2006-ën). Elidon Habilaj u punësua fillimisht në polici (Scotland Yard) e më pas arriti të bëhej oficer i Agjencisë së Krimeve të Organizuar (SOCA) në Londër. Detyra e tij ishte të gjente kriminelë të dyshuar dhe të niste për ta procedurat e ekstradimit. "Daily Mail" shkruan se, pas kontrollit të dosjes së tij, autoritetet britanike zbuluan një bazë të dhënash dhe mashtrimin e shqiptarit, për të cilin u vendos dënimi me 18 muaj burg në mungesë në vitin 2013, ndonëse ai kishte arritur të arratisej më herët. Sipas "Daily Mail", Elidon Habilaj ka jetuar në arrati për 6 vite dhe shërbimet e inteligjencës britanike, për të cilat kishte punuar arritën ta gjenin në periferi të Vlorës pak javë më parë, aty ku mbikëqyrte ndërtimin e një resorti turistik në pronësi të tij. Ai nuk kishte vëlla, ndërsa babain e kishte gjallë. Gazetarët e "Daily Mail" kanë tentuar të kontaktojnë me të pak ditë më parë, por ai i ka përzënë duke i pyetur: "Kush ju ka dërguar? Kush ju solli këtu?". Duke iu referuar postimeve të tij në "Facebook", "Daily Mail" shkruan se shqiptari mburrej duke deklaruar se kishte një diplomë për master në kriminologji. Ai kishte ndërtuar jetën e tij në Shqipëri dhe ishte bërë baba, por hetimet për të nuk mbarojnë me kaq.

**ZBULIMI I HABILAJT**

Sipas "Daily Mail", shqiptari Elidon Habilaj u punësua nga Policia Metropolitane dhe më pas nga SOCA, ku punoi si oficer i inteligjencës dhe ishte pjesë e një grupi me bazë në Londër. Detyra e kësaj skuadre ishte që gjente kriminelë të dëbuar, në kërkim, për t'u ekstraduar. Ai u demaskua pasi kontrolloi dosjen e vet, në një database të punës rreth njerëzve me interes për autoritetet.



Elidon Habilaj

### Policia italiane: Viktimën e hodhi nga makina se nuk donte të paguante

# Vrasja makabre e Anxhela Meçanit, ndalohet e më pas lirohet i dyshuari

## *63-vjeçari nga provinca e Cuenos dyshohet të jetë klienti i fundit i 20-vjeçares*

**ITALI**

Një javë pas vrasjes makabre të 20-vjeçares Anxhela Meçani, e cila dyshohet të ishte punonjëse seksi, policia italiane ka ndaluar tri ditë më parë një person. Bëhet fjalë për një 63-vjeçar italian, i dyshuar si klienti i fundit i të resë shqiptare që u hodh nga një makinë në lëvizje mbrëmjen e së dielës së kaluar në Torino. Mediat e vendit fqinj shkruajnë se është sekuestruar edhe makina e italianit me banim në një provincë të Cuneos. Dyshohet se klienti e ka vrarë Anxhelën, pasi nuk donte të paguante paratë pas shërbimit. Pasi Anxhela i kërkonte me ngulm paratë, ai e ka shtyrë atë jashtë. Gjithçka është zbuluar nga kamerat e sigurisë. Ndërkaq, ndalimi dhe marrja në pyetje për disa orë i 63-vjeçarit italian nuk ka dhënë rezultatet e shpresuara nga hetuesit e çështjes. Pas një nate të tërë të kaluar në polici, 63-vjeçari është lënë i lirë, pasi për momentin autoritetet italiane nuk kanë mundur të sigurojnë të dhëna të mjaftueshme për arrestimin e tij. Pavarësisht lirimit të të dyshuarit, policia e vendit fqinj vijon hetimet për të kuptuar rolin që ka pasur 63-vjeçari në këtë krim, për të kuptuar mbi të gjitha si vdiq Anxhela, nga kush u përplas dhe përse. Ndryshe nga sa u dyshua dhe raportua në fillim se 20-vjeçarja shqiptare u dhunua barbarisht dhe më pas u hodh në rrugë nga një makinë në ecje, rezultatet e autopsisë i kanë hedhur poshtë të dyja këto versione. Sipas autopsisë së kryer nga mjeku italian Roberto Testi, caktuar nga prokurorët publikë Anna Maria Loreto dhe Livia Loçi, të cilët po hetojnë lidhur me rastin e shqiptares, ka rezultuar se ajo nuk është dhunuar para se të hidhej nga makina, shkruan "Torinotoday". Sipas mjekut ligjor, e reja është përplasur nga një automjet, që më pas është larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Kjo shpjegon edhe frakturat e shumta të gjetura në trupin e së resë, që duket se janë bërë nga impakti i përplasjes e jo nga dhuna dhe hedhja në rrugë. Kur u transportua për në spital, Anxhela mësohet se u foli mjekëve për një klient, që ndoshta nuk e kishte paguar dhe i tha se kishte rënë nga një automjet. *"Ai burri nuk më pagoi, pastaj rashë"*, mësohet të ketë artikuluar e reja. Kjo dhe rezultatet e autopsisë ngrenë hipotezën se klienti i së resë nuk ka pranuar ta paguajë dhe e ka zbritur atë nga makina. Më pas është nisur me shpejtësi duke e marrë përpara e duke e lënë për të vdekur në rrugë. Ishte një udhëtar i rastit që e gjeti të renë, por Anxhela vdiq më pas në spital. Falë tabulateve telefonike dhe pamjeve të kapura nga kamerat e sigurisë në rrugë, hetuesit mbërritën tek 63-vjeçari.



Viktima Anxhela Meçani

**BABAI I VIKTIMËS**

Vrasja makabre e Anxhela Meçanit ka tronditur familjarët e saj. Pak ditë pas ngjarjes së ndodhur në Torino të Italisë, ka reaguar babai i viktimës, Dritan Meçani. Mes dhimbjes së madhe, ai ka kërkuar drejtësi dhe zbardhjen sa më shpejt të ngjarjes. Në një intervistë për "GSH", babai i Anxhela Meçanit tregoi si e mësoi lajmin tragjik për vrasjen e së bijës



### Kërcënoi me jetë mësuesen italiane të djalit, bie në pranga shqiptari

**ITALI** – Një 50-vjeçar shqiptar në Itali është arrestuar, pasi ka kërcënuar me vdekje mësuesen e djalit të tij. Sipas mediave italiane, arsyeja që shqiptari e ka bërë këtë është sepse i biri nuk ka pranuar të ndjekë Institutin Profesional në qytetin e Milanos. Pasi 16-vjeçari i ka treguar të atit problemin e tij, ky i fundit ka marrë menjëherë në telefon mësuesen, duke e kërcënuar se do e vrasë. Pas kësaj, mësuesja italiane ka denoncuar rastin në polici, të cilët kanë trokitur në derën e shqiptarit për ta thirrur në polici. Tani 50-vjeçari ndodhet në ambientet e paraburgimit, pasi akuzohet për kanosje.

**SPANJE**

### Grabitën 43 banesa në Spanjë, shkatërrohet grupi kriminal me dy kapot shqiptarë



Autoritetet spanjolle kanë mundur të neutralizojnë grupin kriminal të njohur si "Babe Bands", që ka kryer grabitje në Spanjë, Itali dhe Shqipëri. Dy shtetas shqiptarë që u arrestuan të enjten e kaluar nga policia e Guardia Civil ishin kapot e organizatës për 43 grabitjet e bëra në provincat e Salamancës, Leonit, Valladolidit dhe Pontevedrës. Operacioni i njohur si "Banesa" filloi në prill, ndërsa pohohet se grabitësit hynin në shtëpi për të vjedhur bizhuteri të shtrenjta dhe para. Guardia Civil ka bërë hetimin dhe më pas arrestimet për dy shqiptarët të identifikuar si S.K., 35 vjeç dhe A M., 29 vjeç. Ata ishin të specializuar në grabitje dhe arrinin të bënin kërcënime me armë. Grabitja e fundit që bënë para se të arrestoheshin ishte tek një çift që kishte një djalë të vogël 10 vjeç.

### Policia: Aktiviteti kriminal shtrihej në Shkodër, Malësi të Madhe, Lezhë dhe Kurbin

# Shkatërrohet grupi i trafikut të drogës, bien në pranga 6 persona

## *Tregtimi i marijuanës maskohej nën aktivitetin e grumbullimit dhe shitjes së produkteve bujqësore*

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**

Një grup i strukturuar i trafikut të lëndëve narkotike është goditur nga policia dhe Prokuroria e Shkodrës. Pas një jave hetimesh intensive, u finalizua operacioni i koduar "West Univers" me arrestimin e 6 personave. Ndërsa, u sekuestrua një sasi prej 200 kg marijuanë. Gjithashtu, gjatë këtij operacioni që u zhvillua mesnatën e së premtes u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provave materiale edhe dy pistoleta, telefona celularë, radiomarrëse dhe automjete të përdorura nga autorët. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarku dje bënë me dije se kanë përfunduar në pranga shtetasit: Ardit Sali Haxhagiçi, 34 vjeç nga Shkodra; Fatbardh Simon Gostini, 37 vjeç nga Lezha; Neritan Sulejman Saraçi, 51 vjeç nga Shkodra; Rezart Xhelal Cacani, 34 vjeç nga Shkodra; Ramadan Mustafa Dushaj 61 vjeç nga Malësia e Madhe dhe Vilson Gjergj Ndoka, 27 vjeç nga Lezha. Ndërkohë, janë shpallur në kërkim edhe dy persona të tjerë. Bëhet fjalë për 30-vjeçarin F.M., i cili akuzohet për veprat penale "Prodhim dhe shitje lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje i armëve të zjarrit". Mësohet se ky shtetas ka qenë person me precedentë penalë dhe i arrestuar më parë për veprat penale "Kanosje", "Pengim apo dhunim ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike" dhe "Plagosje e lehtë me dashje". F.M. ka qenë i dënuar për veprat penale "Pengim i subjekteve zgjedhore" "Prodhim dhe mbajtje pa leje i armëve të zjarrit" dhe "Kanosje". Në kërkim është shpallur edhe 20-vjeçari S.N., që akuzohet për veprat penale "Prodhim dhe shitje lëndëve narkotike", "Prodhim dhe mbajtje pa leje i armëve të zjarrit", ndërsa ka qenë person me precedent penal dhe i arrestuar më parë për veprat penale "Kanosje", "Pengim apo dhunim ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike", "Plagosje e lehtë me dashje" si dhe ka qenë i dënuar për veprat penale "Pengim i subjekteve zgjedhore" "Prodhim dhe mbajtje pa leje i armëve të zjarrit" dhe "Kanosje". Policia në njoftimin e saj e quan një grup kriminal me rrezikshmëri të lartë, për shkak se e kishin shtrirë aktivitetin e tyre në Shkodër, Malësi të Madhe, Lezhë dhe Kurbin.


Operacioni antidrogë në Shkodër

**HETIMI**

Në datën 7 qershor 2018, Prokuroria e Shkodrës regjistroi procedimin penal mbi bazën e informacionit të dhënë nga policia se shtetasi Ramadan Mustaf Dushaj, lindur dhe banues në fshatin Dobre të Malësisë së Madhe, organizonte veprimtari për financimin dhe transportin e lëndëve narkotike në këtë qark. Nga informacioni i marrë në rrugë operative ka rezultuar se Dushaj kamuflonte veprimtarinë e paligjshme të tregtimit të lëndëve narkotike me aktivitet të grumbullimit dhe shitjes së produkteve bujqësore. 61-vjeçari kishte grumbulluar sasi të konsiderueshme lënde narkotike, për të cilën kërkonte treg shitjeje. Për këtë qëllim, ai mbante me vete mostra të lëndës narkotike, të cilën kërkonte ta shiste. Pas informacioneve të siguruara, me autorizim të prokurorisë, grupi hetimor lejoi aplikimin e metodave speciale të hetimit për sqarimin dhe zbulimin e këtij aktiviteti kriminal, duke arritur në arrestimin e 6 personave të mësipërm dhe sekuestrimin e 200 kg bimë narkotike e dyshuar si marijuanë.

**ARRESTIMI**

Sipas bluve, rreth orës 23:54 të së premtes, pranë vendit të quajtur kompleksi "Univers" në aksin Lezhë-Milot, shtetasit e arrestuar ishin bërë gati që të shkëmbenin sasinë prej 200 kg marijuanë. Në atë moment ka ndërhyrë policia. Të arrestuarit duke tentuar të shmangen kanë goditur me mjetet e tyre automjetet e policisë, veprim ky që ka vënë në rrezik jetën e efektivëve të pranishëm në vendngjarje. Në këtë grup kriminal të gjithë personat kanë pasur rolin e tyre, ndërsa pohohet se në një kohë të shkurtër kanë arritur të sigurojnë lëndën narkotike, me qëllim shitjen dhe trafikimin e saj. Gjatë zhvillimit të operacionit, këtyre personave përveçse drogës, u janë sekuestruar edhe 2 pistoleta tip "TT", 1 kuti me 20 fishekë pistolete, 1 automjet i markës "Benz Mercdes", 1 automjet i markës "BMW", 7 telefona celularë të markave të ndryshëm, dokumente të ndryshme të personave, 1 radio dhënëse-marrëse si ato të policisë dhe një sasi lekësh. Po të njëjtat burime sqaruan se një nga personat e arrestuar dhe konkretisht Vilson Ndoka rezulton se më përpara ishte shpallur në kërkim. Ndaj tij është dhënë masa e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale "Vrasje me dashje" e mbetur në tentativë dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake". Ndërsa, vijojnë hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

**OPERACIONI "WEST UNIVERS"**

**PERSONAT E ARRESTUAR**

1. Ardit Sali Haxhagici, i datëlindjes 15.03.1984 Shkodër.
2. Bardh Simon Gostini, i datëlindjes 01.04.1981 Lezhë.
3. Neritan Sulejman Saraçi, i datëlindjes 24.12.1967, Shkodër.
4. Rezart Xhelal Çarçani, i datëlindjes 24.04.1984, Shkodër.
5. Ramadan Mustafa Dushaj i datëlindjes 03.10.1957, Malësi e Madhe.
6. Vilson Gjergj Ndoka, i datëlindjes 26.11.1991, Lezhë.

**PERSONAT NË KËRKIM**

1. F.M., 30 vjeç, person me precedentë penalë.
2. S.N., 20-vjeç, person me precedentë penalë.


**NJOFTIM**

**SHPALLJA E VENDEVE TE PUNES PER ADMINISTRATOR**

**Universiteti i Mjekësisë, Tiranë shpall konkusin për tre pozicione pune:**

1. Administrator në Fakultetin e Mjekësisë
2. Administrator në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike
3. Administrator në Fakultetin e Mjekësisë Dentare

Afati i pranimit të dokumentacionit deri në datë **26.06.2018.**
Informacioni i detajuar për kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar gjendet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë **www.umed.edu.al** dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.


### Policia: 26-vjeçari qëlloi nënën e babain për para

## Vrasja e dyfishtë në Peshkopi, mjeku psikiatër për autorin: Ky qenka më në rregull se ne

**DIBËR** - Policia e Dibrës ka dyshime të forta se krimi i dyfishtë në familjen Sela, ku djali i sapokthyer nga Anglia vrau nënën dhe babain ka ndodhur për shkak të parave dhe se shëndeti mendor i 26-vjeçarit të jetë inskenuar prej tij pas ngjarjes së rëndë. I riu Qemal Sela dyshohet se ka debatuar nëpërmjet telefonit me familjarët e tij që kur ai ndodhej ende në kamp në Londër dhe priste deportimin. Burime nga policia bënë të ditur se gjatë vizitës paraprake të 26-vjeçarit te mjeku psikiatër, ky i fundit është shprehur me rezerva sa i përket gjendjes mendore të të arrestuarit për vrasjen e dyfishtë. Pas vendimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda që Qemal Sela të qëndronte përkohësisht në Spitalin e Burgut Tiranë, ai është dërguar për vizitë te mjekët specialistë. Oficerët që e kanë shoqëruar Selën te mjeku psikiatër



thanë se janë befasuar nga sjellja e tij, totalisht ndryshe nga çfarë kishin parë në Peshkopi. "Qemali iu përgjigj normalisht të gjitha pyetjeve të mjekut. U pyet për vitet e qëndrimit në Angli, punën e bërë atje, krimin e kryer, etj. Mjeku në fund u shpreh se: 'Ky qenka më në rregull sesa ne'. Kjo ka bërë që hetimet të marrin drejtim tjetër, pra të dyshohet se krimi është kryer me koshiencë nga ana e të riut. "Po përdoren metoda speciale të hetimit dhe shumë shpejt do të zbardhet e vërteta. Krimi është kryer me sa duket për shkak të harxhimit të kursimeve të 26-vjeçarit. Po ashtu, ai nuk ka qenë dakord me blerjen e një objekti tjetër, çka ka bërë që familja Sela të mos kishte lekë në gjendje", bënë të ditur burime nga policia e Dibrës. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se babai i tij, Flamur Sela e ka pritur të birin në Rinas ditën e kthimit nga Anglia. Ndërsa, mësohet se 26-vjeçari nuk ka pranuar të udhëtojë me taksinë e prenotuar nga i ati, por ka porositur një taksi tjetër dhe ka udhëtuar i vetëm drejt Peshkopisë. Gjithashtu, Qemal Sela ka refuzuar të udhëtojë dhe me vëllain, i cili kishte dalë për ta pritur në Maqellarë. Dyshohet se natën para ngjarjes, debati në familjen Sela ka qenë mjaft i ashpër. 26-vjeçari ka kërkuar llogari se ku janë përdorur paratë e tij dhe a ka lekë gjendje.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

# Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

## *Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuesit janë në qarkun e Korçë. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitet e kërkuesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatëse përgatit informacionin e kërkuar dhe njoftojnë subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera


FORMULAR APLIKIMI
INFORMIM NË LIDHJE ME ECURINË E DOSJES
SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN
SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN
SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

## KORÇË

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 172 | Pogradec | Barjam | | Mukollari | 476.6 | Me Vërtetim Kadastral Vërtetim e Faktit Juridik Vendimi ka Planvendosje |
| 309 | Pogradec | Arife | | Topçiu | 222 | Me Vërtetim Kadastral Vërtetim e Faktit Juridik Vendimi ka Planvendosje |
| 195 | Pogradec | Refki | | Malellari | 600 | Me Vërtetim Kadastral Vërtetim e Faktit Juridik Vendimi ka Planvendosje |
| 620 | Pogradec | Petro | | Kuruni | | |
| 222 | Pogradec | Metropolia | | Pogradec | | |
| 274 | Pogradec | Tomi | | Topalli | | |
| 29 | Pogradec | Petraq | | Divjaka | | |
| 11 | Pogradec | Mahmudi | | Shkullaku | 671 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 42 | Pogradec | Spase | | Çerepi | | |
| 284 | Pogradec | Vasilika | | Todolli | | |
| 250 | Pogradec | Rustem | | Sulollari | | |
| 307 | Pogradec | Skënder | | Manellari | | |
| 216 | Pogradec | Ismail | | Rapollari | | |
| 310 | Pogradec | Namik | | Hysenbegasi | | |
| 628 | Pogradec | Pajtim | | Mançellari | | |
| 626 | Pogradec | Zana | | Rapçe | | |
| 135 | Pogradec | Astrit | | Rexhollari | | |
| 334 | Pogradec | Mynevere | | Bajrami | | |
| 278 | Pogradec | Nuçi | | Gegprifti | 28 | Me Dokument të Arkivor Palnvendosja e Vendimit pa Firmë dhe pa Vulë |
| 627 | Pogradec | Gafer | | Bega | | |
| 1 | Pogradec | Agron | | Minarolli | 2018 | Me Dokument të Arkivor |
| 23 | Pogradec | Rajmond | | Jasharllari | | Me Vërtetim të Faktit Juridik |
| 101 | Pogradec | Shaban | | Olldashi | | Me Vërtetim Arkivor dhe me Vërtetim Arkivor |
| 630 | Pogradec | Dylbere | | Blaceri | | Nuk Ka Asnjë Dokument Ligjorë Pronësie |
| 1213 | KORCE | AHMET | | MULLAJ | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | |
| 1174 | KORCE | XHELADIN | | PILLATI | 1700TR | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESHILLIT TE RRETHIT KORCE |
| 1389 | KORCE | VALENTINA | | NIKA | 2000 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESHILLIT TE RRETHIT KORCE |
| | KORCE | POLIKSENI | | KASHARI | 500 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESHILLIT TE RRETHIT KORCE |
| 1389 | KORCE | KRISTO | | PRIFTI | 50 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESHILLIT TE RRETHIT KORCE |
| 1452 | KORCE | SPIRO | | PENGO | 2564 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESHILLIT TE RRETHIT KORCE |
| 1268 | KORCE | MIRDASH | | TEROLLI | 5016 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESHILLIT TE RRETHIT KORCE |

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1293 | KORCE | SOTIR | | BRUKO | 152 | KA PL. VENDOSJE |
| 1289 | KORCE | HAKI | | HADERLLARI | 10100 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KOM.VRESHTAS |
| 1298 | KORCE | BESIM | | PETRITI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1320 | KORCE | ILIA | | EMANUEL | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1327 | KORCE | SERVETE | | BRAHOLLI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1455 | KORCE | GJERGJI | | KOTA | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1460 | KORCE | MUHAMER | HALIM | SINANI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1393 | KORCE | MYQEREM | | KULLA | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1390 | KORCE | OSMAN | | RAMOLLI | 100 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KOM. |
| 1199 | KORCE | KOCI | | AZISLLARI | 2800 | KA PLAN VENDOSJE TE KOMUNES GORE |
| 1197 | KORCE | VULLNET | | BENDO | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1185 | KORCE | QIRJAKO | | KOROVESHI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1190 | KORCE | ANDREA | | DHIMITRI | 300 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESH RRETHIT KORCE |
| 1021 | KORCE | RINI | | BREGU | 7700 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESH RRETHIT KORCE |
| 1170 | KORCE | VASKE | | KOLACI | 10100 | KA SKICE TE SEKSIONIT TE URBANISTIKES TE KESH RRETHIT KORCE |
| 1169 | KORCE | VASKE | | KOLACI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| | KORCE | VASKE | | KOLACI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1009 | KORCE | GJYLIZARE | | KOCIBELLI | 150 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1008 | KORCE | RAMADAN | | PRISOI | 800 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1040 | KORCE | BUJAR | | SELFOLLARI | 700 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1063 | KORCE | ZIJA | | LEPI | 4754 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1092 | KORCE | AMBELI | | DUCI | 5724 | PRETENDIM BAZUAR VETEM NE VFJ |
| 1094 | KORCE | FETAH | | KOCIBELLI | 300 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1102 | KORCE | THIMI | | VESHI | 212 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1102 | KORCE | THIMI | | VESHI | 288 | KA PLAN VENDOSJE TE SEKSIONIT TE KESHILLIT RRETHIT KORCE |
| 1103 | KORCE | EVGJENI | | THIMO (METOLLI) | 320 | KA PLAN VENDOSJE |
| 1106 | KORCE | HEKURAN | | HAJDARI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 1168 | KORCE | VASKE | | KOLACI | TE MOS MIRATOJE KERKESEN | MUNGESE DOKUMENTACIONI |
| 327 | Pogradec | KOSTAQ | ZISI | KRESTE | Refuzim kerkese | |
| 326 | Pogradec | Fazlli | | Kromollari | Refuzim kerkese | |
| 328 | Pogradec | Hysen | Seit | Pera | Refuzim kerkese | |
| 56 | Pogradec | Rexhep | | Yzeiri (Elmasllari) | | |
| 41 | Pogradec | Llazi | Koli | Turshinka | Refuzim kerkese | |
| 9 | Pogradec | | | | Refuzim kerkese | |
| 88 | Pogradec | Enver | | Hoxhallari | Refuzim kerkese | |
| 79 | Pogradec | | | | 16 211 m2 | |
| 74 | Pogradec | Shpetim | Ahmet | Çollaku | | |
| 68 | Pogradec | Bajram | Kadri | Bono | | |
| 64 | Pogradec | Azis | Kadri | Biba | Refuzim kerkese | |
| 96 | Pogradec | Ali | | Muço | Refuzim kerkese | |
| 95 | Pogradec | Xhelal | Shebi | Muçllari | Refuzim kerkese | |
| 60 | Pogradec | Kopi | Sotir | Shkurti | Refuzim kerkese | |
| 97 | Pogradec | Omer | Ruzhdi | Ibi | | |
| 93 | Pogradec | | | | | |

## KORÇË

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 50 | Pogradec | Pavli | Filip | Vako | 35 497 m2 | |
| 246 | Pogradec | Mustafa | | Mucllari | 38 805 m2 | |
| 358 | Pogradec | Liljana | | Qafzezi | 3000 m2 | |
| 309 | Pogradec | Banush | | Matelli | 103 255 m2 | |
| 260 | Pogradec | Makbuke | Selman | Avdullari (Kreka) | 45 734 m2 | |
| 307 | Pogradec | Anila | | Zeqollari | 9849 m2 | |
| 395 | Pogradec | Adem | Selim | Rapçe | 30 000 m2 | |
| 2 | Pogradec | Filip | Klime | Petre | 1336 m2 | |
| 198 | Pogradec | | | | 3160 m2 | |
| 201 | Pogradec | Petro | Zisi | Çobani | | |
| 346 | Pogradec | | | | 7122 m2 | I eshte njohur e drejta e prablerjes se objektit me sip. 2631 m2 si dhe sheshet funksionale |
| 310 | Pogradec | Pandeli | | Kollcaku | 1602 m2 | |
| | | Pandeli | | Kollcaku | 34 555 m2 | |
| 268 | Pogradec | Margarita | Zisi | Gusho (Angjo) | | |
| 224 | Pogradec | Ferit | | Rexhollari | | E drejte parablerje per objektet e ujembledhesit |
| 350 | Pogradec | | | | | E drejte parablerje per objektet e minieres me sip. 1672 m2 |
| 46 | Pogradec | | | | 8590 m2 | |
| 349 | Pogradec | Fiqiri | | Palla | | E drejte parablerje objekte hekurudha me sip. 3873 m2 |
| 142 | Pogradec | Syrja | | Seitllari | Refuzim kerkese | |
| 84 | Pogradec | Durim | | Corbaxhiu | | |
| 336 | Pogradec | Agim | | Lipo | 720 m2 | E drejte parablerje centrali telefonik me sip. 306 m2 |
| 252 | Pogradec | Defrim | | Mucllari | 14 096 m2 | E drejte parablerje objektit 2629 m2 |
| 203 | Pogradec | Mehmet | | Isufi | 181 396 m2 | |
| 125 | Pogradec | | | | | |
| 155 | Pogradec | Namik | | Bardhi | 22 948 m2 | E drejte parablerje e objektit me sip. 485 m2 |
| 45 | Pogradec | Kolo | | Mato | | E drejte parablerje e objektit me sip. 1800 m2 kur te privatizohet. |
| 186 | Pogradec | Gjergji | Kristaq | Mehilli | | |
| 114 | Pogradec | Fari | | Alinji | | |
| 341 | Pogradec | Qazim | | Seitllari | | E drejte parablerje e objekteve me sip. 2400 m2 |
| 340 | Pogradec | Fidarije | | Abasllari | | E drejte parablerje e objekteve dhe te shesheve funksionale te tyre me sip. 1151 m2. |
| 199 | Pogradec | Hajrica | Dhimo | Bicja | | |
| 157 | Pogradec | Piro | | Hila | | |
| 280 | Pogradec | | | | | |
| 5 | Devoll | Petro | | Nishe | | |
| 3 | Devoll | | | | | |
| | | | | | 4178 m2 233 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 10 | Devoll | Njazi | Neshat | Lumi | | Neshat Njazi Lumi kompensohen per 1/3 e 108 000 m2 pra 36 000 m2. Trashegimtaret e Skender Lumit kompensohen per 1/12 pra 9000 m2. Donika Lumi kompensohet per 4000 m2. |
| 9 | Devoll | Gazmend | | Menkulazi | Refuzim kerkese | |
| | | Sahadet | | Menkulazi | 2380 m2 | |
| 8 | Devoll | Trashegimtaret Tytymçe | | Trashegimtaret Tytymçe | | |
| | | Thimi | | Tytymçe | 600 m2 | |
| 7 | Devoll | Kosta | | Cili | | |
| 6 | Devoll | Sefer | | Tarelli | | |
| 4 | Devoll | Viktor | Kosta | Rado | Refuzim kerkese | |
| 2 | Devoll | Zeqir | | Hoxha | | |
| 1 | Devoll | Lefter | | Shaholli | | |
| 60 | Devoll | Florenc | | Gruçka | 1942 m2 | |
| 27 | Devoll | Jorgji | | Karamitro | 195.7 m2 | |
| 56 | Devoll | Vasil | | Dogramaja | 1200 m2 | |
| 54 | Devoll | Agron | | Frasheri | 381.3 m2 | |
| 75 | Devoll | Emine | | Ajçe | shtepi truall 1500 m2 | |
| 35 | Devoll | Selime | | Tolaj | | |
| 43 | Devoll | Petro | | Tomorri | 487.35 m2 | |
| 34 | Devoll | Fatjona | | Muça | | |
| 28 | Devoll | Sabiko | | Sulo | Dyqan truall 55 m2 98 m2 1178 m2 | Vendimi ka planvendosje |
| 63 | Devoll | Gurali | | Doko | 3844 m2 | |
| 47 | Devoll | Fehmi | | Berberi | 273 m2 | |
| 38 | Devoll | Hafis | | Aliçkolli | 547.3 m2 | |
| 53 | Devoll | Feim | | Mero | 369.2 m2 | |
| 52 | Devoll | Mitat | | Mero | 432 m2 | |
| 107 | Devoll | Elisen | | Karanxha | 4226.5 m2 | |
| 58 | Devoll | Osman | | Mullaj | 499.5 m2 1000 m2 | |
| 61 | Devoll | Avdyl | | Topalli | 2026 m2 | |
| 45 | Devoll | Astrit | | Kello | 301 m2 275 m2 3992 m2 | |
| 44 | Devoll | Esma | | Ajçe | 2226 m2 3950 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit. Vendimi nuk ka marre forme te prere. |
| 37 | Devoll | Tahrije | | Kapshtica | 207 m2 | |
| 48 | Devoll | Fuat | | Shehu | 610 m2 96 m2 96 m2 | |
| | | | | | Refuzim kerkese | |
| 82 | Devoll | Fatime | | Galo | 974.5 m2 2000 m2 | Neni 21 e drejte parablerje. |
| 39 | Devoll | Doko | | Doko | 52.5 m2 | |
| 1 | Devoll | Ilir | | Muzho | | Vendimi fotokopje |
| 6 | Devoll | | | | | Vendimi fotokopje |
| 16 | Devoll | Roland | | Mero | | |
| 26 | Devoll | Spiro | | Toçka | 128.15 m2 | |
| 88 | Devoll | Vexhie | | Maho (Cuko) | 337 m2 611 m2 573 m2 822 m2 | |
| 24 | Devoll | Velisha | | Mytkolli | 235.19 m2 | |
| 65 | Devoll | Servet | | Ago | 1375 m2 351 m2 783.5 m2 | Neni 21 e drejte parablerje. |
| 36 | Devoll | Panajot | | Pilafi | 700 m2 | |
| 42 | Devoll | Alim | | Hoxha | 1000 m2 1820 m2 3598 m2 672 m2 | |
| 23 | Durres | Bajram | | Veli | S'ka | |
| 325 | Devoll | Stavrulla | | Grazhdani | 165.9 m2 | |
| 29 | Devoll | Ollga | | Feri | 206 m2 | |
| 51 | Devoll | Avni | | Zuruku | 1190 m2 | |
| 157 | Devoll | Fevri | | Muçi | 1000 m2 3000 m2 | Neni 21 e drejte parablerje e objekt. Me sip. 1356 m2 |
| 40 | Devoll | Spiro | | Pavliqi | 489 m2 | |
| 41 | Devoll | Shefki | | Yzeiri | 2700 m2 | |
| 62 | Devoll | Mukades | | Agolli | 288 m2 | |
| 25 | Devoll | Ligoraq | | Gjylameti | 406 m2 | |
| 725 | Devoll | Nikolla | | Vano | 192 m2 | |
| 723 | Devoll | Pashako | | Zhgaba | 8375 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 724 | Devoll | Gure | | Bajraktari | 300 m2 120 m2 | |
| | | | | | 786 m2 120 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 722 | Devoll | Dhionis | | Papa | 2151 m2 | Neni 21 e drejte parablerje 1731 m2 |

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 711 | Devoll | Alush | | Bufi | 2500 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 714 | Devoll | Seadet | | Dule | 250 m2 300 m2 4000 m2 | |
| 713 | Devoll | Zihni | Feime | Hoxha | 4000 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 718 | Devoll | Pembe | | Lilka | 690 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| | | | | | 1170 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 716 | Devoll | Rushit | | Xhaholli | 2520 m2 | |
| 715 | Devoll | Myqerem | | Bajraktari | 114 m2 | |
| 720 | Devoll | | | | 1000 m2 1500 m2 1000 m2 | |
| 719 | Devoll | | | | 3000 m2 500 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit. E drejte parablerje e objekteve mbi sip. 3000 m2. |
| 717 | Devoll | | | | 1500 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit. |
| 721 | Devoll | Servete | | Mancka | 5400 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose tia riblej truallin pronarit. |
| 726 | Devoll | | | | 2510 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose tia riblej truallin pronarit. |
| 728 | Devoll | | | | 12 000 m2 | |
| 727 | Devoll | | | | 2000 m2 | |
| 730 | Devoll | Femije | | Bablusha | 1155 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose tia riblej truallin pronarit. |
| 729 | Devoll | | | | 2966 m2 | Neni 12 ti paguaj qera ose tia riblej truallin pronarit. |
| 712 | Devoll | | | | 700 m2 1800 m2 | |
| 84 | Devoll | Emin | Feim | Rushitaj | | |
| 79 | Devoll | Haxhire | | Çurko | | |
| 83 | Devoll | Zylfije | | Skermo | | |
| 80 | Devoll | | | | | |
| 87 | Devoll | Gurali | | Demiraj | | |
| | | Gurali | | Demiraj | 600 m2 344 m2 | |
| 88 | Devoll | Hysen | | Shytko | | |
| 89 | Devoll | Ali | | Zhula | | |
| 86 | Devoll | Hekuran | | Zenelaku | | |
| 78 | Devoll | | | | | |
| 85 | Devoll | Qezap | | Ocka | | |
| 482 | Devoll | Qezap | | Ocka | 1000 m2 | |
| 77 | Devoll | Sherife | | Mero | | |
| | | Sherife | | Mero | 1411 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit. |
| 76 | Devoll | Eleni | | Plaku | | |
| 75 | Devoll | Lirije | | Zypçe | | |
| 82 | Devoll | Ylvije | | Talelli | | |
| 93 | Devoll | Sabri | | Lico | 216 m2 240 m2 420 m2 | |
| 84 | Devoll | Njazi | | Tale | 2940 m2 | |
| 83 | Devoll | Josif | | Nisha | Refuzim kerkese | |
| 92 | Devoll | Ismet | | Nurçe | 300 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit. E drejte parablerje e objekt. qe ze sip. 525 m2. |
| 98 | Devoll | Zydi | | Lima | 500 m2 | |
| 91 | Devoll | Thoma | | Ceko | 324 m2 | |
| 94 | Devoll | Hasan | | Dede | 299 m2 | E drejte parablerje e maternitetit |
| 85 | Devoll | Hamide | | Bajraktari | 520 m2 600 m2 | Neni 12 t'i paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit. E drejte parablerje e objekt. Qe ze sip. 525 m2. |
| 90 | Devoll | Bardhyl | | Jazxhi | 2000 m2 340 m2 | |
| 95 | Devoll | Vebi | | Riza | 300 m2 200 m2 | |
| 88 | Devoll | Sali | | Musa | 537 m2 1259 m2 522 m2 471 m2 | |
| | | Sali | | Musa | 100 m2 1270 m2 200 m2 200 m2 450 m2 600 m2 | |
| 89 | Devoll | Hafize | | Spaho | | |
| 97 | Devoll | Zylfie | | Hoxha | 1000 m2 420 m2 | Neni 21 e drejte parablerje e objektit |
| | | Zylfie | | Hoxha | 2875 m2 | E drejte parablerje e objektit |
| | | Zylfie | | Hoxha | 1000 m2 | |
| 123 | Devoll | Mitat | | Mero | 1120 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 124 | Devoll | Femi | | Mero | 1200 m2 | |
| 116 | Devoll | Memedie | | Hyska | 500 m2 1000 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 117 | Devoll | Hysni | | Sejdo | 4000 m2 | |
| | | Hysni | | Sejdo | 500 m2 1000 m2 | Neni 21 e drejte parablerje |
| 118 | Devoll | Hasan | Emin | Skermo | 725 m2 | |
| 126 | Devoll | Idajet | | Zotolli | 60 m2 936 m2 | |
| 125 | Devoll | Zazbije | | Zotolli | 400 m2 1300 m2 | |
| 119 | Devoll | Myrvet | | Xhaho | 480 m2 30 m2 1347 m2 189 m2 | |
| 120 | Devoll | Hekuran | | Jajolli | 725 m2 | |
| 121 | Devoll | Qemal | | Sabri | 1000 m2 | |
| 122 | Devoll | Ollga | | Gjata | 734 m2 | |
| 295 | Devoll | Gazi | | Kollcinaku | | |
| 297 | Devoll | Sabri | | Spaho | | E drejte parablerje e objektit me sip. 3105 m2 |
| | | Sabri | | Spaho | 1000 m2 600 m2 700 m2 168 m2 | |
| 288 | Devoll | Ilia | | Karafil | | |
| 296 | Devoll | Haxhire | | Agastra | Refuzim kerkese | |
| 289 | Devoll | Najada | | Lici | | |
| 290 | Devoll | Hasan | | Becolli | | |
| 291 | Devoll | Perfaq. I Komunitetit Bektashian | | Perfaq. I Komunitetit Bektashian | Refuzim kerkese | |
| 293 | Devoll | Nafije, Kadri | | Spaho | | |
| 298 | Devoll | Farije | | Shaholli | | |
| 300 | Devoll | Hysen | | Orhan | | |
| 301 | Devoll | Thoma | | Bogdani | | |
| 302 | Devoll | Lida | | Tiko | | |
| 146 | Devoll | Vaske | | Rado | | |
| 145 | Devoll | Pandi | | Bimo | | |
| 153 | Devoll | Sefedin | | Xhuti | | |
| 154 | Devoll | Fitret | | Metolli | | E drejte parablerje objekt. |
| | | Fitret | | Metolli | 228 m2 | |
| 143 | Devoll | Rinka | | Peti | | |
| | | Rinka | | Peti | 70 m2 168 m2 132 m2 | |
| 147 | Devoll | Kristofor | | Zhuka | | |
| | | Kristofor | | Zhuka | 40 m2 36 m2 | |
| 152 | Devoll | Xhevat | | Avdyl | | |
| | | Xhevat | | Avdyl | 150 m2 224 m2 | |
| 151/1 | Devoll | Angjeli | | Qeleshi | Refuzim kerkese | |
| 150 | Devoll | Krist | | Tytymçe | | |
| 151 | Devoll | Anxheli | | Qeleshi | | |
| 149 | Devoll | Mitat | | Zhupani | | |
| 148 | Devoll | Jovan | | Zoto | Refuzim kerkese | |
| | | Jovan | | Zoto | 452 m2 330 m2 45 m2 179 m2 | |
| 144 | Devoll | Fiqiri | Zenel | Hysi | | |
| - | - | Fiqiri | Zenel | Hysi | 480 m2 1600 m2 | |
| 142 | Devoll | Albert | | Papa | Refuzim kerkese | |
| 141 | Devoll | Demir | | Keco | | |

## KORÇË

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 140 | Devoll | Irfan | | Spaho | | |
| | | Irfan | | Spaho | 4500 m2 300 m2 616 m2 625 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 139 | Devoll | Dhora | | Talluri | | |
| | | Dhora | | Talluri | 187 m2 100 m2 | |
| 138 | Devoll | Izaet | | Meço | Refuzim kerkese | |
| 345 | Devoll | Refire | | Kape | | |
| | | Refire | | Kape | 1000 m2 2000 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblej truallin pronarit |
| 317 | Devoll | Nazmi | | Mulla | | Neni 14 pika c e drejte parablerje |
| 318 | Devoll | Angjeli | Kiço | Xole | | |
| 320 | Devoll | Andoneta | | Morava | | |
| | | | | | 29.5 dy | |
| 332 | Devoll | Aristidh | | Mihal (Goxha) | | |
| 333 | Devoll | Zarif | | Spaho | | |
| 337 | Devoll | Mazar | | Fifo (Nuri) | | Mezar Fefa |
| 341 | Devoll | Agim | | Hyska | | |
| 346 | Devoll | Perparim | | Hyska | Te mos I njohe te drejten e kompensimit | |
| | | Yrmet | | Hyska | 6000 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 219 | Devoll | Spiro | | Shopi | | Pa planvendosje |
| 218 | Devoll | Sulejman | | Rusi | | pa planvendosje |
| 220 | Devoll | Nazmi | | Mulla | | Pa planvendosje |
| 221 | Devoll | Osman | | Mulla | | Pa planvendosje |
| 216 | Devoll | Selajdin | | Meka | | Pa planvendosje |
| 217 | Devoll | Berti | | Palloi | Refuzim kerkese | |
| 215 | Devoll | Petraq | | Zoto | Refuzim kerkese | |
| 214 | Devoll | Serveri | | Maho | Refuzim kerkese | |
| 213 | Devoll | Emine, Haki | | Muka | | Pa planvendosje |
| 212 | Devoll | Emine | | Muka | | Pa planvendosje |
| 211 | Devoll | Fani Qirjako Vangjel | | Bleta | | Pa planvendosje |
| 226 | Devoll | Abasali | | Jazxhi | | Pa planvendosje |
| 222 | Devoll | Lida | | Malollari | Refuzim kerkese | |
| 128 | Devoll | Trash. | | Spaho | 1684 m2 | |
| 135 | Devoll | Trash. | | Sino | | E drejte parablerje e angarit |
| 136 | Devoll | Trash. | | Spaho | 500 m2 | Besim Haxhi |
| 137 | Devoll | Skender | | Topalli | 3500 m2 3500 m2 | |
| 140 | Devoll | Yrmet | | Agastra | 871 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 127 | Devoll | Mehmedi | | Merolli | 1500 m2 2000 m2 500 m2 | |
| 132 | Devoll | Nezhdat | | Zhulaku | 1088 m2 1320 m2 | Neni 21 e drejte parablerje per 320 m2 |
| 129 | Devoll | Neki | | Staro | | |
| 130 | Devoll | Remzi | | Hoxha | 2500 m2 1657 m2 250 m2 | |
| 131 | Devoll | Nazmi | | Musa | 1300 m2 1400 m2 300 m2 | |
| 133 | Devoll | Shaban | | Hoxha | | E drejte parablerje vatra e kultures |
| 134 | Devoll | Diturije | | Xhaho | 299 m2 30 m2 276 m2 1840 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 138 | Devoll | Zenepe | | Hoxha | 1500 m2 250 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 139 | Devoll | Namik | | Spaho | 900 m2 454 m2 | |
| 449 | Devoll | Teki | | Zhula | 1000 m2 400 m2 1698 m2 | |
| | | Teki | | Zhula | 1000 m2 400 m2 1532 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 441 | Devoll | | | | 250 m2 140 m2 160 m2 | |
| 439 | Devoll | Ollga | Sotir | Theodhori | 400 m2 1300 m2 | |
| 448 | Devoll | Elisa | Ilo | Taluri | 187 m2 100 m2 | |
| 440 | Devoll | Vasfi | Ibrahim | Shaholli | Refuzim kerkese | |
| 442 | Devoll | Lulzim | | Llomi | 712 m2 872 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 443 | Devoll | Fatma | | Cane | 500 m2 | |
| 444 | Devoll | Raqi | | Kurila | 3130 m2 189 m2 | Neni 12 t'I paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit |
| 445 | Devoll | Emin | | Orhan | 240 m2 konak 40 m2 | |
| 446 | Devoll | Diturie | | Spaho | 1000 m2 | |
| 447 | Devoll | | | | 299 m2 | |
| 450 | Devoll | | | | 214 m2 | |
| 27 | Devoll | | | | 3175 m2 | Vendimi nuk ka planvendosje. E dreje parablerje e objekteve |
| | | | | | 468 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin 130 m2 dhe 16 m2. Neni 21 e drejte parablerje kati I dyte I pallatit |
| 22 | Devoll | Hamza | | Berberi | 67 201 m2 | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 21 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| | | | | | 500 m2 500 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 23 | Devoll | | | | 6000 m2 | Vendimi nuk ka planvendosje. E drejte parablerje e objekteve. |
| 25 | Devoll | | | | 5125 m2 | Vendimi nuk ka planvendosje. E drejte parablerje e objekteve. |
| 28 | Devoll | Shege | | Myrto (Kanina) | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 24 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 26 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 30 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 31 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 32 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 33 | Devoll | Shpresa | | Karanxha | Mosnjohje kompensimi | |
| 34 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 35 | Devoll | | | | | Vendimi nuk ka planvendosje |
| 33 | Kolonje | Isa | | Male | | |
| 17 | Kolonje | Shaban | | Male | | |
| 7 | Kolonje | Piro | | Peço | | E drejte parablerje per centralin 300 m2 |
| 61 | Kolonje | Thoma | | Tasho | | |
| 57 | Kolonje | | | | | |
| 60 | Kolonje | Refat | | Shahu | | |
| 42 | Kolonje | Perent | | Nazarko | | |
| 68 | Kolonje | | | | | |
| 49 | Kolonje | Dhorke | | Dhami | | |
| 62 | Kolonje | Dhimiter | | Tasho | | |
| 9 | Kolonje | Nexhip | | Hasani | | |
| 54 | Kolonje | Qazim | | Hasani | | |
| 58 | Kolonje | Baki | | Shahu | | |
| 10 | Kolonje | Ferdinant | | Qyteza | | |
| 68 | Kolonje | Thoma | | Gaba | | |
| 85 | Kolonje | Kujtim | | Hasani | | |
| 40 | Kolonje | Pleurat | | Caco | 220 ha | |
| 41 | Kolonje | Adalet | | Selimi | | |
| 53 | Kolonje | Xhevat | | Lame | | |
| 32 | Kolonje | Edmond | | Sfrati | | E drejte parablerje Vaskat e peshkimit 14 600 m2 |
| 38 | Kolonje | Haneme | | Jaupi | | |
| 86 | Kolonje | Fiorentina | | Vehbiu | | |
| 87 | Kolonje | Duro | | Vehbi | | |
| 59 | Kolonje | Panajot | Koco | Xhuma | | |
| 66 | Kolonje | | | | | |
| 18 | Kolonje | Llambi | | Zguri | 243 m2 ndertesa 2 kt 243 m2 | |
| 139 | Kolonje | Vangjeli | | Dine | 312 m2 mulli 1 kt 115 m2 | |

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9/E | Kolonje | Thoma | | Prodani | 1500 m2 | |
| | Kolonje | | | | 2000 m2 | Neni 21 e drejte parablerje |
| 129 | Kolonje | Marjanthi | | Kosta | 134 m2 ndertese 2 kt | |
| 111 | Kolonje | Argjil | | Zoto | 2370 m2 | |
| 21 | Kolonje | Marina | | Laka | 150 m2 ndertese 2 kt | |
| 191 | Kolonje | Urani | | Panajotidhi | 42.5 m2 | |
| 68 | Kolonje | Avni | | Duro | 148.8 m2 | |
| 164 | Kolonje | Myzejen | | Meçe | 1916 m2 | |
| 158 | Kolonje | Ollga | | Petro | 140 m2 ndertese 2 kt | |
| 159 | Kolonje | Nikolla | | Petro | 52.5 m2 | |
| 45 | Kolonje | Muhamet | | Prespa | 24 320 m2 | |
| 64 | Kolonje | Teqes Erseke | | Teqes Erseke | 5917 m2 | E drejte parablerje e nderteses |
| | Kolonje | | | | 9000 m2 | |
| 5/B | Kolonje | | | | 204 m2 | |
| 96 | Kolonje | Lefteri | | Polishari | 22 000 m2 | |
| 913 | Kolonje | Jorgji | | Prodani | 3000 m2 90 m2 | |
| 48 | Kolonje | Vasil | | Stefanllari | 80.04 m2 | |
| 76 | Kolonje | | | | 1000 m2 | E drejte parablerje e objekteve |
| 162 | Kolonje | Tafil | | Tafili | 1738 m2 | |
| 29/30 | Kolonje | File | | Simeoni | 1082 m2 | |
| | Kolonje | | | | 433 m2 | |
| 24 | Kolonje | | | | 161 m2 2 dyqane | |
| 61 | Kolonje | Aleksander | | Niço | 225 m2 | |
| 62 | Kolonje | | | | 162 m2 | |
| 152 | Kolonje | | | | 86.5 m2 ndertese 2 kt | |
| 1870 | Durres | | | | Sip.Nj=10000m2 | |
| 117 | Kolonje | | | | 10 134.5 m2 | |
| 60 | Kolonje | | | | 251 m2 | |
| 83 | Kolonje | | | | 3561 m2 184 m2 | E drejte parablerje e shtepise |
| 26 | Kolonje | | | | 192 m2 | |
| 156 | Kolonje | | | | 156 m2 | Vendimi pa vule |
| 50 | Kolonje | | | | 400 m2 1300 m2 | |
| 12 | Kolonje | | | | 1000 m2 | |
| 9 | Kolonje | | | | 2014.5 m2 | |
| | | | | | 104 m2 | Neni 21 e drejte parablerje per kinemane |
| 23 | Kolonje | | | | | |
| 37 | Kolonje | Thimi | | Tile | | |
| | | Thimi | | Tile | | |
| 45 | Kolonje | Spiro | | Toqe | | |
| | | Spiro | | Toqe | | |
| 113 | Kolonje | | | | | |
| | | | | | | |
| 78 | Kolonje | Ramadan | | Caka | | |
| | | | | | | |
| 168 | Kolonje | Marianthi | | Lico | | |
| | | Marianthi | | Lico | | |
| 287 | Kolonje | Pali | | Prifti | | |
| | | Pali | | Prifti | | |
| 318 | Kolonje | Simo | | Lazi | | |
| | | Simo | | Lazi | Refuzim kerkese | |
| 232 | Kolonje | Sullejman | | Veseli | | |
| | | Sullejman | | Veseli | | |
| | | Sullejman | | Veseli | 928 m2 512 m2 are | |
| 12 | Kolonje | Loni | | Ziko | | |
| | | Loni | | Ziko | Refuzim kerkese | |
| | | Loni | | Ziko | 264 m2 | |
| 153 | Kolonje | Rezarta | | Bace | | |
| | | Rezarta | | Baçe | | |
| 13 | Kolonje | | | | 19 600 m2 | |
| | | | | | | |
| 51 | Kolonje | Bajram | | Sula | | |
| 69 | Kolonje | Ali | Tefik | Orgocka | | |
| | | Ali | Tefik | Orgocka | | |
| 97 | Kolonje | Merjeme | | Shkembi | | |
| | | Merjeme | | Shkembi | | |
| 13 | Kolonje | | | | | |
| | | | | | | |
| 42 | Kolonje | Hikmete | | Azisi | | |
| | | Hikmete | | Azisi | | |
| 156 | Kolonje | Miti | Koli | Note | | |
| | | Miti | Koli | Note | | |
| 160 | Kolonje | Majlinda | | Loshi | | |
| | | Majlinda | | Loshi | | |
| 20 | Kolonje | Tomor | | Vehbiu | | |
| 133 | Kolonje | Bardhyl | | Latifi | | |
| | | Bardhyl | | Latifi | | |
| 115 | Kolonje | Bajram | | Xhomaqi | | |
| | | Bajram | | Xhomaqi | | |
| 190 | Kolonje | Ibrahim | | Çeço | | |
| | | Ibrahim | | Çeço | | |
| 102 | Kolonje | Aleksandra | | Qirjazi | | |
| 220 | Kolonje | Avni | | Isaj | | |
| | | Avni | | Isaj | Refuzim kerkese | |
| 759/1 | Devoll | Feruze | | Cane | 750 m2 | |
| 756 | Devoll | Pandi | | Napo (Konomi) | 1520 m2 | |
| 755 | Devoll | Seladin | | Tepalli | 875 m2 | |
| 752 | Devoll | Ali | | Arapi | 1140 m2 | |
| 765 | Devoll | Zyhdi | | Talo | 4500 m2 300 m2 616 m2 625 m2 | |
| 764 | Devoll | Zenel | | Ago | 720 m2 2450 m2 | Neni 21 E drejte parablerje |
| 763 | Devoll | Agim | | Meka | 2500 m2 | |
| 762 | Devoll | Refiko | | Agolli | 1864 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 761 | Devoll | Xhafer | | Meka | 2790 m2 | |
| 760 | Devoll | Nexhat | | Qose | 4500 m2 1500 m2 | |
| 759 | Devoll | Zeme | | Gora | 187.5 m2 | |
| 758 | Devoll | Vasil | | Pano | Refuzim kerkese | |
| 757 | Devoll | Sotir | | Andoni | 300 m2 | |
| 753 | Devoll | Stojana | | Xhamo | 577 m2 243 m2 | |
| 751 | Devoll | Fanika | | Grapshi | 550 m2 1100 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 291 | Devoll | Fitret | | Matolli | 393 m2 | |
| 295 | Devoll | Loni | | Progri | | |
| 281 | Devoll | Hetem | | Hoxha | 3102 m2 | |
| 282 | Devoll | Nuni | | Plaku | 250 m2 112 m2 82 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 283 | Devoll | Qibrie | | Bylyku | 2006 m2 2201 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 285 | Devoll | Vullnete | | Veli | 500 m2 | |
| 284 | Devoll | Vangjush | | Temo | 441 m2 820 m2 | |
| 286 | Devoll | Muazes | | Kambo | 1000 m2 130 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 288 | Devoll | Muhamar | | Topalli | 3400 m2 | |
| 287 | Devoll | Anesti | | Furxhi | 160 m2 | |
| 290 | Devoll | Fitret | | Metolli | 228 m2 | |
| 289 | Devoll | Femije | | Mixha | 846 m2 | |
| 292 | Devoll | Zarife | | Xhihani | 766 m2 | |
| 293 | Devoll | Petro | | Popllo | 280 m2 | |
| | | Petro | | Popllo | 282 m2 2000 m2 1500 m2 | Neni 12 t'I paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. |
| 294 | Devoll | Koço | | Maxhe | 520 m2 240 m2 | |

*(vijon)*

SHEMBJA

# "Dua më shumë Shqipërinë", protesta për teatrin me këngë patriotike

Fatmira Nikolli

## Budina: Festë e protestë, nga teatri në parlament e ministri; Mehdi Malka pritet me duartrokitje

## Derhemi: Teatrin e mbroj me gjak. Hervin Çuli: Nuk ka nevojë për gijotinë

Performancë muzikore dhe artistike "Dashuri për Atdheun". Një imazh i Adriana Tolkës me këtë shënim, ftonte dje qytetarët t'i bashkoheshin protestës së artistëve për mbrojtjen e godinës dhe truallit të Teatrit Kombëtar në sheshin e tij. Vetë Aleanca për Mbrojtjen e teatrit shënonte se do të "Takohemi bashkërisht për të mbrojtur teatrin me muzikë". "Protesta" filloi me "Dua më shumë Shqipërinë", me "Lule Borë" dhe me këngën e Nexhmije Pagarushës "E dehun jam".

"Duhet të pish shumë që të jetosh në këtë vend", tha Tolka duke përshtatur vargjet e këngëve me idenë e protestës. Kënga arbëreshe e rikënduar nga Elina Duni "Dallëndyshe", për çka Tolka tha se sa herë e dëgjon, nëse do të vijë dita të na dëbojnë nga ky teatër, do ndjehem si ata që u kushtohet kjo këngë.

Më pas në skenë doli Robert Budina, regjisori që është pjesë e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, i cili tha se "të festuarit s'do të thotë se kemi humbur fokusin. Po tregojmë shpirtin tonë artistik. Do ta pushtojmë këtë teatër me pasionin tonë, jo me dhunën. Që ta kemi të qartë që t'i doni artistët tanë kur janë këtu, jo kur ikin jashtë e gjejnë mekanizmat e sistemin gati dhe kanë sukses". Budina shtoi se veç këtyre festave që do bëjnë, do ndiqen hapat ligjore. "Sepse asgjë nuk është bërë nga qeveria për tërheqjen e projektligjit që i hap rrugën shembjes së teatrit dhe ndërtimit të një qendre multifunksionale", tha Budina. Ai shtoi se ndërsa festohet këtu, do të këtë edhe protesta në parlament dhe në Ministrinë e Kulturës. "I kemi të ngritura antenat e protestës dhe do t'i mbajmë gjallë derisa qeveria të tërhiqet nga projektligji. Pasi të tërhiqet projektligji, do fillojmë të diskutojmë me ta. Anëtarët e këshillit bashkiak, atë që s'e bëjnë dot në bashki, do e bëjmë këtu. Do bëjmë një Kuvend me specialistë të fushës për vlerat e Teatrit Kombëtar këto ditë që të kuptohet qartë se çfarë bart. Po përpiqemi të organizohemi që të kemi festë e protestë. Nëse nuk arrihet që ligji të rrëzohet, do gjejmë zgjidhje të tjera më të forta. Do t'i japim dinjitet vetes, se po i dhamë dinjitet vetes, do fitojmë", tha Budina.

"Unë jam përmetare, por edhe im atë ka lindur në Tiranë, e jam edukuar me muzikën tiranase, ndaj do këndoj një këngë tradicionale qytetare".




Aktivistja Alida Karakushi tha se sa u takon akuzave për politizim të protestës, "PD ka të drejtën dhe detyrimin t'i bashkohet kësaj lëvizjeje pa logo partiake, por kjo lëvizje nuk është e politikës. Partitë kanë dashur gjithnjë t'i përvetësojnë nismat e lëvizjet qytetare. Unë nuk dua të paguaj taksa për dëgjesa pseudopublike në kullat e oligarkëve".

Aktori Genci Fuga e nisi fjalën e tij me një barsoletë mbi gjendjen e Shqipërisë. Më pas, një poezi për Shqipërinë e recituar nga Mehdi Malka u prit me duartrokitje.

"Këlyshët kanë një prejardhje të thjeshtë natyrore, pa komplikime, apo siç thotë edh eshprehja popullore, këslysh i ati, këlysh i biri, e këlysh ai që bëri të anë(të atin). Këlyshët vërtet vijnë nga një premisë fushore, por kur gjejnë terren të përshtatshëm, i zhvillojnë shumë aftësitë e veta", tha Malka.

Aktori Alfred Trebicka tha se dëgjesa ishte fillimi i bisedës, por më pas po thuhet se u arrit marrëveshja. "Ka bir kurve, po ka edhe bira, bira kurve me kuptimin simbolik. Pa i hequr asnjë presje asaj që u tha para meje, duhet të jemi të gjithë këtu bashkë, sepse ne do ta mbrojmë këtë teatër me praninë tonë. Nuk do rrahim njeri, as atë zhdëpim njeri, as të shkepim njeri. Nuk e kemi pas kurrë këtë qëllim. Ata që e kanë këtë mendje, po e kruajtën do ta gjejnë".

### VELIAJ

Dy ditë pas dëgjesës publike me komunitetin e artistëve, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, tha dje se ndjehet i inkurajuar, pasi u hap një faqe e re diskutimi. Ai e bëri deklaratën nga Praga, ku diskutoi me arkitektë e urbanistë për ndryshimet në kryeqytet. "Jam shumë i inkurajuar nga dëgjesa që patëm me aktorët, sepse patëm një ulje tensioni, lamë mënjanë mëritë e vjetra, nisëm një faqe të re të diskutimit. Nëse me këtë mirësi mendojmë si të shfrytëzojmë një shans fantastik për t'i dhënë Tiranës një teatër të ri, duke lënë mënjanë cic-micet e duke menduar për të mirën e përbashkët, që pas 20-30 vitesh të jemi krenarë që kur kishim vendimmarrjet në dorë, morëm një vendim të drejtë për ta modernizuar qytetin, siç po bëjmë edhe në fusha të tjera".

### ÇULI PËR KABASHIN

Çuli ka sqaruar reagimin e tij për Mirush Kabashin ditë më parë, duke e cilësuar emocional. Ai tha sërish se Kabashi ka gënjyer për censurën në shfaqje, gjë që sipas tij, nuk ndodh në Teatrin Kombëtar. "Nuk i heq asnjë presje asaj që kam thënë, një gënjeshtër e trashë duhet të demaskohet. Ai më akuzoi për censurë dhe unë për këtë reagova. Nuk ndjej asnjë 'mea culpa' nga zotëria përballë". Sa i takon deklaratës së Arben Derhemit se teatrin e mbroj me gjak, Çuli tha se "me përjashtim të ndonjë individi me doza të tepruara ekstremiteti, pjesa tjetër nuk do të arrinte forma të tilla. Është nga ata tipat që e mbrojnë me gjak. Nuk mbrohet me gjak, por me arsye se s'ka nevojë të na tregojë gijotinën apo ndonjë revolucion francez. Rezistenca e paqtë është më me vlerë".

# "Wall Street Journal": Ismail Kadare, ndërgjegjja e popullit të tij

"Wall Street Journal" në një artikull të titulluar "Ismail Kadare, ndërgjegjja e popullit të tij", merret me letërsinë e shkrimtarit dhe raportin e tij me tiraninë, duke u nisur nga veprat e tij. Sam Sacks e nis artikullin e tij shumë herët në kohë. "Në një ese të vitit 1985 mbi Eskilin, shkrimtari shqiptar Ismail Kadare argumentonte se gjëja më e vlefshme e grekëve të lashtë - madje më e rëndësishme se shpikja e filozofisë dhe e demokracisë - ishte ndjenja e tyre e 'keqardhjes kolektive'. Një thënie e guximshme: por kini parasysh që shekuj më parë grekët kishin zhvilluar një luftë të egër dhe të padenjë moralisht kundër Trojës", shkruan 'WSJ'. "Një qytetërim më pak i zhvilluar do ta kishte fshirë atë periudhë të turpshme nga kujtesa e vet. Në vend të kësaj, grekët e bënë atë gurthemelin e letërsisë së tyre. "Krimi u ekspozua nga të gjitha këndet prej vetë grekëve, pa ndonjë presion të ushtruar nga kombe të tjera", shkruan Kadare. "Ishte një ekzorcizëm i pashembullt, një akt tronditës, në të njëjtën kohë duke çliruar dhe emancipuar. Për herë të parë në historinë e njerëzimit, ndërgjegjja e një populli po e kalonte me dëshirë duket një trazirë e tillë", shkruan 'WSJ', duke cituar Kadarenë. Sipas Sacks, që prej viteve 1960, zoti Kadare, tani 82 vjeç, ka ndjekur shembullin e grekëve në të gjitha rrethanat e pamundura. Ai ishte autori më i njohur i Shqipërisë nën sundimin stalinist të Enver Hoxhës, që udhëhiqte regjimin e kolektivizimit të detyruar dhe shtypjes së pamëshirshme nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1985. Kadare është autori më i njohur i vendit të tij. Për nga natyra e vet, totalitarizmi synon ta mbajë ndërgjegjen në një gjendje gjumi. Kadare zor se qe i lirë nga ndërhyrja e shtetit, për shkak të karrierës së tij, ai lëvizi mes lëshimeve dhe kodifikemeve



të kritikave të qeverisë së Hoxhës; ai herë u botua dhe herë u censurua. Megjithatë, siç tregojnë tre libra të përkthyer rishtas, ai i mbeti besnik asaj që e ka quajtur "funksioni themelor i letërsisë: mbajtja e moralit ndriçues".

Sacks thotë se Kadare e sheh Prometeun e Eskilit, heroin e ndëshkuar ashpër se i dha zjarrin njerëzimit, si një nga figurat e para në letërsi që kundërshtoi tiraninë. Ai e quan "Komedinë Hyjnore" të vetmen vepër që për të, "pasqyroi si errësirën dhe dritën e Shqipërisë komuniste".

Dialogu i z. Kadare me kanonet perëndimore vazhdon në romanin "A girl in exil" (E penguara), botuar në vitin 2009, me një histori që vendoset në fillim të viteve 1980. Z. Kadare gradualisht zbulon një shëmbëlltyrë të tundimeve të pushtetit. Sack ka marrë në shqyrtim veprat "E penguara" e "Kamarja e turpit", por nuk lë pa përmendur edhe "Pallatin e ëndrrave" apo "Ura me tri harqe". Mbi "Kamaren e turpit", 'WSJ' shkruan se kjo vepër ilustron fiksionin disashtresor që ai krijoi gjatë sundimit të Hoxhës. Ky roman u botua në vitin 1978 dhe është pjesë e dy librave të tij më të mëdhenj, "Ura me tri harqe" (1979) dhe "Pallati i ëndrrave" (1981), romane që ripërpunuan historinë dhe folklorin shqiptar me qëllime delikate alegorike. Sam Sack nga 'WSJ' vëren se ngjarja prej ku nis romani është rebelimi i Ali Pashës, guvernatorit shqiptar që u përpoq të largohej nga Perandoria Osmane dhe u vra nga forcat e Sulltanit më 1822. Fokusi nuk është në kryengritje aq sa te "dhurata": koka e prerë e Ali Pashës, që e ruajtur në akull, transportohet deri në një ntga sheshet e Konstandinopojës dhe shfaqet si një paralajmërim për kryengritësit e mundshëm. Z. Kadare rrotullohet mes karaktereve të ndryshme të lidhura me atë stemë të dhunës autoritare.

'WSJ' vëren se si te "E penguara", qëllimet politike të librave janë të mprehta dhe të pagabueshme.

Duke përshkruar korrupsionin dhe mizorinë e çuditshme të Perandorisë Osmane, z. Kadare denoncon komunizmin shqiptar. "Por do të ishte gabim ta mendonim këtë roman si një alegori politike orueliane. Evokimi i së kaluarës ndihet si bashkëkohor (turistët dynden në Stamboll për të goditur kokën e prerë dhe pothuajse mund t'i imagjinoni ata ta fotografojnë me celular) dhe jashtë kohës. Z.Kadare ka më shumë gjëra të përbashkëta me William Faulkner, një shkrimtar që nxjerr mitologjinë nga legjendat rajonale. Ky, gjithashtu, është sa një projekt moral, po aq edhe artistik. Te "Kamarja e turpit", Kadare përshkruan përpjekjet e Perandorisë Osmane, që me vullnet rreket të shfarosë gjuhën dhe zakonet e Shqipërisë. Ky roman i paharrueshëm i shton punës së tij të përjetshme rikuperimin kulturor. E kaluara është kaq e pranishme në librat e tij - një fantazmë që ecën mes të gjallëve, ose një kokë e prerë që duket se ju bllokon në vështrimin e saj.

MILOSAO

# GJON GAZULLI, AMBASADOR I SKËNDERBEUT

NGA GJON MARKU

Njëri ndër çështjet më kryesore të shtetit të Gjergj Kastriot Skënderbeut ishin marrëdhëniet diplomatike si një nga faktorët më të rëndësishëm të cilët zhvillonin aktivitete ndërkombëtare në mungesë të prezencës së udhëheqësit shqiptarë.

Duke pasur një rëndësi të dorës së parë dhe duke qenë faktori kryesor në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare, në marrëdhëniet ndërkombëtare vetë Gjergj Kastrioti i kushton një vëmendje të veçantë trupës së tij diplomatike.

Në këtë trupë diplomatike dhe në këto marrëdhënie të Shqipërisë me vendet e tjera, një rol më vete kanë luajtur të zgjedhurit e tij për këto pozicione, që në të shumtën e rasteve kanë qenë klerik të lartë katolik. Ata ishin njerëz me integritet e personalitete të kohës.

Pjese më e madhe e tyre i shërbyen Gjergj Kastriot Skënderbeut me shumë mençuri dhe besnikëri, pikërisht pse këto ambasador kishin kulture të gjerë humaniste, sepse ata kishin një identitet të veçantë dhe një shkathtësi në marrëdhëniet diplomatike, ishin të mirëorientuar dhe të mirëpritur në Diplomacitë Evropiane ato Ballkanike dhe Italiane, sidomos marrëdhëniet diplomatike zënë vend me rëndësi në ngjarjet e asaj kohe në Arbëri, në ndërkombëtarizimin e tyre. Këto klerikë katolik që në të shumtën e rasteve gjenden si diplomat në një apo në një tjetër formë, në vende të ndryshëm, kanë dhe një kontribut të madhe dhe të pazëvendësueshëm në zhvillimin kulturor të vendin tonë.

Vijon në faqen 18



In Memoriam

NGA BEN ANDONI

Pothuaj gati i njëjti tekst u shkrua pak orë pas vdekjes së saj. Autorja Dasha Drndiç ishte një mike e shqiptarëve, sëmundja e të cilës bëri, që ajo të mos rikthehej më në vendin tonë, sipas premtimit që kishte bërë. Gjithsesi, la pas një seri shkrimesh të gjetura për kryeqytetin, që do të vinë shumë shpejt, paçka se e kish bërë Shqipërinë pjesë të krijimeve të saj, të njohura "Sonnenschein" dhe "Belladona".

Një anti-komuniste e bindur dhe një njeri pa shumë etiketa, kur duhet të thoshte të vërtetën, ajo ka ndarë me shqiptarët e letrave dhe miqtë e saj në Ballkan momente të mira reflektimi dhe qasje të shkuarës. *"Unë kam gërmuar të gjitha varret e imagjinatës dhe dëshirave... Jam rrotulluar nëpër një seri të ruajtur të vërtetash pa gjetur një gjurmë logjike"*, e citojmë nga Paris Review.

# DASHA DRNDIÇ,

## një autore e madhe, mike e shqiptarëve

{ Në këtë numër: DASHA DRNDIÇ, GJON MARKU, KUJTIM MORINA, ELENA FERRANTE, ETJ... }

Redaktor: Ben Andoni; Grafika Artan Buca 340

L
LETËRSIA

*Dasha Drndiç u nda nga jeta rreth 10 ditë më parë. Mes të tjerave, ajo u mundua të dhuronte një pjesë të librave të saj për Bibliotekën e Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë. Nuk arriti. Burokracia e mundi përpjekjen dhe dëshirën e Drndiç. Nuk dilte njëri të mbulonte shpenzimet nga pala shqiptare, kurse shkolla e kishte të pamundur t'i tërhiqte sepse duheshin mbushur shumë e shumë procedura.* **Në fakt, ata as nuk e njihnin. Kjo përpjekje e bukur mbeti udhës si shumë të tjera syresh, që i drejtohen vendit tonë.**

**"Poeteka" i botoi romanin e saj të njohur "Sonneschein", që në shqip erdhi me dëshirën e autores me titullin-epigram "Fëmijët e urrejtjes dhe dashurisë". Arsyeja ishte se titulli origjinal përbënte disi një gjë të pakuptueshme për publikun shqiptar, që nuk është në masë gjermanofil...**

NGA BEN ANDONI

# Dasha Drndiç, një autore e madhe, mike e shqiptarëve

Kishte fituar njohje ndërkombëtare dhe ndërkohë me veprën e saj i pati dhënë një status të lartë dhe tepër interesant letërsisë kroate, që funksionon si degë e veçantë në letërsinë sllave pas ndarjes së ish-Jugosllavisë. Tema për të cilën ishte më e predispozuar ishte ajo që lidhej me përballjen e individit me vetëdijen dhe sidomos me kujtesën. Ishte tejet e interesuar me rastin shqiptar për këtë përballje dhe me miqtë e saj shqiptarë ndau shumë e shumë gjëra. Pak vite më parë qëndroi në rezidencën e "Poetekës" për shkrimtarët ballkanikë në Tiranë dhe la për kryeqytetin një cikël shumë të bukur reportazhesh, të cilat do të jenë në Panairin e Librit, që zhvillohet në Nëntor. Mbi të gjitha solli emrin e saj, si pjesëtarë e komunitetit të Residencës, që ka prodhuar aq gjëra interesante për kryeqytetin dhe që do të jenë në të ardhmen si trashëgimi e bukur për publikun shqiptar.

Por jo vetëm kaq. Ajo u mundua të dhuronte një pjesë të librave të saj për Bibliotekën e Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë. Nuk arriti. Burokracia e mundi përpjekjen dhe dëshirën e Drndiç. Nuk dilte njëri të mbulonte shpenzimet nga pala shqiptare kurse shkolla e kish të pamundur t'i tërhiqte sepse duheshin mbushur shumë e shumë procedura. Në fakt, ata as nuk e njihnin. Kjo përpjekje e bukur mbeti udhës si shumë të tera syresh, që i drejtohen vendit tonë.

"Poeteka" i botoi romanin e saj të njohur "Sonneschein", që në shqip erdhi me dëshirën e autores me titullin-epigram "Fëmijët e urrejtjes dhe dashurisë". Arsyeja ishte se titulli origjinal përbënte disi një gjë të pakuptueshme për publikun shqiptar, që nuk është në masë gjermanofil. Në këtë libër ka një seksion ku Shqipëria përfutet në rrjedhën e ngjarjeve të personazhit kryesor, ashtu si te "Belladona", por edhe këto elementë nuk bënë që libri të përcillej gjerësisht ashtu si po ndodh me shumë libra të njohur në Shqipëri, vendin që sot vuan nga të gjitha, por më së shumti me gjërat që e lidhin me kulturën.

Aftësia e Dashës ishte për t'u futur thellë në të fshehtën e të kaluarës që ruajnë dokumentet, kujtimet, fakte të cilat sot janë të komprometuara nga ana morale dhe nga të gjitha elementët e tjera prej fuqive që duan t'i fshijnë, por edhe me atë qëmtimin e zërave të viktimave krejt të humbura. Në të gjallë ajo e zgjidhi këtë problem me një përmasë logjike që i shkonte formës: ajo mblodhi me sukses një mori jetësh, rregulloi këtë grumbull të së kaluarës dhe krijoi një seri të papërcaktuar të ngjarjeve, ku jetohej. Mbi të gjitha ajo demaskonte këtë fashizëm të ri, që duket se po lind nga një shoqëri kaq shumë e shkatërruar prej tejkalimeve të çdo lloj forme, që ne e hasim ngado. Dhe, kjo është e para, ajo nuk mund të bënte pakt me këtë shoqëri krejt të dorëzuar. *"Nuk ka fashizëm të vogël, nuk ka nazizëm të vogël, apo nazisëm beninj. Kjo është ajo që unë përpiqem të flas në librat e mi, pra rëndësia e kujtimit. Në këtë epokë të revizionizmit agresiv - i cili tenton të trullos mendjet tona tashmë të dëmtuara, deformuara - pa kujtesë, ne jemi pre e lehtë për manipulim, dhe po humbim identitetin"*, citohet ajo.



Dasha Drndiç

Drndic nuk u ndal vetëm këtu por i zbukuroi romanet e saj të vlerësuara sot ndërkombëtarisht me elementë dokumentarë që e provojnë Holokaustin nga disa kënde. Ajo jep jetët reale të njerëzve që bënë Aushvicin, fotografitë reale të tyre, skicat biografike, transkriptet biografike, listat e stërgjata emërore, dëshmitë dhe elementë të ndryshëm përshkrimorë.

*"Ajo që lidhet me shkatërrimin ekziston edhe kur nuk ndodh më, sepse kthehet disi dhe vazhdimisht përsëritet në kujtesë, e nëpërmjet kujtesës ajo rikthehet përsëri"*, shkruan në librat e saj.

Ashtu, si ndodh me autorët kërkues ndaj kohës së tyre, ajo mbetej e trishtuar për lexuesin që nuk lexon më ajo, ndaj ajo përdorte gjithçka që ai të futej në hullinë e leximit. Dukej sikur po e merrte për dore. *"Lexuesi që ka humbur aftësinë për të imagjinuar të kuptojë fjalët dhe mundësitë e menjëherta, të cilat janë gjithnjë e më pak të njohura. Procesi të menduarit është thjeshtësuar turpshëm"*, pohonte diku tjetër . Dhe, në përpjekjen e saj Dasha, ku mbushte gjithçka me detaje, besonte se i kishte ardhur fundit të përpjekjes së saj që t'i shpjegonte lexuesit deri në detaje për librat e personazhet e saj mes tyre.






Dasha Drndiç në Tiranë

Në Shqipëri në kërkimin e saj për trashëgiminë e komunizmit ajo do të hasej me shumë personazhe. Maks Velon do ta përshkonte në mënyrë jashtëzakonisht poetike si askush tjetër dhe me adhurimin e një jete të mbijetuar. Do të njihte realisht edhe të tjerë, që kishin vuajtur dhe ata që me sintaksa të fryra i thoshin se gjërat janë të ekzagjeruara! Këtyre të fundit arriti t'ua plaste hapur. Jo komunizmi ishte i pamëshirë. Mos e mbroni!

Dasha shikonte dhe e qëmtonte detajin, sepse përmes detajit ajo mendonte se qëndronte një kapacitet i tërë për të parë, këqyrur, dëgjuar dhe ndjerë. Pa detaje, sipas saj, do kishe një material të tharë.

Duhet të kini kurajë për të kaluarën tuaj dhe ta dashuroni atë, u shprehej ajo dëgjuesve shqiptarë, që më shumë se për të njohur mënyrën dhe teknikat e romanit të kujtesës i kërkonin t'u thoshte gjëra për kotësinë sllave, nga ato të ngjashmet me të cilën është e mbytur jeta jonë. Nuk besonte se arti i mirë mund të ndryshojë gjë në këtë hulli, por ishte e bindur se ajo gjithsesi mund të ndryshonte gjëra.

*"Arti nuk mund ta ndryshojë botën, por mund të na ndryshojë ne. Arti mund dhe mund të estetizohet, por nuk mendoj se ky është funksioni i tij i vetëm. Les belles lettres është një term shumë i vjetëruar, pra sot një koncept me pothuajse asnjë peshë. Arti, që duhet të bëjmë, duhet të shokojë, lëndojë, ofendojë, intrigojë, të jetë një kritik i pamëshirshëm i kohës së pamëshirshme ku s'jemi më vetëm dëshmitarë, por edhe viktimat. Në këtë fushë, të ashtuquajturit intelektualë kanë dështuar jashtëzakonisht - duke heshtur, duke kryer tradhti, siç do të thoshte Julien Benda nga La trahison des clercs. Letërsia e mirë kërkon një traumë - një traumë personale, kolektive dhe historike, pa marrë parasysh aftësinë që duhet për ta formuluar atë. Letërsia e mirë nuk ka nevojë për "një histori". Kështu paraqiten ngjarjet që e ndajnë letërsinë e mirë nga shkrimi mediokër imagjinar, shpesh një ndërtim linear i mërzitshëm"*.

Dasha u gjend shumë afër në përkthimin e librit të saj në shqip dhe botuesi Arian Leka dhe artikullshkruesi(përkthyesi), ruajnë kujtimet më të mira për një mike të madhe të shqiptarëve por edhe një shkrimtare që të mësonte sesi të mos humbje në zgafellet e kujtesës dhe problemet e përkthimit.

Vdekja, disa herë, realisht nuk është se i bën gjë disa njerëzve që lenë shumë nga veprimtaria e tyre dhe këtë herë Dasha Drndiç nuk është se u dëmtua shumë nga vdekja, që e priste prej një viti e gjysëm. Ajo e sfidoi se la një vepër të bukur... (Milosao)

R
ROMAN

*Kjo është një pjesëz e romanit të autores Belladonna, ku flitet për Shqipërinë.* **Po e botojmë në nderim të autores...**

# BELLADONNA

**NGA DAŠA DRNDIC***

Teksa në Shkup po presin armikun e tyre imagjinar që nëpërmjet Prizrenit do të arrinte nga Shqipëria me tanket e rregjuara T-59 (varianti kinez i tankut të famshëm T-55), *Enver Hoxha mbillte vendin e tij përreth në mënyrë histerike me bunkerë, kurse në jug të Tiranës ngriti bazën ajrore të* Kuçovës në Berat, me skuadrionet e aeroplanëve MiG-15/19 dhe 21 gjuajtës-bombardues, versionet e F-13, të gjitha prodhime kineze të markës F- 5/6/7.

Ato 750.000 bunkerë ku për dekada shqiptarët do kruspulloseshin me pushkë në baltë "të gatshëm" në përgjim të armikut *të tyre,* tani po risajohen në objekte të këndshme intime dhe të errëta, bare apo diskoteka, vende që turistët i vizitojnë zakonisht me një buzëqeshje dhe kinse habi, e ku blejnë edhe kopje në miniaturë të imitacioneve të pesë dekadave të tmerrit, që mbuluan të gjithë jetën e një kombi. Këto suvenire, bunkerë të vegjël, të cilët turistët që vijnë nga ndonjë prej atyre vendeve të lumtura nuk do i kujtojnë më *për asgjë*, pas kthimit në jetën e tyre të përditshme, do i vendosin në raft apo brenda ndonjërit prej atyre objekteve në formën e një tavlle duhani – ku shuajnë bishtat e cigareve.

Ai do të shkojë në Shqipëri, ende nuk ka mbërritur, por do shkojë. Kur në vitin 2008 udhëtoi në Shqipëri ekipi i të njohurit të tij, Andreas Ban-it i duhej të operonte një lungë dhe, mu atëherë, i përkoi siç edhe shpesh ndodh në ëndrrat pas ndonjë të papriture reale e të beftë, mbas të cilës të mbetet një vrimë në gjoks. Mbiemri i tij Ban është me origjinë ilire, shqiptare, Arnaute, rrënjët janë diku aty nën vargjet malore mes eshtrave të dikurshme të dekompozuara të luftëtarëve të vrarë, të mbetura pas sulmeve të turqve në shekullin e largët XV, kohë kur paraardhësit e tij ia mbathën në Istria. Gjithsesi, rastësisht apo jo, Shqipëria përmes realitetit të Andreas Ban shfaqet e habitshme por jo në formën e fijeve të humbura e as të ndonjë historie, e cila kthehet vazhdimisht në episode të rregulluara mjeshtërisht në jetën e zakonshme. Kjo tani, duke u përballur me kufirin shqiptar i përsjell një botë në vetvete me mur, ngurosur, por edhe jetën e trishtuar e të varfër, të cilës i kanë plaçkitur buzëqeshjen dhe madje edhe lotin, e të gjitha këto Andreas Ban nuk i dyshon.

Shumë vite më vonë, në librin me titull *Sonnenschein*, Andreas Ban ndodhet në kapitullin që ka të bëjë me jetën e një familjeje italiane në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në këtë kapitull, e gjen veten me emrin e Ruben Ketz dhe ndaj Andreas Ban ngre vetullat e tij dhe thotë, *E pamundur. Po ekzistojnë shumë emra dhe mbiemra të njëjtë të njerëzve të ndryshëm*, bind veten Andreas Ban gjatë leximit të librit me titullin *Sonnenschein,* ku shkruhet se familja italiane-hebreje-fashiste Tedeschi u vendos në Vlorë në vitin 1939, kohë kur në qytet jetojnë ende rreth gjashtëqind hebrenj, dhe që atëherë në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare Haya do kujtonte në pleqëri vetëm Fanny Mallin, që e mbante të lidhur me ngjalmë një lepur, dhe Ruben Ketz-in sepse ai i kishte xhepat plot me guralecë të zinj dhe fliste shqip më mirë se ajo. Pas këtyre të dhënave të parëndësishme e gjoja fiktive mendja e Andreas Bana lëviz në një kujtesë të vagëllt, e gjitha dytësore për jetën e tij. Por me kalimin e kohës, hapen të çara të reja në historinë e familjes Ban, që megjithëse janë të çara beninje, duken si pa dhimbje, edhe pse përbëjnë boshllëqe që edhe njëherë tjetër konfirmojnë se jeta jonë s'është më fiktive dhe imagjinare por reale, ndaj Andreas Ban s'di çfarë të bëjë me situatën e tij të momentit, kaq të koklavitur, konfuze e të lodhshme, mu tani kur e mbërthejnë të gjitha llojet e sëmundjeve që përmbajnë mbeturinat e mbetura të realitetit të heshtur dhe të rremë.

Motra e Andreas Ban-it, ajo që në vitin 1997 vdiq nga një goditje në tru në Ljubjanë, në fund të viteve 1960, na u martua me njëfarë Carlo Ketz, inxhinier ndërtimi nga Trieste, nga i cili, "për shkak të natyrës së mosmarrëveshjes," kërkoi menjëherë divorc. Nuk kanë fëmijë. Menjëherë pas divorcit, Carlo Ketz u vendos në repartin psikiatrik të spitalit "San Giovanni" të Triestes, të cilin pas radhës së spitalit psikiatrik në Gorizia, në vitin 1960, e reformoi i famshmi Franco Basaglia dhe ku në fasadën e të cilit dikur me shkronja të ndritshme të kuqe ishte i mbishkruar grafiti *"Terapia është liri"*, kurse vetë institucioni u quajt shkurtimisht *Casa Rosa Luksemburg.* Dhëndri i Andreas, Carlo Ketz, iu nënshtrua një trajtimi për humbjen e identitetit, ngaqë se kuptonte qartë vetveten dhe kohën, e pas së cilës duke e pasur të vështirë për të dalluar se cili ishte, vendosi të shndërrohej në disa subjekte njerëzor, fatet paralele të të cilëve jetonin, ashtu siç dukej edhe për atë Teresa Acosta, e cila konfirmon vetëm se sëmundja është e lidhur me njohjen e vetvetes, nga pasqyrimi i thyer i jetës sonë në realitet e që nuk përbën një sëmundje specifike sesa përshfaqje e pak a shumë të zakonshmes për t`u copëtuar, kohës së jetuar gjatë ekzistencës sonë.

Spitali San Giovanni nga ana humane është i integruar mirë në mjedis, rreth tij shëtisin të rinj, është pranë edhe një diskotekë, pa ka bare, restorante dhe ëmbëltore, madje edhe një teatër i vogël, natyra është e bukur, ashtu si ishte e këndshme edhe përreth kampeve naziste të përqendrimit, arkitektura ishte e stilit nouveau, lagjja ishte multi-etnike, e përshkonte kultura, oh, çfarë mrekullie, pacientët dilnin jashtë sa herë që donin, disa, megjithatë, të shoqëruar nga të tjerët, të themi, e mund të rrëfehet po ashtu se edhe Carlo Ketz, ish-burri i motrës së Andreas, jeton në repartin psikiatrik të spitalit San Giovanni sot, në moshën e tij të mesme, ndjehet i qetë dhe është *i integruar*, sikur nuk është atje ku është, sikur është mu *mes nesh.*

Franco Basaglia, i vetëdijshëm për faktin se sa më të mbyllura të ishin institucionet psikiatrike aq më të dëmshme do ishin për llojin e identitetit njerëzor dhe pastaj më të diferencuara edhe prej trajtimit të ashtuquajtur nga "djepi deri në varr", mbrojti shkollën e psikiatrisë demokratike dhe dekonstruksionin e spitaleve psikiatrike, ku njeriu pa mëshirë katapultohet më tej në humnerën mendore dhe shpirtërore, dhe madje edhe fizike. Kur qenia e sëmurë do gjendet e mbështetur në muret e spitalit psikiatrik, thotë doktor Basaglia, ajo zhvendoset në një dimension të ri të zbrazëtirave emocionale, në neurozë institucionale. Andreas Ban-it i duket se rënia në neurozë institucionale nuk është e nevojshme të kurohet në spital psikiatrik, është e mjaftueshme thjesht të ulesh në çdo zyrë, t'i nënshtrohesh si punonjës i saj, po ndoshta edhe si të atij shkencëtarit, ndoshta veçanërisht stafit të universitetit, sepse universiteti mbështjell një mburojë të padepërtueshme të autonomisë së rreme dhe korrupsionin akademik, dhe të gjithë këtë e ka thënë tashmë Kafka. Duke arritur në një spital psikiatrik, thotë doktori Basaglia, njeriu hyn në një hapësirë të projektuar fillimisht si një zonë që do ta bëjë të padëmshëm, të butë, të qetë, të lehtë dhe të bindur, të gjithë në frymën e krishterë, veçanërisht katolik të devotshëm, e cila ashtu me hile i vret shpirtin, e është në të vërtetë një propagandë shekullore e lojës, shfaqje me kostume të varfëra plot me tekste të uritura dhe skenografi kitsch, nën ballin e të cilës nën mantelin *e rëndë* qëndisur me fije ari dhe këpucë të kuqe Prada, parakalon figura groteske e Papës.

Duke e vendosur njeriun në një spital psikiatrik, vërtetoi mjeku Basaglia, "kompetent" i vërtetë në fakt, ai mblidhet në hapësirën në të cilën falë terapisë së ilaçeve, e gatisin sërish të kthehet në botën e jashtme, që të bëhet sërish i pranueshëm. Në mënyrë paradoksale, thotë mjeku Basaglia, në vend të kësaj, pacientët vijnë me një mohim të plotë të individualitetit. Nëse sëmundja mendore në thelb do të thotë humbje e individualitetit dhe lirisë, atëherë në institucionet për sëmundjet mendore personi i sëmurë e humb më vonë *përveç* dhe *plotësisht* veten e tij, duke u bërë objekt i sëmundjes së tij, që është vështirë të shërohet. Në këto institucione, pacientët janë të privuar nga e ardhmja, në institucione të tilla ankorohen njerëz pa të ardhme, të privuar nga vendimi dhe rebelimi, vazhdimisht të varur nga vullneti, direktivat dhe diktati i të tjerëve, pohon mjeku Basaglia.

*Ku jam,* pyet Andreas Ban, *brenda apo jashtë?*

Ky është Carlo Ketz, ish-burri i motrës më të madhe të Andreas Ban-it - "internuar", Andreas Ban e dinte se deri në mes të vitit 1970 ai qëndronte në Shkup, në kazermën Marshall Tito, VP 4466, dhe ndërsa po kthehet kah kufirit shqiptar rivlerëson rrënjët e veta, i gatshëm për të mbrojtur Atdheun nga sulmi i padukshëm dhe asnjëherë i parë nga një fuqi armiqësore.

Por vetëm kur në këtë librin *Sonnenschein* u ndesh me mbiemrin Ketz, para Andreas Ban-it shtrihet kapitulli për të cilën ai nuk di asgjë, heronjtë e të cilit fluturojnë drejt footsnote të jetës së tij. Prej sa kohë familja italiane Ketz, e cila ishte i lidhur një herë e një kohë me motrën e tij, kishte qenë në Shqipëri? A ishte familja Ketz e njëjtë me atë të burrit të motrës së tij, të cilin e pa vetëm një herë, tridhjetë apo dyzet vjet të shkuara gjatë martesës? Pse Carlo Ketz humbi, e tani, nëse ai ishte ende gjallë, mbledh mbeturinat e ditëve të tyre? Dhe kështu, duke kërkuar jashtë dhe duke zgjidhur të kaluarën e tij, qoshet e së cilës janë të humbura, mbushur me shtresat e lëkurës së kohës së tij, dhe që tashmë po shkojnë drejt përqafimit të harresës, Andreas Ban furnizon jetën e njerëzve të tjerë në rrugën kah vdekjes, në këtë pakujtesë të përgjithshme kaq të fuqishme.



Dy vjet pas operacionit të një kanceri në gji, aty nga 2010, me ftesë të mikut të tij në Beograd që nga 1990 ishte vendosur në Nova Gorica, Andreas Ban, përmes një kufiri jo ekzistent, udhëton drejt Gorizias në ekspozitën retrospektive të Zoran Mušiè (1909-2005). Rastësisht, për aq sa ekziston rastësia, në ekspozitë u njoh me Haya Tedeschi, një nga personazhet e librit *Sonnenschein* sepse dikush me pëshpëritje tha një moment - Ja e çmendura Haya; *duket se ka gjetur një bir dhe pendimin nga mëkatet.* Andreas Ban ftoi gruan e vjetër Haya Tedeschi në Cafè "Joy" për t`i folur rreth Shqipërisë dhe Ruben Ketz, i cili kishte xhepat plot me guralecë të zinj dhe fliste shqip më mirë se ajo.

Kështu, Andreas Ban mësoi se në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar Italia u hodh drejt Shqipërisë dhe i huajti asaj kredi që ajo nuk arrin t`ia shlyejë dot. Mbreti Zog i uli disi shantazhet italiane më 1936 kur me Italinë nënshkruan dymbëdhjetë marrëveshje ekonomike dhe financiare që do ta shkundin pavarësinë shqiptare. Roma nga Tirana kërkoi që kreu i xhandarmërisë shqiptare të emërohej prej qeverisë italiane, e të realizojë bashkimin doganor me Italinë, asaj t`i garantohej kontrolli mbi prodhimin shqiptar të sheqerit, monopoli për qasje në postë, telegraf dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, të fusë gjuhën italiane në të gjitha shkollat shqipe dhe të pranonte edhe kolonistët italiane. Shqipëria mu atëherë ka pritur kompani të ndryshme italiane, veçanërisht ato të ndërtimit. Ishin ato të Ferrobetonit, Simoncini, Marinuçi, Tudini dhe Talenti e shumë të tjerë. Vijnë edhe bankat italiane.

Pas pushtimit italian të Shqipërisë, në prill të vitit 1939, vetëm në Tiranë jetonin rreth 20,000 italianë, Haya Tedeschi i rrëfen Andreas. Atëherë ne kemi ardhur në Vlorë, i thotë. Babai im ishte bankier. Në lagje jetonte një inxhinier ndërtimi Massimo Ketz, mund të ishte rreth dyzet vjeç, një punonjës i kompanisë Immobiliare që ka ndërtuar hekurudhën Durrës -

Elbasan. Duke e parashikuar luftën e ardhshme, Massimo Ketz nga Vlora e ktheu familjen e tij, gruan Marcella dhe dy djemtë, Carlo dhe Ruben, në vendlindjen e tij Italinë fashiste, në vilën luksoze të babait të tij në periferi të Monfalcone, ku familja vazhdoi mundimshëm jetën e saj të qetë, duke u shtuar e shumuar, duke vdekur dhe lindur, në përputhje me ligjet e natyrës dhe natyrës njerëzore, deri në ditët e sotme, tha Haya Tedeschi. Vetëm në vitin 1940 miku im dhjetë vjeçar

Vijon në faqen 16

A
ARGUMENT

# Interesim i kënaqshëm nga lexuesit në panairin e Prishtinës

NGA KUJTIM MORINA






Panairi i 20-të i librit në Prishtinë i mbajtur në datat 5-10 qershor 2018 pati një interesim të kënaqshëm nga lexuesit. Merrnin pjesë shumica e botuesve shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Shoqata e botuesve të Kosovës si organizatore duket se ka qenë e angazhuar që panairi të shkojë sa më mirë megjithë vështirësitë e shumta që hasen në këto raste. Duket që kanë pasur një mbështetje nga Ministria e Kulturës së Kosovës, nuk po hyjmë në shifra sa dhe si dhe që kuptohet se nuk përmbush ende nevojat që ka organizimi i një aktiviteti të tillë.

I ftuar i nderit në këtë panair ishte François –Henri Désérable, një shkrimtar i ri francez por që është vlerësuar në Francë me botimet e para të tij. Me këtë rast ishte botuar romani i tij "Njëfarë Z. Piekielny" botuar nga shtëpia botuese "Buzuku" dhe përkthyer nga Urim Nerguti. Kishte plot vizitorë, shkrimtarë dhe kritikë të njohur nga Tirana, Tetova, Shkupi e Presheva të ftuar në promovime librash apo për organizime të tjera. Megjithë klimën pozitive në të cilën u zhvillua ky panair, nga bisedat e zhvilluara, ranë në sy edhe problemet që hasen në këto raste. Godina ku u mbajt panairi, Pallati i Rinisë, një godinë e vjetër e ndërtuar në fillim të viteve 80 e quajtur atëhere "Boro & Ramizi" megjithëse në pozicion të përshtatshëm në qendër të qytetit, ka hapësira të kufizuara dhe pa ajrosje të mjaftueshme. Shkrimtari Ag Apolloni e ngriti shqetësimin e tij duke atakuar drejtuesit e shoqatës së botuesve për mosmarrjen e masave për të nxehtin e padurueshëm në ambientet e panairit pa ventilim dhe ajrosje. Kryetari i shoqatës së botuesve Abdullah Zeneli shprehet në bisedë me të se mbetet problem prej shumë vitesh ambienti i panairit të Prishtinës. Godina ekzistuese është e amortizuar dhe e mbetur pezull pronë shtetërore dhe nuk po vendoset as të shitet tek privati dhe as të rikonstruktohet. Ambientet e tjera të mundshme për panair janë në periferi të qytetit dhe nuk do të kishin këtë akses lëvizje. Ai rendit sakrificat e mëdha që ka bërë për librin si shtëpi botuese serioze duke mos rendur drejt komercializmit.

Në panair kishte vizitorë të shumtë. Besoj që duhet të ketë më shumë nxitje për nxënësit e cikleve të larta të shkollës 9 vjeçare e të mesme sepse nuk u pane shumë organizime të tilla si në Tiranë. Organizatorët kishin parashikuar aktivitete në nderim të shkrimtarëve shqiptarë dhe të huaj me rastin e përvjetorëve të tyre ku vlen të veçohen, aktivitete për 550 vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar Skënderbeut që binte në sy me postera edhe në rrugët e Prishtinës, 100 vjetorin e lindjes së shkrimtarit nobelist rus Solzhenicin që megjithë deklarimet e tij nacionaliste për Kosovën, nderohet për dëshmitë e e tij të pakontestueshme ndaj krimeve të komunizmit. Bënë përshtypje dy aktivitete për dy intelektualë nga Shqipëria, Abdulla Ramin, jurist, gjyqtar dhe avokat i cili, në vitet 1942 – 43 ka punuar si gjyqtar në Gjilan si dhe Tajar Hatipin nga Elbasani që ka punuar si mësues në Kosovë që në vitet e Luftës II Botërore dhe më tej si inspektor e drejtor shkolle duke dhënë një kontribut të shquar për arsimin në Kosovë.

Në mbyllje të këtij shënimi të shkurtër, do të thoja se panairet e librit të Tiranës dhe Prishtinës mbeten dy aktivitetet më të rëndësishme në këtë drejtim. Organizimi i tyre në kohë të ndryshme i përgjigjet interesit të lexuesve që natyrisht duan edhe mbështetje nga qeveritë e të dy vendeve aty ku shoqatat e botuesve nuk arrijnë dot apo për të mos ngarkuar më tej botuesit e veçantë dhe përfundimisht lexuesit me kosto shtesë.

Vijon nga faqja 15

# BELLADONNA

NGA DAŠA DRNDIC*



Ruben Ketz, i tha Haya Tedeschi, ai që i kishte xhepat plot me gurë të zinj dhe gjuhën shqipe e fliste më mirë se unë, zhduket nga fotoja dhe hyn në një histori tjetër. Pjesën tjetër e kam mësuar kohët e fundit, shton Tedeschi, kur isha në Kryqin e Kuq të Triestes, e ku unë shkova për të kërkuar ndonjë informacion të ri në lidhje me zhdukjen e djalit tim, takova Ruben Ketz të cilin, sigurisht, unë nuk do ta njihja, pasi ndarja tonë ishte pothuajse shtatëdhjetë vjeçare. Në zyrën e Kryqit të Kuq të Triestes, dikush papritmas bërtiti, zoti Ruben Ketz!, dhe unë logjikisht, u drithërova. Rubeni kërkonte informacion në lidhje me familjen e tij; Pastaj ai më tha se çˆkish ndodhur pas largimit të tyre nga Shqipëria.

Pastaj, kur vendosi të shoqen dhe bijtë e tij në Monfalcone, ndërtuesi Massimo Ketz, përpara se të fluturonte në Shqipëri, në Trieste testoi çizmet e terrenit (për kthimin në Vlorë), të cilat atij në këmbë butësisht ia futi shitësja sllovene Dora Dag, bukuroshja kuqalashe me llërë të bardha pa unaza. Po atë mbrëmje në një restorant në Trieste të çiftit të bashkëshortëve Perica në Piazza Cavani, mes ndërtuesit Massimo Ketz dhe shitëses Dora Dag (1900) u thye ky pasion i pakuptueshëm, pas të cilit Massimo Ketz i tha: Eja me mua në Vlorë.

*Më kujtohet kur erdhën ata*, i thotë Haya Tedeschi, *sepse ne u larguam nga Shqipëria më 1943.*

Kështu në vitin 2010 në kafen e Goricës "Joyˆ Andreas Ban mësoi nga Haye Tedeschi gjithashtu se Dora Dag në Trieste la burrin e saj dhe dy fëmijët dhe me avionin e një kompanie ushtarake "Ala Littoria", me Massimo-n zbarkoi në Tiranë. Massimo dhe Dora, si dhe disa mijëra italianë dhe familje italo-shqiptare, i kanë mbijetuar luftës, por na i kanë mbijetuar edhe pushtimit gjerman të Shqipërisë dhe pritën regjimin e Enver Hoxhës, pas të cilit ranë poshtë perdes së hekurt të heshtjes dhe frikës, dyzet vjet të varfërisë, urisë, mbikëqyrjes, arrestit, përjashtimet, ri-arrestimet dhe ekzekutimet, e shpresës së përgjithshme deri në vitin 1992 kur as nuk do të ëndërronin për një rikthim në Itali. Edhe pse pas luftës, ata ishin të nevojshëm për ndërtimin e vendit, Enver Hoxha më vonë kolonistëve italianë dhe fëmijëve e tyre, me etiketimin si "agjentë të imperializmit", "sabotues" dhe "armiq të revolucionit", ua kufizoi gjuhën, kombësinë, kujtesën dhe ekzistencën, e u harruan kështu dhe janë bllokuar duke u munduar në ekzistencën e tyre të bunkerizuar.

Dora dhe Massimo pra nga Vlora Mesdhetare, *zhytur në kopshte dhe ullishte,*

Oh, ishte aq e bukur ajo Vlora jonë, i tha Haya Tedeschi:

*Dora dhe Massimo* më 1947 nën direktivën e Komitetit Qendror të PK-së së Shqipërisë janë zhvendosur në Burrel, një qytet prej pesëmbëdhjetë mijë banorë në veri të vendit, ku Massimo vdiq më1982, e Dora tre vjet më vonë. Për fëmijën e tyre të vogël, Giuseppe (1942) që u quajt Zefi, *më kujtohet kur u lind*, i tha Haya Tedeschi, dhe Rosa - Rozën (1945), që pati një realitet zhytur në vuajtje të rëndë dhe t'ngadalë.

Burreli, vendlindja e Skënderbeut dhe Ahmet Zogut, për shqiptarët është i njohur edhe si vendi i mbretërve. Në komunizëm, Burreli ishte një vend minierash që i mbulonte grimcat e padukshme toksike të kromit që mësynin mushkëritë, e që kështu për ta kishte edhe një vështirësi më shumë në frymëmarrje. Në Burrel inxhinieri Massimo Ketz mbikëqyr minatorët sesi gërmonin në minierë. Në kohën e Enver Hoxhës Burreli ishte i njohur mirë për burgun e tij mizor për kriminelët politike dhe tradhtarë. Në këtë burg Massimo Ketz do banojë edhe vetë në disa raste për shkak të përhapjes së "propagandës anti-komuniste dhe agjitacion" në mesin e minatorëve. Sigurimi e kontrollon imtësisht jetën e tij. Kudo, në të gjitha skutat e jetës ndërfuteshin metastazat e Sigurimit. Gjatë kohës së Pashkëve, agjentët e fshehtë gërmonin në kutitë e plehrave natën në kërkim të vezëve t'bojatisura, apo në kohën e Krishtlindjeve se mos gjenin stolitë e thyera apo dhe mbetje të letrës dekorative edhe pse globezat dhe letrat dekorative nuk ekzistonin fare në treg, apo edhe duke kërkuar kokrrat e pishës, të gjitha prova për t'i arrestuar më pas. Në burg, Massimo Ketz u takua me Fatos Lubonjën, i dënuar me 25 vjet burg nga të cilat 17 syresh të kryera në Burrel, romanin e të cilit shkruar në kutitë e cigareve, nuk arriti ta lexojë; njohu Pjetër Arbnorin të burgosur për 28 vjet, dëgjoi tregimet horror, ka parë trupa të rrahur, nofulla t'pa dhëmbë. Kohë të vështira, kohë e mendjeve të inatosura, rregulli të pafund uroborosi.

Në vitin 1992, qeveria e re shqiptare e liroi Roza Bufin lindur Ketz, të shkonte në Itali për të kërkuar gjysmë vëllezërit e saj Carlo dhe Ruben Ketz, tha Haya Tedeschi. A ka pasur ndonjë takim me djalin e Dora Dag, të martuar Ketz, këtë unë nuk e di. Në garsonierin, në afërsi të Triestes në spitalin San Giovanni, atëherë jetonte ende pesëdhjetë e shtatë vjeçari Carlo Ketz i cili herë pas here e vizitonte psikiatrin. Unë jam mirë tani, i pohonte i vëllai i Rubenit, Carlo Ketz. Carlo Ketz për pesëdhjetë vjet jetoi me mendimin se babai i tij, Massimo Ketz, ishte vrarë në frontin shqiptar në mbrojtje të Mbretërisë së tij fashiste të Italisë, dhe s'ka asnjë ide se çkërkonte atje Roza Bufi - lindur Ketz. Prandaj i thotë, e dashura Roza Bufi, kjo është familja ime, dhe i vë në dukje një fotografi të vjetër që ka marrë ngjyrën e sepjes në kornizën varur në mur. Këta janë njerëz të veshur me kadife dhe mëndafsh. Burrat mbajnë veshur këmisha me bust që mbërthehen me kapëset, teksa gratë me doreza dantellash, qeshin qetësisht. Rubeni tregon, i tha Haya Tedeschi, se Carlo Ketz viziton dyqanet antike të Triestes nëpërmjet Koperit dhe Rijekës dhe në to blen jetën e njerëzve të sistemuar dhe kujtimet e të kaluarës së vet fiktive.

Dhe kështu Andreas Ban, kush e di për të satën herë, u sigurua njësoj si të gjithë ne që vrapojmë në pista paralele, pista të cilat vetëm për një moment preken e nxjerrin ato shkëndijat e çmendura që fluturojnë tutje mu si ato nën rrotat e një treni që nxiton në shpejtësi të përjetshme.

*Avete delle veçhie fotografie, famigliare? Delle fotografie famigliari,* i jehon në kokë Andreas Ban.

Një nga Trieste vjen rregullisht, duke kërkuar për të afërmit, i thotë tregtari i antikuareve Oskar.

*Eço la mia nonna, ho trovato la mia nonna,* i thotë italiani. *Comprerò tutto.*

*Po ai bleu të afërmit e mi,* ore Oscar, i thotë Andreas Ban, *jetët e njerëzve të tjerë.*

*Ndoshta jo aq të huaj sa na duket*, e përfundon Oskar.

Tani, dy ose tre vjet më vonë, ndërsa është duke e dëgjuar Haya Tedeschi, Andreas Ban-it thjesht i mbetet një buzëqeshje, kur merr vesh se ai njeriu i vjetër në dyqanin e antikave të Oskarit, ishte ish ***brother-in-law*** (kunati) Carlo Ketz, por edhe pse erdhi përciptas dhe për një moment, u largua sërish në atë jetë, ku arnat e shpërndara të së cilës zvarriten kah strehimores së tij.

***Përktheu nga origjinali kroatisht Ben Andoni***

K
LETËRSIA

*Elena Ferrante është pseudonimi i autores së dhjetë veprave letrare, ndër të cilat edhe saga napolitane, e konsideruar si kryevepra e saj, nga pikëpamja e kritikës letrare, por edhe falë suksesit të jashtëzakonshme me lexuesit. Emri i vërtetë i autores mbetet ende zyrtarisht i pakonfirmuar.* **Në 2011 u botua kapitulli i parë i sagës napolitane, "Mikesha gjeniale" (i botuar në shqip në nëntor 2016), i ndjekur nga libri i dytë, "Mbiemri i ri" (i botuar në shqip në korrik 2017), vëllimi i tretë, "Histori arratie e qëndrese" dhe nga libri i katërt dhe i fundit, "Historia e vajzës së humbur".**

# Për librin e Ferrantes!

"Historia e vajzës së humbur" është vëllimi i katërt dhe i fundit i "Mikeshës gjeniale", sagës që e ngriti autoren në shkallën e një prej shkrimtareve më të mira në botë.

Në fillim, pamë dy vajzat e vogla të hidhnin qëllimisht kukullat e tyre prej lecke në bodrumin e don Akil Karraçit, që mban nën kontroll gjithë të varfrit me anë të mekanizmave korruptues; të atij përbindëshi të pamëshirshëm, në portën e të cilit vendosën të trokisnin me atë shkas, duke ngjitur shkallët e duke ecur dorë për dore me njëra-tjetrën për të marrë zemër, njëra përpara, Lina, e paepur, trime, tjetra pas, frikacake e gjithnjë një hap mbrapa. Qysh prej atij çasti, që prej asaj "skene të parë" – që theu digën dhe shpërtheu vrullshëm rrjedhën e rrëfimit, në qendër të të cilit mbetet ujdia e rreptë e bashkëpunimit mes protagonisteve – zë fill një lojë pasqyrash dhe shkëmbimesh, ku mezi arrijmë të deshifrojmë se cila prej të dyjave është "mikesha gjeniale".

Dy vajzat tashmë janë të rritura, më pas të moshuara. Që prej viteve '50-të deri më sot kanë përjetuar ndryshime epokale, kanë arritur e kanë dëshmuar me sytë e tyre një mirëqenie të papritur, pastaj mohimin, dehjen e lirisë së hershme seksuale, dehjen politike, vitet e plumbta, terrorizmin; kupola e kamorristëve, që kontrollon gjithçka dhe përcakton rregullat e lojës, bëhet gjithnjë e më kanosëse.

Dy heroinat, Lina dhe Elena, tashmë kanë mbi shpinë një jetë plot ngjarje, zbulime, rrëzime dhe "rilindje". Elena, shkrimtare e njohur, nënë e dy vajzave, kthehet në Napoli për t'i rënë pas një dashurie rinore, që u bë sërish e pranishme në jetën e saj të re. Lina nuk është larguar kurrë nga Napoli, ku arriti të ngrinte një karrierë të mahnitshme si sipërmarrëse informatike, duke ushtruar më shumë se kurrë rolin e saj karizmatik dhe magnetik si lidere e fshehtë, por e vërtetë e lagjes.

Dy gratë, pole vërtet të kundërta të së njëjtës forcë, takohen dhe përplasen, ndikoj në mbi njëra-tjetrën, largohen e sërish gjenden, zilepsen dhe admirojnë shoshoqen.

Ky vëllim i katërt dhe i fundit përmbyll një vepër letrare jashtëzakonisht pjellore dhe frymëzuese, një vepër e pranuar ndërkombëtarisht si një prej më të mirave të kohës sonë.








**VLERËSIMET**

➤Numri 1, në revistën Time, në listën "10 librat më të mirë letrarë të 2015".

➤Një nga "10 librat më të mirë letrarë të 2015" në The New York Times Book

**REVIEW**

➤Një nga "10 librat më të mirë letrarë të 2015" në People Magazine.

➤Përmendur në listën e "15 librave që duhen lexuar këtë vjeshtë" në Wall Street Journal.

**Titulli: "Historia e vajzës së humbur"**
**Titulli në origjinal: "Storia della bambina perduta"**
**Autori: Elena Ferrante**
**Përktheu: Agim Doksani**
**Zhanri: Roman**
**Data e botimit: Qershor, 2018**
**Numri i faqeve: 484**
**Çmimi: 1200 lekë**
**Kandidate për çmimin Man Booker International, 2016.**

## KRITIKA

Pas kaq e kaq dekadash, vepra e parë nga Italia që ia vlen të fitojë çmimin Nobel.

***The Guardian***

Saga e saj napolitane është një kryevepër epike, një roman për jetën dhe rritjen e një artisti, i mbushur me pasion dhe furi... Ferrante është e fshehtë: familjarja, në librat e saj të shkëlqyer, është një bombë me sahat që rreh shumë fort për t'i qëndruar mospërfillës.

***TIME's 100 Most Influential People***

Këtë po e them me besimin e patundur që s'e kam ndier gjatë 15 vjetëve që jam marrë me recensione librash: saga napolitane është e jashtëzakonshme.

***The Sunday Times***

"Historia e vajzës së humbur" nuk i jep sagës një fund qetësues, por pohon edhe njëherë se Ferrante është një prej zërave më të fortë të narratives bashkëkohore.

***The Telegraph***

Nga këndvështrimi letrar, qasja e Ferrantes është mjeshtërore: përdor trofetë melodramatike të soap-operave për të rrëfyer një histori të bukur, ku ndërkallen gjithandej vëzhgime të holla filozofike.

***The Economist***

Zemra e errët e miqësisë rrallëherë është disektuar me kaq detaje të hollësishme.

***The Evening Standard***

... një marifet i vjetër letrar, ose të paktën, po aq i vjetër sa Prusti: rrëfimi i një historie dhembjeje dhe disfate e pastaj, në fund, pranimi se gjithçka do të shëlbehet nga arti, nga një libër – e pikërisht nga libri që po lexoni. Elena do të shkruajë për muaj me radhë... për të qetësuar shoqen e saj dhe veten, si dhe për të arritur, përtej metaforës, që të shpëtojë jetën nga brengat, që të nxjerrë kthjelltësinë nga kaosi, pa mohuar ekzistencën e brengës dhe të kaosit. Ajo afron karrigen te tryeza e saj. "Do ta shohim se kush do të fitojë këtë radhe", thotë ajo. Arti fiton. Ne fitojmë.

***The NeW Yorker***



## FRAGMENTE NGA LIBRI

1)

Ndryshe nga ç'ndodh në rrëfime, jeta e vërtetë, kur ka kaluar, zgjatet përpara jo drejt kthjelltësisë, por drejt errësirës.

2)

Çdo marrëdhënie e ngushtë mes qenieve njerëzore është plot tehe të mprehta dhe nëse do që të zgjasë, duhet të mësosh t'iu dredhosh. Kështu bëra edhe në atë rrethanë e, në fund, m'u duk që sërish u gjenda para provës se sa e shkëlqyer dhe e errët ishte miqësia jonë, sa e gjatë dhe e koklavitur kishte qenë dhembja e Lilës, se si ajo vazhdonte të ekzistonte dhe do të ekzistonte përgjithmonë.

3)

Këto tradhti, mërmëriti, nuk bëjnë fajde kur tjetri nuk i mëson në çastin e duhur; kur je i dashuruar, fal gjithçka. Që tradhtitë të fitojnë peshën e vërtetë duhet që dashuria të nisë të zvjerdhet.

4)

...për të prodhuar ide nuk është nevoja të jesh shenjtor. Gjithsesi, intelektualët e vërtetë janë një grusht. Masa e të kulturuarve komenton përtacisht tërë jetën idetë e të tjerëve. Energjitë më të mira i shpenzojnë në ushtrime sadizmi kundër çdo rivali të mundshëm.

5)

Ia ktheva: po më la edhe Ima, jeta ime s'ka më kuptim. Por ajo buzëqeshi: e ku është shkruar që jetët duhet të kenë një kuptim?

6)

Shpejt zbulova se po mësohesha të isha njëherësh e lumtur dhe fatkeqe, sikur të ishte pikërisht ky statusi i ri dhe i pashmangshëm i jetës sime.

7)

Atë idenë e zhdukjes e kishte shprehur shpesh, por nga fillimi i viteve '90 – sidomos nga viti 2000 e tutje – iu kthye në një lloj refreni kryeneç e tallës. Ishte një metaforë, natyrisht. I pëlqente, e kishte përdorur në rrethana nga më të ndryshmet, dhe kurrë s'më shkoi në mendje, në tërë ato vite të miqësisë sonë – as në çastet më të tmerrshme fill pas zhdukjes së Tinës – që të mendonte për vetëvrasje. Zhdukja ishte një lloj projekti estetik. Është e padurueshme, thoshte, elektronika duket kaq e pastër, por në fakt ndot, ndot jashtë mase, dhe të detyron ta lësh veten kudo si të pëgërje e të pshurrje nën vete vazhdimisht: kurse unë s'dua të lë asgjë nga vetja, tasti i parapëlqyer është FSHI.

8)

Në këtë mes, vetëm ne të dyja kemi lidhje: ajo që kërkon që unë të jap atë çka natyra e saj dhe rrethanat ia ndaluan ta jepte, unë që nuk arrij të jap atë çka ajo pretendon; ajo që nxehet me pazotësinë time dhe për inat do të më shndërrojë në hiç siç bëri me veten, mua që shkrova muaj e muaj me radhë për t'i dhënë një trajtë që të mos tretet, dhe ta mundja, dhe ta qetësoja, dhe kësisoj të qetësohesha edhe vetë.

9)

Kush është në depresion, nuk shkruan libra. I shkruajnë njerëzit e kënaqur, që udhëtojnë, që janë të dashuruar, dhe flasin e flasin të bindur që fjalët, në një mënyrë a një tjetër, gjithnjë shkojnë në vendin e duhur.

– Pse, nuk është kështu?

– Jo, fjalët rrallë shkojnë në vendin e duhur, dhe vetëm për një kohë shumë të shkurtër. Më së shumti, shërbejnë për të llomotitur në tym, si tani. Apo për t'u shtirur sikur gjithçka është në kontroll.

10)

Ishin vite të ndërlikuara. Rendi i botës ku qemë rritur po shpërbëhej. Aftësitë e vjetra të fituara falë studimit të gjatë dhe shkencës së vijës së drejtë politike befas dukeshin një mënyrë e pakuptimtë për të zënë kohën. Anarkist, marksist, gramshist, komunist, leninist, trockist, maoist, punëtorist, po bëheshin me shpejtësi etiketime të vonuara apo, më keq akoma, një damkë shtazërie. Shfrytëzimi i njeriut nga njeriu dhe logjika e fitimit maksimal, që dikur mbaheshin si diçka e neveritshme, tani ishin kthyer kudo në shtylla mbajtëse të lirisë dhe të demokracisë. Ndërkaq, përmes rrugësh të ligjshme dhe të paligjshme, tërë hesapet e hapura brenda shtetit dhe brenda organizatave revolucionare po mbylleshin me dorë të fortë. Fare lehtë mund të përfundoje i vrarë ose në burg dhe, mes njerëzve të zakonshëm, kishte plasur paniku.

H
HISTORIA

*Autori ka bërë një përshkrim të kohës që përkon me shekullin e XV dhe rolin e Gjon Gazullit, që sipas tij mund të quhet "diplomat profesionist",* **duke qenë se qysh në kohën e lëvizjeve kryengritëse të prijësve arbër më 1432, ai del të ketë shërbyer si ambasador i Republikës së Raguzës pranë Perandorit Sigismund..**

# GJON GAZULLI, ambasador i Skënderbeut

NGA GJON MARKU

*Vijon nga faqja 1*

Nëse kërkojmë në gjurmët e shtetit shqiptar marrëdhëniet diplomatike midis vendit tonë dhe vendeve të tjera, ato kishin nisur shumë kohë më parë. Kështu sipas kapitullit XXIV të Statusit të Raguzës në vitin 1272, mësojmë për lartësimin e rrogës së misionarëve të ndryshëm që shkonin në qytetet shqiptare, si bie fjala në Durrës, në Vlorë, në Krujë, në Shkodër, në Ulqin dhe në Tivar.[1] Pra është e qarte se Raguza kishte lidhje dhe dergonte të ashtuquajturit misionar në disa qytete të Shqipërisë. Krahas shërbimit të misionarëve, të konsujve dhe të ambasadorëve të huaj, sidomos të Venedikut, të Raguzës, të Napolit, të Hungarisë, të Bosnjes etj.të cilët zhvilluan aktivitet diplomatik në; Ndërfanë, Durrës, Artë, Vlorë, Spinaricë (Zvernec), Shkodër, apo në ndonjë qytet tjetër shqiptar. Që nga kapërcyelli i shekullit XII me ngritjen e Arbëris shtet i pavarur, zë fill edhe diplomacia e hershme shqiptare. Për këtë, njoftime mjaft interesante jep traktati i Dhimitrit (kryezot i Arbëris) me komunën e Raguzës, që u bë më 1210. Sipas traktatit në fjalë, garantohet liria për tregtarët e Raguzës që në ujrat dhe në Trojet Arbërore të bëjnë tregti, pa kurrfarë detyrimesh doganore apo diçka të ngjashme.[2]

Për të mbërritur në një marrëveshje ndërkombëtare, sikurse qe midis Dhimitrit dhe Komunës së Raguzës, është dashur një mision diplomatik edhe pse mungojnë të thënat e hollësishme për veprimtarinë dhe për aktivitetin e tij.

Kryengritjet shqiptare nuk kalojnë jashtë vëmendjes së serave të larta të shoqërisë edhe para ardhjes së Skënderbeut në Shqipëri.

**Së pari**, të interesuar për intensitetin dhe mbarëvajtjen e këtyre kryengritjeve ,ishin vendet që rrezikoheshin nga pushtimi Osman, e një ndër këto vende ishte Raguza, që në thelb vinin nga e njëjta origjinë si dhe shqiptarët, pra ishin Ilirë.

**Së dyti,** gjithnjë e më shumë po afroheshin drejt saj Hordhitë Osmane.

**Së treti**, ishin dëmtuar seriozisht marrëdhëniet tregtare ku anijet raguziane nuk liheshin të qarkullonin lirshëm më ne territoret kur dikur kishin zhvilluar marrëdhënie intensive tregtare.

**Së katërti,**Raguza kishte një komunitet mjaft intensive me peshë, dhe që zinte vend në aristokracinë e kësaj republike të ardhur nga Shqipëria e Veriut.

Por për kryengritjet dhe ecurinë e tyre ishin të interesuar dhe fuqitë e mëdha. Atyre u cënoheshin fort interesat e tyre tregtare e ekonomike, e më pastaj dhe politike. Por mbi të gjitha në portat e Europës gjendej njëra ndër hordhitë më barbare të botës, një rrezik i përhershëm dhe i vazhdueshëm për botën e qytetëruar.

Themelimi i shtetit të ri, të pavarur shqiptar në krye të të cilit ishte Gjergj Kastrioti (1443-1468) bëri që Shqipëria të bëhet një faktor i rëndësishëm i rezistences antiosmane. Në këtë kohë marrëdhëniet diplomatike ndërkombëtare, marrin një rëndësi të vecantë dhe luajnë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet gjithëplanshme midis shteteve, të cilat vinë gjithnjë e më tëpër duke u intensifikuar dhe duke u bërë gjithnjë e më të domosdoshëm e më të rëndësishëm.

Në këtë veprimtari politike dihet se rolin kryesor e kanë luajtur intelektualet e kohës, njerzit e shkolluar. Sidomos ato që ishin shkolluar në shkollat e këtyre vendeve, e për këtë u zgjodhën njerëz që falë aftësive të tyre individuale kishin fituar një popullaritet, që ishin shkolluar në shkollat më prestigjoze të kohës dhe që kishin lënë gjurme duke u bërë përsonalitete të kulturës, dijes e shkencës në vende të tjera. Marrëdhëniet diplomatike me Raguzën por dhe me vendet e tjera kanë marr një karakter ndërkombëtarizues.Dhe misionet diplomatike të kësaj periudhe u përfaqësuan vetëm në emer të Skënderbeut.

Shumë i spikatur është kontributi i një grup diplomatësh a të dërguarish, që ndihmuan luftën e Skandërbeut në Dubrovnik, heshturazi në pikëpamjen logjistike.Një rol kyq luajti këtu familjet e dijetarëve dhe diplomatëve (Gazulli) (Gasulus).Gjon Gazulli (Johan Gazuli) rreth 1400-1465, i cili pati doktoruar në Universitetin e Padovës më 1430, mbahej si një dijetar i rëndësishëm i kohës.

Natyrisht një njeri i shkolluar në nivelet më të larta,në një ndër universitetet më prestigjioze të kohës, menjëherë do të zinte një vend të rëndësishëm dhe në diplomacinë e Raguzës, ku ai banonte dhe jetonte ishte kthyer menjëherë pas mbarimit të studimeve. Ai me siguri ishte i lidhur fort me çështjet shqiptare, në një kohë që Roma në këtë kohë e konsideronte nje diplomat të madh.

Vetë Raguza shërbente si një qendër informacioni për vendet e Europës, sidomos për dy prej diplomacive më kryesore pra Romës dhe Hungaris por dhe vendeve të tjera të krishtera.



Skënderbeu

## Aftësia e Gjon Gazullit

Gjon Gazulli shfaqet si një person me aftësi të rralla në fushën e diplomacisë e shquhet si një ndër diplomatët më të zotë të kohës. Vetë situata e krijuar dhe aktiviteti i tij i gjerë dhe i spikatur bënë që ai të hynte në mënyrë aktive në zgjidhjen e mjaft ngjarjeve politike të kohës. Ndërsa vendet ballkanike bënin rezistencë ndaj gjendjes së krijuar nga sulmet e drejtpërdrejta të turqve, qarqet diplomatike europiane dhe shtetet e Europës zhvillonin një aktivitet të gjerë diplomatik kundër deportimit të mëtejshëm të osmanëve, prandaj ato nxisnin dhe përkrahnin rezistencën e popujve të Ballkanit e kjo ishte e lidhur drejtëpërsëdrejti në mbrojtje të interesave të tyre e në radhë të parë të lirisë së tyre.

Perandori Sigizmundin kryengritjet shqiptare të viteve (1429-1436) i ndiqte me vëmendje tëveçantë, e kryesisht lajmet për këto kryengritje i merrte nga Raguza ku gjendej një komunitet mjaft i rendësishme.Mbi të gjitha një plejade intelektualesh e familjesh aristokrate te Dubrovnikut ishin me origjinë prej Shqipërie. Në bazë të dokumenteve arkivore, ai në vitin 1434 kishte krijuar lidhje të drejtpërdrejta me kryengritësit, e kjo kishte ndodhur nëpërmjet Raguzës. Është Perëndori Sigizmundin që në vitin 1434 angazhon për të vënë kontakte me kryengritësit shqiptar djalin e perandorit të Bullgarisë Fruzhinën.[3]

Gjithashtu në vitin 1435 Republika e Raguzës dërgon në Shqipëri të deleguarin e mbretit të Hungarisë, që të informohej hollësisht për rrethanat në këtë vend. Në fillimet e luftës së Skënderbeut kundër pushtuesve Osman, interesimi i këtyre vendeve ishte më shumë vëzhgues, pasi këto vende nuk ishin shumë të gatshme dhe të qarta në marrëdhëniet me Gjergj Kastriotin.Gjon Gazulli si diplomat i sprovuar i republikës së Raguzës mbante lidhje me republikën e Hungarisë.Por fillon të angazhohet fort në çështjet Shqiptare dhe kudo ku udhëtonte e publikonte me forcë këtë çështje dhe kryengritje të shqiptarëve.

Në këtë kohë republika e Raguzës edhe pse dërgon në Shqipëri të deleguarin e mbretit te hungarez që të informohet për gjendjen në Shqipëri, interesimi i tyre për Gjergj Kastrioti Skënderbeun në vitet e para të luftës së tij kundër pushtuesve osman pasqyrohej vetem me vëzhgimin e ngjarjeve, meqë në këtë kohë Raguza nuk ishte e gatshme të vinte kontakte më të afërta me shqiptarët në luftë kundër osmanëve. [4]

"Ky Gjon Gazulli asht kenë çue shpesh herë si nunë te Papa e Perandori. Ne vj. 1432 çohet te Sigismundi e te Eugeni IV. Në vj. 1435 më 7 Marc Te princi i Torantit. Prej këtyne dokumentave e dijm se ky është meshtar (-vobis egregio atrium doctori magistro, nenerabilique presbitorio, Johani Gasuloa-) kështu i drejtohet Rektori i Raguzës kur e lut në vj. 1432 me shkue te Sigismundi e të Eugeni IV,- shkruhet ne Hyllin e Dritës në 1940.[5]Në fjalorin enciklopedik shqiptar thuhet "U ngarkua me misione delikate diplomatike, si "ambassador shetitës" i Raguzës ku u angazhua në politik"[6]

Pra në vitin1432 Gjon Gazulli në emër të Republikës së Raguzës dërgohet te Sigismundi: "Në vitin 1432 më 25.III Raguza dërgon Gjon Gazullin, presbiter, me mision diplomatik të Sigizmundi i Hungarisë, për të kërkuar leje prej tij që tregtarët raguzjanë të punojnë në viset e "të pafevet". Gjerë në fund të prillit 1433, Gazulli ishte në Siena pas Sigizmundit se hungarezi vajti në Romë për t'u kurorëzuar perëndor nga papa Evgjeni IV më 14.II.1434, Raguza e falenderon Sigizmundin se ju dha leja që i kërkonte dy vjet më parë. (Gelcich-Thalloczy, Diplomatarium Ragus 568-71.)

Pavarsisht se kërkonte leje nga Sigizmundi vasale e të cilës është, Raguza vepron dhe me mendjen e saj, si mund të kuptohet nga datat e vendimeve që ajo merr e të përçapjeve që bën.

Prof. Jahja Drançolli në librine tij "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV" pohon se falë angazhimit të tij Sigmundi u angazhua për ralizimin e misionit diplomatic. Kështu, për këtë qëllim Gazulli qëndroi në oborrin mbretëror dhe e shoqëroi atë për në Sienë të Francës ku arriti më 11.VII.1432, pas një kohe të sh-

# ARBEN MEKSI MERR ÇMIMIN SPECIAL NDERKOMBETAR PER KARIKATUREN

Në konkursin botëror të karikaturës të zhvilluar në Qipro, ku morën pjesë rreth 348 karikaturistë nga 64 vende të ndryshme të botes, u paraqitën plot 802 punime. Karikaturisti Arben Meksi u nderua me çmim special në këtë evinement kaq të madh. Ky konkurs trajtonte temën e ruajtjes së Paqes në botë, e shprehur përmes simbolit të pemës së ullirit.

Ideja që ka paraqitur autori në këtë punim, janë pemët e prera të ullirit dhe pëllumbi, i cili fluturon sipër tyre me folenë e lidhur pas trupit duke mbajtur në sqep degën e ullirit, duke shpëtuar kështu simbolin e paqes.

Karikatura e tij u vlerësua jo vetëm për mesazhin që përcillte por edhe për paraqitjen grafike të saj. Punimet e paraqitura në këtë konkurs, u vlerësuan nga një juri ndërkombëtare. Fituesit që u nderuan me çmim, do të marrin pjesë në ceremoninë e ndarjes së tyre.

Organizatorët e këtij konkursi, ditën e dhënies së çmimeve sëbashku me punët e ekspozuara, do të shpërndajnë dhe katalogun me punimet më të zgjedhura nga ky aktivitet. Karikaturisti shumë i njohur vlonjat ka marrë disa çmime ndërkombëtare dhe është nga të paktët karikaturistë që përfaqësojnë vendin tonë në këtë gjini të artit tonë pamor.





Raguza

## Aftësia e Gjon Gazullit

Për Gjon Gazullin
"Ky Gjon Gazulli asht kenë çue shpesh herë si nunë te Papa e Perandori. Ne vj. 1432 çohet te Sigismundi e te Eugeni IV. Në vj. 1435 më 7 Marc Te princi i Torantit. Prej kётyne dokumentave e dijm se ky është meshtar (-vobis egregio atrium doctori magistro, nenerabilique presbitorio, Johani Gasuloa-) kështu i drejtohet Rektori i Raguzës kur e lut në vj. 1432 me shkue te Sigismundi e të Eugeni IV,- shkruhet ne Hyllin e Dritës në 1940




kurtër pikërisht më 31.VII.1432, mbreti hungarez mori një letër nga rektori raguzian, që kishte këtë përmbajtje: "Të bindurin Prift Gjon Gazulli (...) të cilin, me kredencialet tona e dërguam te shkëlqesia juaj, që të angazhoheni te Papa për të nxjerr privilegjin e lundrimit dhe të tregtisë në vise të të pa feve, po ashtu Ju porosisimdhe ju lutemi me përvuejtëri që të bëheni fjalëmirë për realizimin e dëshirës sonë". (7)

Po atë vit Raguza meqë Sigmundi pati pengesa por mbi të gjitha nga vonesa e Gjon Gazullit dërgoi dhe tre diplomat të tjerë të Sigmundi që të ralizohej kërkesa e saj.

Gazulli, i cili e shoqëroi vazhdimisht perëndorin e sapokurorzuar, nuk u kursye që ti lutej Sigismundit për tu angazhuar në ralizimin e misionit në fjalë, por me gjithë përpjekjet e bërë misioni nuk u ralizua nga Papa por gjithësesi ishte ralizuar miqesia midis perendorit dhe republikës së Raguzës, e ky ishte komntributi kryesor i Gazullit. Vetë Sigizmundi arritit të siguronte privilegjin e kërkuar prej Raguzianëve në vitin 1434.

Gazulli, shqiptar, autoritet në Raguzë, nuk mund të jetë pa dijeni mbi çka zhvillohet ne Mirditën e tij, ku zoti i vendit, Gjon Kastrioti, është thyer e nënështruar më 1430 dhe tani e ka syun për kryengritje, në mos ka nisur anijet raguziane, tregtonin në Shufadanë e tij". (8)

Ai gëzonte një autoritet të madh në Raguza e këtë e tregojnë më së miri detyrat që i ngarkoheshin atij gjatë kësaj periudhe.

Në vitin 1432 zoti i Krujës, Ali Beu, kërkon pension prej 200 dukat vjetor, që i jepte Venediku, që s'ia ka dhënë e ai, për këtë shkak, i ka mbyllur rrugën e Durrësit.

"Në vitin 1435, Gjon Gazulli gjendet te mbreti i Hungarisë, me sa duket për çështjen e kryengritjes në Shqipëri. (J Tadic, J. Gazulus (Zbornik filozof. Fakult.2/ 1964, Beograd, 453).

Edhe pse ai është një diplomat në dispozicion të republikës së Raguzës duket se qështja kryesore e këtij udhëtimi të tij drejt Hungaris janë ngjarjet në Shqipëri e prej andej po në dispozicionin e Republikës së Raguzës sipas Prof. Jahja Dranqollit, Gazullin në viti 1435 e shohim prapë në një mision diplomatik në Italinë e Jugut. Italia e jugut në këtë kohë është e njohur për piratët e saj të etnive të ndryshme, që nuk lejonin anijet raguziane të bënin tregti.Ndërsa Raguza kërkon të ndërtojë lidhje bashkëpunimi dhe tregtie me Italinë e Jugut, Sicilin etj. Ai u dërgua atje 10.II.1435 e mund të qëndronte atje dhe dy muaj për të ralizuar misionin e ngarkuar nga Raguza që ishte sigurimi i lidhjeve dhe marrëveshjeve me Italin e Jugut,Sicilin etj. Nuk dihet se si përfundoi ky mision i Gjon Gazullit në Italinë e Jugut pasi ka shumë pak të dhëna për të. Më pastaj ai qëndron në Raguzë deri në përfundimin e vitit 1435. (9) Në fillimin e vitit 1436 ai gjendet ne Oborrin e princit të Sllovenis Matej Talovec (10) i cili posaqe kurorëzuar nga perandori hungarez Sihgmundi që sipas Prof. Jahja Dranqollës humanisti ynë e njihte Matej Talovecin, përkatësisht nga koha, kur kishte shkuar në misionet e veta të para diplomatike në Itali pra që në vitin 1432. (11)

Gjon Gazulli ka meritën e madhe se e kishte mirëinformuar perandorin hungarez Sihgmundi dhe atë Slloven Matej Talovecin, për ngjarjet në vendin tonë kështu që janë të shumta misionet diplomatike shqiptare që gjenden në oborrin e perandorit Hungarez dhe atij Slloven por këtu nuk është qëllimi të merrem dhe të ndalemi tek ato. Gazulli përmendet për herë të fundit 29 shkurt 1436 tek Matej Taloceci.

Gazulli banonte në Raguzë dhe i shërbente kësaj si ambassador, si do t'i shërbej më pas edhe Skënderbeut.Ai ka qënë me kohë aktiv për qëndresën e shqipërisë duke ndikuar pranë Republikës së Raguzës dhe Hungarisë. Sipas Tadicit, po aty më 1441 dhe 1445, ai ishte në Romë për të mbrojtur interest e një prifti katolik të Serbisë. Më 1451, atje e dërgoi Skënderbeu, për të kërkuar nga papa ndihma në të holla. (12)

Më 1442 sipas Prof. Jahja dranqollit, pasi ishte kthyer nga Italia, gazulli gjendet prapë në Raguzë ku sëbashku me disa antarë të Këshillit Kishtar të Raguzës bënë një transaksionme shtëpinë që ja kishte lënë trashëgim xhaxhai i tij Matej Gazulli e për këtë do të flasim diku tjetër.

Për Skënderbeun marrëdhëniet e Shqipërisë me republikën e Raguzës janë tepër të rëndësishme.

**Së pari,** Raguza ishte porti më i afërt që mund të shërbente si qendër e rëndësishme informacioni për Europën dhe për vendet e tjera të krishtera.

**Së dyti,** Raguza ishte qendër kryesore që mund të shërbente si ndërlidhëse me Hungarinë, me perendorin Sigizmund të Hungaris.

**Së treti,** Raguza kishte një numër jo të vogël familjesh shqiptare që gjendeshin dhe banonin në këtë qytet dhe këto familje kishin një peshë të rëndësihme e kishin bërë vend të rëndësishëm në aristorkracinë e vendit.

**Së katërti**, Raguza ishte nje vend prej nga mund të siguroheshin të ardhura për luftën po mbi te gjitha armatimet.

**Së pesti,** Raguza mund të shërbente dhe si një vend i mundshëm prej nga ku në kushte tëper të veshtira mund të gjendej vend për familjen e princit shqiptar, pra në rastin e një pushtimi tëmundshëm nga osmanët.

**Së gjashti**, Raguza ishte një vend ku kishte një shtrat të kahershëm të marrdhënjeve ndërshtetërore edhe pse në fillimin e kryengritjeve dhe luftës së Skënderbeut kundër Osmaneve, Raguza nga ana e saj mbante një qëndrim vëzhgues.

Krejt ndryshe ndodh me Gjon Gazullin që jo vetëm i ndiçte me përparësi ngjarjet në Shqipëri por kishte dhe një angazhim serioz për to e sidomos në prezantimin e tij para Republikës së Raguzës, Sigizmundit të Hungarisë apo mbretit të Sllovenis, duke ndikuar drejtëpërsëdrejti në marrëdhëniet e këtyre vendeve me Skënderbeun.

E pra në këto marrëdhënie një rol kyq luante familja Gazulli, nëpërmjet të cilës kryeheshin kontakte të rëndesishme të Skënderbeut me Raguzën.Astronomi dhe diplomati i Skënderbeut Gjon Gazulli kujdesej për çështje financiare dhe krijonte kontakte me Romen dhe Hungarinë.Ai përpiçej të sqaronte republikën e Raguzës më 1455, pse e zgjeroi Skënderbeu Kepin e Rodonit në keshtjell.Familja Gazulli, e cila atëherë jetonte në Raguzë i siguronte Skënderbeut para dhe teknologji lufte. (13)

Është Gjon Gazulli që vë në dijeni Romën për "braktisjen" e turqve nga ana e Skënderbeut.Për "braktisjen" e turqve nga ana e Skënderbeut do fliste dhe nje document raguzian i vitit 1451 në fjalimet që Joan Gazulli, i dërguari i qytetit të Raguzës te papa, do të mbahej para tij në shkurt të vitit 1451. (14)

Më 27.X. 1436 Gjon Gazulli është i dërguari i Raguzës tek Papa, që të fliste "për pesë ditë për punët

Vijon në faqen 20

## ...nga numri i shkuar

“Milosao” e këtij numri iu kushtua me të gjithë të drejtën e duhur, Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Redaktori kontaktoi prof. Gazmend Shpuzën, që shpesh ka shkruar për këtë ngjarje, dhe i kërkoi një shkrim. Në titullin kryesor redaktori vendosi diçka që kish lidhje me karakterin mysliman të kësaj lidhje, por që në fund u kthye në Lidhje Shqiptare. *Kuvendi historik i Prizrenit, në të cilin u themelua Lidhja Shqiptare, i mbajtur pranë Bajrakxhami-së të këtij qyteti ka mbetur i pa vlerësuar dhe madje i anatemuar keqas si një tubim i organizuar dhe i manipuluar nga elementët sulltanistë. Kararnameja, i vetmi dokument i miratuar në këtë kuvend, përshkohej nga besnikëria ndaj sulltanit dhe Sherijatit. Edhe vetë organizata e porsakrijuar qenka quajtur lidhje islamike dhe më vonë u quajt Lidhja Shqiptare!* Pikërisht, këtu e gjeti idenë redaktori për ta vendosur në titull.

Për miken e tij, që u nda nga jeta disa ditë më parë, redaktoi bëri një shënim në faqen e parë, që pësoi një vërejtje nga Kroacia, vendi i saj i origjinës…Marko Pogaçar, poeti kroat që u përkthye në këtë numër nga vetë redaktori, i kujtoi mikut të tij se Dashës i duhej lënë vend pak më shumë. Redaktori, nga ana e tij, i kujtoi se Drndic



është shumë më pak se Lidhja e Prizrenit dhe u mundua t’ia shpjegojë këtë fakt.

Ndërkohë cikli i poezive të mrekullueshme prej autorit kroat e zbukuronte numrin. Ai mbahet si një nga poetët më të lexuar të rajonit në kohën tonë. Autori punon me simbolika dhe koncepte dhe jep një letërsi me karakteristika realisht shumë të larta...shkroi për mikun e tij kroat.

Patëm një tekst, kushtuar Mjeshtrit të Madh Hazis Ndreu, që ishte shkëputur nga libri i artistit Bujar Kapexhiu “Burri i Odës Dibrane”. Shkrimi u përgatiti enkas me rastin e tetëmbëdhjetë vjetorit të ndarjes nga jeta të tij. Për fat ishte pritur shumë mirë nga njerëzit e tij. Kapexhiu kishte shqetësimin se mos nuk i botoheshin karikaturat e veta.

Vazhduam shkrimin e Ilirian Agollit për Poradecin…Në këtë pjesë vazhdoi përshkrimi nga publicisti të momenteve të vështira të jetës së Lasgush Poradecit. Me ankimet e zakonshme të poetit që po lulëzonte dhe përkëdhelitë që e rrethojnë ngado dhe që në fund konkretizohen me ndihmë, autori na jep dhe momentin kur Poradeci shpërblehet për Himnin e Rinisë, që bëhet në kremtimet e ditëlindjes së Mbretit Zog...

Në përgjithësi duhet të themi se ishte realisht një numër i mirë dhe i gjetur këndshëm. Layout këtë numër kish punuar më shpejt. Urojmë që një gjë të tillë ta bëjë dhe në këtë numër.

Vijon nga faqja 19



Rrethimi i parë i Krujës

# GJON GAZULLI, ambasador i Skënderbeut

e Skënderbeut në oborirn e Romës, e mbasi të ketë nxjerr lejen (për të marrë nga ndihmat raguziane) e të ketë fol për punët e Skënderbeut “të kthehet sa më parë. Nëse Gjoni nuk ka në dorë “bulën” (që i jap Raguza) “të mos flas për punët e Skënderbeut” [15]

Raguza kuptohet, duhet ti jepte Gjonit një autorizim special të shkruar, por nuk ishte e vendosur për këtë akoma.[16]

Në situatën kur Skënderbeu luftonte i vetëm,vendet e tjera më shumë vëzhgonin ngjarjet në Shqipëri dhe nuk ishin shumë të gatshëm të ndihmon Gjergj Kastriotin. Duke parë ndoshta dhe mos dyshim luftën e tij, aq më tepër pa dashur të futen në konflikt të drejtëpërdrejtë me osmanet, bën që gjendja në Shqipëri të vij duke u bërë gjithnjë e më e vështirë.

Gjon Gazulli është shumë aktiv, sidomos me qeverin e tij ai i ndiqte me vemendje të madhe ngjarjet në Shqipëri dhe interesohej vazhdimisht për to, e mbi të gjitha ishte ai që i prezantonte këto ngjarje kudo ku shkonte në misionet e tij, diplomatike dhe shkencore.

Në vitin 1450 gjendja e shqiptarëve vinte duke u keqësuar; qoftë nga dëmet e mëdha që po shkaktonte ushtria turke, qoftë nga shpenzimet e shumta që kërkonte lufta e gjatë, fundi i së cillës nuk dihej, qoftë më në fund ngase aleatët e Beslidhjes së Lezhës po e braktisnin Skënderbeun njeri pas tjetrit.

“Në rrethanat kritike, Skënderbeu kreu nje hap të jashtëzakonshëm, i cili mundi të merret dhe si një gurë diplomatik, por edhe si një akt dëshpërimi. Më 14 tetor 1450 Augustin de Renieris, Proveditor Venedikas i Danjes, i shkruan Senatit të Venedikut, se Skënderbeu kishte dërguar tek ai priftin e vet, abating Lazër, me propozimin që t’ia dhuronte Sinjorësis Krujën, përndryshe, ngaqë gjendja e tij po keqësohej vazhdimisht, do ishte i detyruar t’ua dorëzonte turqve. Por për republikën, sado që dhurata ishte joshëse, po ta merrte në dorëzim Krujën, do të thoshte të hynte në luftë me Turqinë.Për këtë arsye Senati refuzoi.”[17]

Pas refuzimit kategorik të Sinjorisë së Venedikut, Skënderbeu, në pamundësi për të përballuar financiarisht shpenzimet e luftes (vështirësi të shkaktuara sipas Gjon Gazullit jo vetem nga zgjatja e luftës, por dhe nga largimi i aleatëve të Beslidhjes së Lezhës, të cilët, për më tepër kaluan në anën e Sulltanit), ai nisi në Raguzë, sipas relatorit të përmendur raguzian, një ambasador për të kërkuar nga ajo ndihmë. Madje për të shpejtuar procedurat e ndihmës, udhëheqësi shqiptar pak më vonë u nis vetë në Raguzë, duke marrë me vete disa letra të Nikollës V, në të cilat Papa nxiste raguzianët, që të ndihmonin financiarisht Skënderbeun. Raguza shkuan relatori raguzian, vendosi “të dërgonte një ndihmë dhe subvencione të mira në të holla.”[18]

I menjëhershëm dhe i vendosur bëhet qëndrimi i Raguzës, e cila jo vetëm ndiqte me vëmendje dhe me një interesim të veçantë ngjarjet në Shqipëri por i përcillte ato edhe në diplomacitë e vendeve te tjera. Pas vajtjes së Skënderbeut në Raguza, në dhjetorin e viti 1450, pra pas rrethimit të parë të Krujës që kishte rezultuar i pa suksesshëm për turqit, marrëdhëniet diplomatike midis Raguzës dhe Shqipërisë hynë në një fazë të re dhe më pastaj ato zënë vend të rëndësishëm në ngjarjet e kohës, Raguza u bë një qendër e rëndësishme edhe përsa i përket sigurimit të burimeve financiare dhe mjeteve të luftës.

Është republika e Raguzës që i afron ndihmë të menjëhershme financiarë sipas Prof. Jahja Dranqollit qeveria raguziane i dha shumën prej 500 dukatësh.[19]

Sipas Gjon Gazullit shuma e të hollave duhet të ketë qënë e konsiderueshme mbasi me to, thotë ai, Skënderbeu përballoi shpenzimet, të cilat i dhanë atij mundësinë jo vetëm të mbronte qytetin e Krujës, por dhe të shtinte në dorë një pjesë të zotërimeve të veta.

Konteksti i situatës reale, në të cilën Skënderbeu detyrohej të bënte aktin në dukje “Befasues” të afrimit të qytetit të Krujës. Signjoris pikërisht mbas heqjes së rrethimit te Krujës mund të shtjellohet në mënyrë të tërthortë prej një fjalimi që Joan Gazulli, i dërguar i qytetit të Raguzës te papa, do të mbante para tij në shkurt të 1451-shit. [20]

Gjendjen kritike të Skënderbeut në vitin 1450 e ndriçon një relacion i ambasadorit të Raguzës në romë Gjon Gazullit (një humanist me origjinë shqiptare, vëllai i ambasadorit të Skënderbeut në Raguzë, Pal Gazullit) dërguar Papës Nikolla V, më 27 shkurt 1451,disa muaj më pare, pasi mori fund rrethimi i Krujës. Në relacion theksohet tekstualisht:

“Në këtë mënyrë, në vitin e kaluar erdhi i thëni “Turk” dhe i biri i tij kundër Skënderbeut dhe aleateve te tij me ushtri shumë të fuqishme dhe me mjete luftarake. Vetë aleatët e Skënderbeut u bashkuan me turkun. Kështu që Skënderbeu i humbi të gjitha tokat e veta, përveç Krujës, të cilën Turku nuk mundi ta shtinte në dorë për arsye të ashpërsis së maleve dhe kështjellës së atij vendi, dhe besnikëris së njerëzve që ishin aty brenda”.[21]

Kështu me gjithë rrethimin e gjatë që vazhdoi gati pesë muaj dhe me gjithë perdorimin e mjeteve moderne, sulltani nuk e shtiu dot në dorë Krujën, mbasi mbajtësit e saj, siç shkruante në letrën e tij Gjon Gazulli: “luftuan aq sa e detyruan Turkun të hiqte rrethimin, nga qyteti i Krujës”.

Mos marrja e Krujës prej turqve ndikoi në forcimin e vetbesimit të ushtrisë shqiptare dhe mbi të gjitha e ngriti shumë lart autoritetin e Skënderbeut në diplomacitë Ballkanike dhe ato Europiane.

Nga këshillat e dhëna me 27 shkurt 1451 Joan Gazullit prej senatit të Raguzës kuptohet që papa kishte ngulmuar pranë Republikës së Shën Vlashit (Raguzës) për të ndihmuar e mbështetur dhe atë. [22]

Me synimin e realizimit të programit tij, Skënderbeu arrin në dhjetor të vitit 1450 në Raguz dhe kërkon ndihmën e Shuteriqit, pohon që patjetër është takuar me Gjon Gazullin. **(Vijon)**


Literatura

1. Libarstatutorum civitatisRagusii composites anno 1272, ed. V. Bogisic et C. Jereçek, in Monumenta historic-juridica Slovorum meridionalium, vol. IX, Zagrabiae, MCMIV, Lib. II, XXIV, p. 46-”Sialiquis nuncius vel nuncio mitterantur Dyrachium, habere debeat unusquisque ipsorum yperperos septem et lignum et engarios a comuni”
2. HAD, Miscellanea saec. XIII; Drançolli, J. bashkëpunimi në ditë të vështira, p. 13, Rilindja, 2. III. 1985.
3. Radoniç, J. “Djuradj Kasrtriot Skëndërbegi Arbanija u XV veku, 70”; Jereçek, K. Istoria Sarba I, 360, Beograd, 1978.
4. Drançolli, Jahja. “Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV” fq. 58, Prishtinë,1984.
5. “Hylli I Dritës”, nr 7-9, fq, 400, 1940.
6. “Fjalori Enciklopedik shqiptar” Vëllimi I, Tiranë, 2008.
7. Drançolli, Jahja. “Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV” fq. 58, Prishtinë, 1984.
8. Shutertiqi, Dhimitër. “Moti i Madh” përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, fq. 83 Shtepia botuese “Dituria”, Tiranë, 2006.
9. J. Tadiç, “Johannes Gazuli 440”.
10. Sihgmundi, AHD, Lettere et commissioner Leventis XII, Fol. 16; J Tadiç, “Johannes Gazuli” 440.
11. Drançolli, Jahja. “Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV” fq. 58, Prishtinë, 1984.
12. Shutertiqi, Dhimitër. “Moti i Madh” përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, fq. 94, Shtepia botuese “Dituria”, Tiranë, 2006.
13. Drançolli, Jahja. “Prania e shqiptarëve në Raguzë gjatë shek. XIII- XV”, “Gjurmime albanologjike”, “Seria e shkencave historike”, I. XV, fq.39-60, 16-1986, Prishtinë, 1987, ,
14. Plasari, Aurel. “ Skënderbeu një histori politike” fq. 307, Tiranë 2010.
15. Gelcich–Thalloczy, Diplomatarium Raguz. 568-7, Radoniç 38, Jorga , Notes II446. Sh.1
16. Shuteriqi, Dhimitër. “Moti i Madh” përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, fq. 166, Shtepia botuese “Dituria”, Tiranë, 2006 .
17. Frashëri, Kristo. “Gjergj Kastriot Skënderbeu, jeta dhe vepra” (1405-1468) f q. 171, Tiranë, 2002.
18. Frashëri, Kristo. “Gjergj Kastriot Skënderbeu jeta dhe vepra” (1405-1468) f q. 171, Tiranë, 2002.
19. Drançolli, Jahja. “Prania e shqiptarëve në Raguzë gjatë shek. XIII- XV”, “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave historike I. XV, fq. 69, 16-1986, Prishtinë, 1987.
20. Plasari, Aurel. “Skënderbeu një histori politike”, fq. 307, Tiranë, 2010.
21. Frashëri, Kristo. “Gjergj Kastriot Skënderbeu jeta dhe vepra” (1405-1468) f q. 170, Tiranë, 2002.
22. Plasari, Aurel. “Skënderbeu një histori politike”, fq. 307 Tiranë, 2010.

Opinioni i Ditës

# Kush po luan me aktorët?

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

… të shtirë që zhvilloi kryebashkiaku Veliaj, mediat e pushtetit, ato që po përgatiten të rrëmbejnë me miliona euro nga xhepat e taksapaguesve shqiptarë, u munduan të vënë si kryelajme të tyre faktin se komuniteti i aktorëve ishte i ndarë, disa për ruajtjen e godinës së vjetër dhe disa për ngritjen e një teatri të ri. Të tjerë shkuan edhe më tej, duke vënë në pah ndonjë lapsus banal në gjuhën e atyre që janë formuar për të interpretuar më shumë sesa për të menduar. Kështu u tentua të jepet një tablo e rreme sikur Reshat Arbana ishte kundër Luftëtar Pajos, sikur Robert Ndrenika ishte kundër Zamira Kitës apo sikur Alfred Trebicka ishte kundër Hervin Çulit. Në këtë histori, ku nuk do të qe e vështirë të dalloje konfliktin e atyre që thonë mendimin e tyre dhe të tjerëve që paguhen si drejtorë, këto cic-mice kanë fare pak rëndësi. Në qëndrimet e aktorëve të pamësuar me gjuhën e drunjtë të politikës, e cila përbën fjalorin themelor të mediave tona tradicionale, dikush me siguri mund të shtangej nga patetizmi ekstrem i Asqeriut, nga shpërthimet ekstreme të Derhemit apo nostalgjia e tepruar e Roza Anagnostit, por vënia e theksit tek ato është një manipulim i pastër. E para, sepse në gjithë këtë histori të dallueshme korrupsioni dhe arbitrariteti ka fare pak rëndësi forma e shprehjes, përpara aktit të rezistencës.



E dyta dhe më kryesorja, sepse sado që është i lidhur emocionalisht me fatet, kujtimet për të shkuarën dhe të ardhmen e aktorëve, fati i Teatrit Kombëtar nuk është vetëm monopoli i tyre. Ai është një çështje që na prek të gjithëve. Prandaj, përpara se të merremi me aspektet banale të një drame shumë më të gjerë, gjithkush që është në mirëbesim duhet të ngrejë disa pyetje.

Pse qeveria po përgatit një ligj antikushtetues, që anashkalon korpusin legjislativ të miratuar prej vitesh për t'i falur një tokë shtetërore në mes të Tiranës një kompanie private?

Pse kur ky është një biznes fitimprurës me grataçela milionëshe, Edi Rama nuk bën garë, por ia dhuron atë klientit të tij, firmës "Fusha"?

Pse kur ndërkombëtarisht shitet sikur ka pasur një konkurs ndërkombëtar, qeveria e ka miratuar vetë edhe arkitektin danez Bjorke Ingels, që u paraqit në Tiranë me një plagjiaturë të shëmtuar?

Pse kur ka një përvijim konsensual se ajo godinë dhe ajo zonë është monument i trashëgimisë kulturore, askush nuk pyet për këtë? Pse prej 20 vjetësh nuk hiqet dorë nga gënjeshtra se ajo godinë është duke u shembur dhe më në fund doli dhe Veliaj që në stilin e tij, sa më i madh mashtrimi, aq më e madhe besueshmëria, ngjalli panikun se aktorët rrezikohen të vdesin nga kanceri?

Pse disa herë kryebashkiaku u kap në mashtrim nga deklaratat e ministres së Kulturës dhe të dy bashkë dolën blof nga qëndrimet e Ramës?

Pra, e gjithë kjo histori ngërthen brenda vetes aq shumë pikëpyetje dhe dilema sa e ke më të lehtë të besosh tek një histori grabitjeje e përmasave të mëdha, sesa për një debat estetik se çfarë lloj teatri duhet të kemi. Dhe si i tillë, diskutimi për të duhet të fokusohet pikërisht këtu. Tek afera, tek paratë, tek lidhja e shkurtër e kryeministrit me klientin e tij privat. Çdo lloj shmangieje tjetër, çdo tentativë për ta paraqitur atë si një betejë këndvështrimesh mes artistëve që kanë marrë poste nga qeveria dhe atyre që nuk ndikohen nga versioni zyrtar, është një manipulim i pastër. Kushdo që vepron në mirëbesim dhe që nuk është pjesë e sistemit mediatik që po përgatitet të vjedhë taksat e shqiptarëve, nuk ka pse fokusohet as tek ndonjë fyerje e tepërt e Trebickës, as tek debati banal mbi pagën e Mirush Kabashit dhe as te ringjallja e Avni Rustemit në jetën reale.

Pyetja themelore e kësaj afere është nëse do ta lëmë Edi Ramën të vjedhë diçka që na takon të gjithëve. Dhe kush e shmang atë për t'u marrë me detaje, nuk bën asgjë tjetër veçse renditet në krah të hajdutëve.

*"Lapsi"*

Opinioni i Ditës

# Shqipëria në sezonin e kampionatit "Rusi 2018"

Nga Silvi Bakiri

Si kërkon të luajë Shqipëria duke ruajtur personalitetin e vet në rajon (politikisht)?

Po duket çdo ditë e më shumë pozicionimi strategjik i Shqipërisë në ngjarjet politike mbarëbotërore, edhe pse tashmë është fillim vere dhe vëmendja është spostuar detyrimisht nga sporti, që këtë radhë përbën një risi, sepse zhvillohet në Rusi. Si gjendet politikisht i pozicionuar vendi ynë, në raport me vendet e tjera në kërkimin e ekuilibrit euro-perëndimor, me nuanca të qarta lindore në ndikimin dhe lojën e vet? Më tepër se sa në sport, shpirti ballkanas i mbledhur më shumë se kurrë më parë në Shqipëri, e veçanërisht në Tiranë, po i jep vëmendje tjetër vendit. Kështu, në lagje të ndryshme të Tiranës, periferike, por edhe në pedonale për shembull, mund të kuptosh thuajse një ndarje gjeografike si në kohën e Fuqive të Mëdha. Brenda një territori qartësisht dhe dukshëm të kufizuar duket diçka athinase bashkuar me Itali, mu në zemër të kryeqytetit.



Tiranën, për moshën time, e kujtoj si një vend atraktiv dhe unik për nga fakti se ngjante vetëm me vetveten, si ta zëmë Gjirokastra, Berati, Elbasani, Korça etj., qytete karakteristike, që i përkasin vetvetes; me atë arkitekturën tipike që i bën tërheqëse. Ndërkaq, Tirana, si kryeqendër kulturore e Shqipërisë ka ndryshuar me ritme të shpejta. Përmirësimi i banorëve (estetikisht dhe shpirtërisht) - dhe këtë e mundëson sërish dëshira për kulturë, jo gjithmonë sinkronizohet me atë çka është bërë Tirona. Më ngjan çuditërisht me disa skena "toidhje" me kryeqytetin gjerman, Berlinin; shpesh kërthizën e politikëbërjes globale: ku shihja edhe atje trendin e grupeve të djemve që ecnin së toku duke gërthitur, me një lloj proteste të nëndheshme për gjithçka individuale, largqoftë individualiste apo autentike! Pra, një si lloj urrejtje ndaj të ndryshmes, tipike e vendeve komuniste, që përmbush fiks "vullnetin për barazi" siç e quan Niçja - mosguximin për të qenë në turmë pa u njëjtësuar me turmën. Kjo nuk domethënë të duash të zhbësh realitete duke tjetërsuar, për t'ia ndryshuar faqen Tiranës, duke thënë se ajo është në fakt Stokholm, Madrid, Kopenhagen a Romë. Por Tirana ka ndryshuar, është modernizuar shpesh së tepërmi dhe po aq së tepërmi, me një kërkesë të çuditshme për të ngelur njëkohësisht vjetërsi artistike dhe pra një lloj Kruje, deri në barbari...() Shqipëria mund ta ndjekë, nëse nuk e tërheqim Tiranën për ta njohur, për ta rithyer në një kryeqytet që i përket vetvetes. I gjithë ndryshimi projektohet edhe te shqiptarët vetë, pra ne. Kështu që për të ndryshuar një vend, duhet të bëhet ndërgjegjësim kolektiv për reflektim individual, që të mos shohim një shoqëri në depresion, por njerëz të qartë, në kohën dhe vendin e duhur, pa megafonë ekskluzivisht politikë a pushteti.

Duke iu larguar çdo qasjeje personale apo aq më keq makiaveliste, vendit i duhet ristrukturuar klasa politike. Lidershipi. Mënyrat. Mendësia. Përndryshe do jetë pikërisht Tirana, që si një masë përherë në ndryshim të pandalshëm do kthehet eventualisht në Pekin dhe për rrjedhim edhe ne të gjithë, në entitete, që nuk do të njohin më Itakën e vet. Me dëshirën për të ikur, për fugë. Një Tiranë në gri në thelb nuk ka lidhje as me Europën. Duhet të rinjohim vendin, me një tjetër politikë. Me propozime përtej verbërive pushtuese, me ata dhe ato njerëz që dikur thoshin "Mjaft". Edhe tani thonë "Boll". Sepse njerëzit e këtij vendi nuk janë shaka që të meritojnë një mejhane. E as cirk që të meritojnë për kryeqytet, vendbanim apo vendlindje: një teatër. Kush nuk ia u ndjen lodhjen, le të ikë! Kush kupton, të flasë, të bëjë 'fair play', duke mos luajtur, por duke parë seriozisht problemet.

Dje në "Deutsche Welle"

# Kampionati Botëror në Rusi, humbje për lirinë e shtypit

Nga Thomas Latschan

(vijon nga faqja 1)

... i televizionit gjerman ARD dhe shihet në Gjermani si institucion dhe në nivel ndërkombëtar, i njohur në çështjet e sqarimit të dopingut në sport, gazetar investigativ dhe kritik. Kur miliarda tifozë futbolli hidhen përpjetë nga sinjali i bilbilit të Kampionatit Botëror në Rusi, prezent me siguri është Vladimir Putin. Atij i duhet Kampionati Botëror për t'i prezantuar vendin e tij gjithë botës, Rusinë si vendim mikpritës së kampionatit. Rusia sërish superfuqi e fortë. Rusia, komb krenar i sportit, me shkëlqim të mjaftueshëm për të nxirë me diell edhe Putinin.

### KAMPIONATI BOTËROR I FUTBOLLIT NË RUSI, PA ASNJË RE TË ZEZË

Retë e zeza që kanë qenë sipër Rusisë, këtij vendi sportdashës, nuk duhen parë nga tifozët. Hajo Seppelt, gazetari gjerman i sportit, pati hedhur shumë re të zeza mbi shkëlqimin e sportit rus. Sipas mendimit të rusëve, shumë më tepër se duhet. Ai zbuloi sistematikisht dopingun shtetëror mbi sportistët më të mirë rusë, shkaktoi dëbimin e pjesshëm të sportistëve rusë nga Lojërat Olimpike 2016 në Rio dhe 2018 në Phenjan duke e kthyer veten në një lloj armiku për shtetin rus. Edhe sot ai merr mesazhe armiqësore në internet, sharje dhe kërcënime me vrasje. Në kuadër të Kampionatit Botëror të Futbollit, ai u shpall nga autoritetet ruse perspon non grata dhe iu refuzua viza fillimisht, por iu dha më vonë me ndërhyrjen e kancelares Merkel. Megjithatë, autoritetet për çështjet e sigurisë mendojnë se gazetari i sportit ndodhet para një "rreziku të paparashikueshëm" nëse shkon në Rusi. Duke qenë gazetar kritik, nuk je shumë i mirëpritur në Rusi. Gazetarët politikë shpesh sulmohen hapur, vendosen nën presion, iu shtihet frika e duhet nganjëherë të kenë frikë për jetën. Mediat ndërkombëtare mund të cilësohen që prej fundit të vitit 2017 si "agjentë të huaj". Edhe gazetarët kritikë ndaj Rusisë, që ndodhen në vendet e tjera janë kthyer në tabela qitjeje për fushatat e nxitjes së urrejtjes në internet.

### DËSHMI PËR VARFËRINË E RUSISË DHE FIFA-S

Që gjendja e sigurisë në Rusi edhe për një gazetar të huaj sportiv të jetë kaq kritike, nuk ka ndodhur ndonjëherë. Aktualisht ajo tregon edhe një herë se sa keq është liria e shtypit në vendin mikpritës të Kampionatit Botëror. Në rastin e Seppelt, qarqet gjermane të sigurisë thanë se atij mund t'i ndodhë që të merret në pyetje nga pala ruse dhe në rast "mungese bashkëpunimi" të mjaftueshëm, mund edhe të arrestohet. Madje "akte spontane dhune" kundër Seppelt nuk përjashtohen. Kjo tregon se sa shumë zien shpirti rus, se sa shumë armiqësim në vend të sqarimit ekziston në Rusi.



Qeveria ruse duket se nuk është e interesuar në sqarimin e skandalit të dopingut, për më tepër tani. Në fakt, ajo që kërkohet është një deklaratë e qartë e Ligës Botërore të Futbollit. Sepse në artikullin 3 të statuteve të FIFA-s, tek kushtet themelore që duhet të plotësojë një vend që të jetë mikpritës i Kampionatit Botëror bën pjesë edhe liria e shtypit dhe liria e mediave. Në këtë rast duhej një sinjal i qartë nga Moska, që reporterët nuk do të ndalohen të kryejnë punën e tyre, sepse Kremlinit nuk i pëlqen raportimi i tyre. Nëse FIFA do të kishte qenë konsekuente, atëherë ajo do të duhej ta përdorte këtë rast për të rishikuar në përgjithësi praktikat e dhënies së kampionateve botërore. Deri tani qendra e FIFA-s në Gjenevë nuk ka thënë asgjë. Liga botërore e futbollit luan me kohën.

> Retë e zeza që kanë qenë sipër Rusisë, këtij vendi sportdashës, nuk duhen parë nga tifozët. Hajo Seppelt, gazetari gjerman i sportit, pati hedhur shumë re të zeza mbi shkëlqimin e sportit rus. Sipas mendimit të rusëve, shumë më tepër se duhet. Ai zbuloi sistematikisht dopingun shtetëror mbi sportistët më të mirë rusë, shkaktoi dëbimin e pjesshëm të sportistëve rusë nga Lojërat Olimpike 2016 në Rio dhe 2018 në Phenjan duke e kthyer veten në një lloj armiku për shtetin rus. Edhe sot ai merr mesazhe armiqësore në internet, sharje dhe kërcënime me vrasje.

### HUMBËSI I PARË I BOTËRORIT DIHET

Dhe nuk ka rëndësi cili ekip do jetë kampioni i Botërorit, sepse kjo lojë është fituar që tani nga Putini dhe FIFA. Gazetaria kritike ulet në karrigen e humbësit në Rusi, sepse në momentin kur u hodh topi, e gjithë vëmendja përqendrohet tek aktiviteti sportiv.

## HOROSKOPI

### DASHI

Me Hënën armiqësore mund të keni mosmarrëveshje me një familjar që ndërhyn në punët tuaja. Nuk keni fare dëshirë t'i thoni sesi doni të silleni. Do të keni pika të përbashkëta me dikë që ka ditur t'ju tërheqë vëmendjen, por nuk do të jetë e lehtë të pajtoheni.

### DEMI

Nëse në punë doni të jeni i qetë, përmbajuni në mënyrë të përpiktë rregullave dhe shmangni kundërshtimin e vazhdueshëm të veprimeve të eprorëve. Jeni të papërmbajtshëm, edhe për gjërat me të vogla. Organizohuni mirë, pushoni më shumë, zbavituni me miqtë.

### BINJAKET

Pozicioni i Hënës do të bëjë që situata të acarohet. Luftojini mendimet e këqija me një shëtitje në park apo duke dëgjuar muzikën tuaj të preferuar. Mund të bëni njohje të reja të këndshme. Do të përjetoni emocione të bukura.

### GAFORJA

Keni dëshirë të vendosni mirëkuptim edhe më të thellë me personin e zemrës, që do t'ju kuptojë menjëherë dhe do t'ju dëgjojë. Keni përkrah një partner vërtet të veçantë! Do të zmadhoni rrethin e të njohurve dhe do të krijoni kontakte të shumta me njerëz të ditur.

### LUANI

Me mbështetjen e Hënës që ju favorizon do ta peshoni mirë një zgjedhje që do të bëni dhe do t'ia nisni punës. Do t'i tejkaloni situatat e zënkave dhe do të jeni bujarë. E keni kuptuar se për të zgjidhur disa çështje nuk duhet thjesht të mendoni, por edhe duhet të veproni.

### VIRGJERESHA

Në ambientin që frekuentoni, ka persona me të cilët keni të përbashkëta, por duke qenë se jeni i zënë me çështje të përditshmërisë, nuk e kuptoni. Mos ëndërroni udhëtime dhe ndryshime në vende utopike, nuk është koha të merrni nisma të reja.

### PESHORJA

Me Saturnin dhe Uranin bashkëpunëtorë, mund të angazhoheni për të mbushur disa mungesa njohurish dhe të arrini të përgatitur për një sfidë shumë të pritur profesionale. Me Venusin mik, është e mundur që një krizë në çift të zgjidhet.

### AKREPI

Shqetësimi nuk do të jetë i lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Do të bëjë që marrëdhëniet me të tjerët t'i keni sipas kapriçove të humorit. Qetësohuni! Nuk do të pranoni propozimin e një të njohurit, sepse më vonë do t'i ndiheni në borxh.

### SHIGJETARI

Me Jupiterin që i bashkohet shenjës suaj, padituria për t'i vënë fre sjelljes suaj në disa raste mund të shkaktojë ndërlikime. Prandaj veproni me mend. Jupiteri mund të bëjë që të keni disa vonesa administrative të bezdisshme. Kini durim dhe mos u dorëzoni!

### BRICJAPI

Hëna në qiellin tuaj ju bën të provoni emocione të ndryshme. Nga një anë do të jeni ëndërrimtarë dhe të shkëputur, nga ana tjetër pasionantë dhe të angazhuar. Me partnerin mund të keni vështirësi të mirëkuptoheni rreth çështjeve që kanë mbetur në vend.

### UJORI

Me bashkëveprimin e Neptunit në shenjën tuaj, priten gjëra të mira në fushën e dashurisë. Përgatituni të përfitoni. Do të keni në maksimum aftësinë tërheqëse dhe joshëse. Jeni duke shkuar drejt një të ardhmeje të shndritshme në dashuri.

### PESHQIT

Me ndikimin Hënës që bashkëvepron me Venusin, pritet të kaloni një ndjenjë vështirësie që nuk mund ta shpërfillni lehtë. Bëni kujdes se çfarë thoni dhe sjelljes së papërshtatshme që mund të keni, sepse mund t'ju shkaktojë probleme.


www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
Sherri për kafshët, Roza Lati: Do t'i jap kastravecë
BLUE TOOTH
GAZETA SHQIPTARE
500 NUMRA, NJE HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!